

Don Ndue Ballabani ed.

Imzot LAZËR MJEDA

Sa fort e deshti edhe e nderoi Atdheun e vet, e dini të gjithë. Ai jo vetëm e ndjeu në zemër ket dashni e nderim, por e dëftoj me vepra gjith jetën e vet. Emzoti nuk flite shumë, nuk ishte asish që bertasin tue hanger e tue pi. Krejt jeta e Tij kje e shkrimun çashtjes shqiptare. Punoj e ndihmoj që gjuha amtare të zhvillohet e letersija të pasunohej. Tagrave të Atdheut u del zot deri ku i punoj fjala e fuqija. Auktoriteteve të vendit u dha gjithmonë nderimin që e perkithe si urdhnnon ligja e Zotit, mjaft që mos të perkithshin prakun e tagravit hyjnore.

Pjesë nga fjalimi i delegatit apostolik, Gjon della Pietra në varrimin e L. Mjedës

Qe i papertueshëm, i kujtueshëm dhe guximtar. Kudo që e lyp rastin e nevojës për të mbrojtur e zhvilluar ato veprimtari, të cilat janë të shpejta e të dobishme për njeriun dhe legjitime për çdo vend, kohë dhe njeri. Ishte i përkortë dhe i matur në biseda dhe sofrë.

Imzot Mark Sopi

Imzot Lazer Mjeda, krahas Atë Shtjefën Gjeçovit, ishte jo vetëm shembulli i një misionari dhe prifti, dhe e një bariu të ndershëm dhe energjik të grigjës besuar atij, por edhe një ndër burrat më të shquar në jetën politike shqiptare të kohës së tij.

Imzot Dodë Gjergji, ipeshkëv i Kosovës

Imzot Lazër Mjeda
mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar



mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar

Biblioteka »Lazër Mjeda«
Libri 29
Boton Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci
Don Nue Ballabani, misionar
Baboničeva 12
CRO-1000 Zagreb
www.misioni.hr
© *Copyright*

Këshilli i Pakicave Kombëtare Shqiptare të
qytetit të Zagrebit
Remetnička Cesta 79/b
CRO-1020 Zagreb
Vijece.alb.manjine.zagreba@zg.t-com.hr

Albanisches Institut
Postfach 7
CH-9001 St. Gallen
www.albanisches-institut.ch

Për botuesin: dr.med Luigj Daka, kryetar i KPKSHQZ
Lektura: Prof.dr. Tef Topalli

Radhitja teknike dhe kopertina:
Zef Ahmeti

Imzot Lazër Mjeda mbrojtës dhe lëvrues i identitetit shqiptar, Don
Nue Ballabani (ed.) - ISBN 978-953-7367-06-0

Ovo izdanje financiar Vijeće albanske nacionalne manjine Grada
Zagreba.

LAZËR MJEDA NË ARGJIPESHKVINË SHKUP-PRIZREN MES 1909-1921

*(Sipas arkivit Austriak, emërimi tij, laramanizmi, largimi nga
Prizreni)*

Albert Ramaj¹

Hyrje

Nëse e vlerësojmë punën e argjipeshkvit Imzot Lazër Mjeda sa ishte argjipeshkëv i argjipeshkvisë Shkup-Prizren, lirisht mund të dhuhet se L. Mjeda ishte për atë kohë jo vetëm argjipeshkëv, pra bari shpirtëror i kaktolikëve të argjipeshkvisë Shkup-Prizren, por të njëjtën kohë ai kishte marrë përmbi vehte obligim moral që të jetë diplomat, politikan e prijës për mbrojtjen e popullatës jo vetëm katolike por edhe muslimane shqitare në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, Serbi e më gjërë.

Gjërat që do të trajtohen në këtë punim janë puna e tij në Argjipeshkvinë e Shkupit, pra prej 1909 deri më 1921, veprimtaria e tij duke e buzar në disa dokumente të arkivit shtetëror të Austrisë, largimi i tij nga Prizreni. Kuptohet se materialet arkivore që i kemi në duar nuk janë të plota për gjithë punë dhe veprimtarinë e Mjedës në këtë argjipeshkvi, por shpresojmë në planet që kemi se në një punë më të zgjëruar lidhur me këtë temë, do të trajtohet edhe më mirë L. Mjeda mes periudhës 1909-1921. Ka disa gjëra që nga disa autorë në këtë botimit të librit do të cekin, kështu që për të mos përsëritur ato, do tu largohem, por do të mundohem që të sjellë disa gjëra interesante për atë kohë dhe për L. Mjedën.

¹ Drejtues i Institutit Shqiptar në St. Gallen /Zvicër (www.albanisches-institut.ch)

Gjatë këtij shkrimi ndoshta për lexuesin do të shfaqen huti për shkak të temave të ndryshme, për shkak të kapërcimit prej një pjese në tjetrën gjatë leximit, por duhet pasur parasysh se gjitha ato ndryshme dhe procese historike pikërisht kur L. Mjeda ishte argjipeshkëv në argjipeshkvinë Shkup-Prizren që kishin ndodhur në Ballkan, pra është fjala “vetëm” për 13 vite sa ai rezidoi, saqë është e pamundur që në një shkrim të shkurtër të përfshir të gjitha ngjarje. Gjithësesi duhet pasur parasysh edhe gjithë ato procese: luftra kunër turqëve, luftat ballkanike, evropiane, botrore, pastaj shpallja e pavarasisë së Shqipërisë. Lazër Mejda ishte ai që të gjitha ato procese dhe ndodhi i përjetoi, pikërisht në kohën kur ishte argjipeshkëv në argjipeshkvinë Shkup-Prizren. Ai ishte edhe dëshmitar i shumë proceseve të lartëpërmendura, përveç atyre proceseve ishte angazhimi i tij si ipeshkëv jo vetëm në sferën shoqërore, politike e diplomatike, por edhe atë pastorale, kështu që ndoshta jemi të obliguar në këtë shkrim të kapërcejmë disa gjëra që të mund të përfshijmë atë që është me më shumë rëndësi, pra angazhimi pastoral i L. Mjedës Shpresojmë se më vonë me një studim në vete për jetën dhe veprimtarinë e tij vetëm në kohën sa ishte argjipeshkëv në argjipeshkvinë Shkup-Prizren do të zbardhim, apo së paku të jetë ky punim vetëm një udhëzim për të tjerët që të fillojnë punën.

Është shumë me rëndësi që të ceket se si ishte e mundur që popullata shqiptare e sidomos ajo katolike në Kosovë e Maqedoni të mbijetonte gjatë periudhës sa ishte imzot Lazër Mjeda argjipeshkëv. Për këtë gjë, më së shumti ka merita vet argjipeshkvi me angazhimin e tij. Puna dhe veprimtaria e tij është tejjet e rëndësishme për Kosovën dhe është të njëjtn kohë poashtu zhgënjyese që historiografia shqiptare ka lënë në harresë këtë personalitet të madh. Shpresojmë se kjo punë nuk bëhet qellimisht nga historianët shqiptarë. Është po ashtu edhe zhgënjyese dhe që bjerë në sy, se Imzot Lazër Mjeda nuk ka ashnjë rrugë apo shesh që mban emrin e tij në

ndonjë vend në Kosovë apo Maqedoni, kur dihet sa kishtë bërë ai për Kosovën dhe për Maqedonien. Po mos të ishte Lazër Mjeda me menqurinë e tij më 1913, territori i Kosovës së sotme, ndoshta nuk do të ishte si është, sepse ai ishte në fakt që prap Kosovës iu kthya më 1913 territori i Pejës, Gjakovës e rrethinës që kishin okupuar malazezët. Është poashtu e ditur se po mos te ndihmonte Lazër Mjeda Ismail Qemalin në nëntor të 1912 që të vinte në Shqipëri, Qemali nuk do të kishte mundësi që të vinte në kohën e shpalljes së pavarësisë.

Për të kuptuar sa më mirë gjendjen e argjipeshkvisë Shkup-Prizren gjatë veprimtarës së Lazër Mjeda, duhet të shtjellojmë disa gjëra historike të kohës, para se të vinte L. Mjeda në Prizren.

I. Protektorati austrohungarez gjendja e argjipeshkvisë Shkup-Prizren para dhe në kohën e L. Mjedës

Shtrirja osmane në Ballkan nënshtroi edhe tokat shqiptare. Popullata krishtere e Ballkanit, pra edhe ajo katolike shqiptare, e cila kërcënohej të konvertohet e gjitha në islam, shtynë fuqitë e mëdha që të marrin hapa diplomatik që të marrë në mbrojtje këta besimtarë. Atria kishte bërë disa marrëveshje me perandorinë Osmane për të marrë në mbrojtje katolikët në ato vende ku sundonin turqit, pra arrihen marrëveshjet e ashtu-quaajtura paqësore mes këtyre dy fuqive të asaj kohe, si ajo e Vjenës në vitin 1615. Kjo kontrat në fillim kishte për qëllim që të mbrohet kleri krishterë, kurse më arritjen e marrëveshjes së 1681 në Stamboll e sidomos ajo e 1699 në Sremski Karlovac përfshinte jo më vetëm klerikët, por edhe të gjithë besimtarët krishterë që gjindeshin nën sundimin osman. Pastaj u nënshkruan edhe kontrata e vitit 1718 në Pozharevc, më 1739, në Beograd dhe më 1791 në Svishtovë që kishin të njëjtin qëllim; pra mbrojtjen dhe përkrahjen e besimtarëve krishterë në trojet e okupuara nga osmanët. Por, me nënshkrimin e Svishtovës iu mundësua Austro-Hungarisë që të hap përfaqë-

sitë e veta diplomatike në trojet shqiptare. Këto marrëveshje i mundësonin Austrisë që të intervenoj dhe mbrojë sidomos katolikët në aspektin fetar e kulturorë. Nën këtë mbrojtje bëjnë pjesë edhe shqiptarët krishterë. Si figurë e njohur që ka dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim ishte edhe ipeshkvi i Shkodrës, Benino Alberini, ai kishte kontakte të përhershme me Romën dhe Vjenën. Ndërsa në vitin 1837 zyrtarisht edhe Vatikani ia bartë kompetencat me dekret Austrisë që ti mbrojë katolikët në Ballkan.² Një etapë e rëndësishme në zhvillimin e Protektoratit të Kultit shënohet në vitin 1855 kur u arrit Konkordati në mes të Vatikanit dhe Austrisë, i cili parashihte mbështetjen e një "Programi Veprimi" të Ballhausplatz-it³ nga ana e Vatikanit dhe posaçërisht veprimtarinë e Propaganda Fides. Si rezultat i këtij Konkordati, është edhe ardhja e Jezuitëve në Shqipëri që u bënë një faktor përcaktues i politikës kulturore të Austro-Hungarisë në Shqipëri. Prej 240 institucioneve katolike të Protektoratit të Kultit në Perandorinë Osmane, 220 ishin vetëm në Shqipëri. Hapësira e ndikimit të Austro-Hungarisë në kuadrin e protektoratit të kultit shtrihej në Shqipëri sidomos në shtatë dioqeza katolike: Shkodër, Lezhë, Durrës, Shkup-Prizren, Sapë, Pult e Mirditë. Shkodra, si seli ipeshkvnore ishte qendra e katolicizmit shqiptar.⁴

Duhet pasur parasysh se deri më 1890 konzujt që ishin në Shqipëri (kuptohet se nuk është fjala vetëm për Shqipërinë

² A. H. Bena, Studien zum Kultusprotektorat ÖSTERREICH-Ungarns in Albanien in Zeitalter des Imperialismus (1888-1918), Vjenë 1954, poashtu edhe Frok Zefi, Austria mbrojtëse e katolikëve në Ballkan, Urtia 1/1994, fq. 94-96.

³ Ballhausplatz është shesh në qarkun e parë të Vjenës, kurse kjo fjalë si sinonim përdoret për Monarkinë austro-hungareze. Në sheshin Ballhausplatz ishte atëherë edhe godina e Ministrisë së punjëve të jashtme austro-hungareze. Sot janë në atë apo afër këtij sheshi gati të gjitha strukturat shtetërore austriake, si dhe godina e Kancelarisë austriake që ishte ndërtuar më 1717-19 nga arqitekti J. L. von Hildebrandt.

⁴ Krahaso. Kurt Gostentschnigg, Phoenix, 1-2 (15-16, Shkodër, 2000, fq. 37.

e kufijve shtetëror të sotëm, por edhe Kosovë, Maqedoni e gjetiu) nuk kishin simpati të duhur në popull. Sepse dëri në atë kohë, konzujt ishin njërëz të familjeve aristokrate austriake dhe ishin në relacion me shqiptarët mendnjemdhënjë. Por duhet thënë edhe një gjë, se Austro-Hungaria, pas kongresin e Berlinit më 1878 angazhimi konkret diplomatik kishte marrë taman me kuptimin e fjalës „mbrojtëse e katoliëve në Ballkan“. Më parë, ishte më shumë diplomaci reprezentuese se sa mbrojtëse. Sidomos kjo ka të bëjë poashtu edhe me konzujt që njërin shumë mirë Shqipërinë dhe popullin shqiptar, jo vetëm aspekti gjeografikë, por edhe kulturor, gjuhësor, historik, etnografikë etj.

Më 1886 është nënshkruar konkordati i Malit Zi më Vatikanin. Kjo ndoshta nuk kishte pas shumë ndikim në raport me Austro-Hungarinë, sa ishte idea tjetër që të nënshkruhej një konkordat mes Vatikanit dhe perandorisë osmane për çështjen e katolikëve në territorin e Perandorisë Osmane. Ideja për një gjë të tillë lindi nga Perandoria Osmane dhe si shembull duhet të merrej konkordati malazias me Vatikanin. Dhe qëllimi i tij ishte që të zbus çështjen e protektoratit austro-hungarez apo edhe tërthorazi (më vonë) të asgjëson politikën austro-hungareze në Ballkan, sidomos politikën përball populli shqiptar. Për një gjë të tillë ishte përzgjedh njeriu që ishte shumë i afërm në qarqet zyrtare dhe private në Perandori. Patriku armen Stefan Azarian i cili më 1878 vizitoi Romën dhe Vjenën dhe ishte me qëllim të caktuar dhe dërguar nga Turqia, që Vatikanin të mund të hyn në bisedime me Perandorinë Osmane lidhur me konkordatin. Ministri i atëhershëm i punëve të jashte i Austro-Hungarisë Gustav Kalnoky kishte biseduar me Azarian lidhur me këtë punë, por ministri ishte i rezervuar për ndonjë konkordat të mundshëm.⁵ Azarian ishte tepër dinak me me diplomatët

⁵ Benna, Studien zum Kultusprotektorat fq. 21.

perëndimor, sepse nuk u tregonte qëllimet që kishte ti arrinte jo vetëm ai, por edhe Perandoria Osmane, kështu që edhe ministrit Kalnoky nuk i tregoi taman si duhet, por as gjysmën e vërtetë. Ministri mendonte se një lloj konkordati mund të ishte një gjë e mirë për përmirësimin e gjendjes së Kishës Katolike në Shqipëri dhe i tha Azarian se mund të bisedohet për këtë gjë. Kështu që shpesh ndodhte që austro-hungarezëve u tregonte vetëm një pjesë, Vatikanit poashtu, francezëve të njëjtën gjë. Kështu që kishte krijuar një gjendje kaotike diplomatike me mashtrimet e veta për qëllime private, pra atë që kishte qëllim të përbashkët me qarqet zyrtare turke, që të menjanohej protektorati austro-hungarez në Shqipëri.

Qëllimi i Turqisë ishte që ipeshkvijtë dhe priftërinjtë në trojet shqiptare mos të kenë lidhje të mira me Austro-Hungarinë, e gjithësesi mos të jenë shtetas austro-hungarez siç ishte rasti i Fulenije Carev argjipeshkvit të Shkupit. Më të vërtetë është bërë një koncept me disa pika për konkordatin mes Vatikanit dhe Turqisë, duke iu falenderuar dinakrisë së patrikut Azarian. Një ndër pikat që ishin kishte të bëjë edhe drejtpërdrejt me protektoratin austro-hungarez dhe se Turqia kishte të drejtë edhe në veto kur është fjala për emërimin e ipeshkvijve në Shqipëri, pastaj se ipeshkvinjtë e Shqipërisë nuk duhet të caktohen nga Austro-Hungaria dhe ipeshkvinjtë duhet patjetër të kenë dëgjes ndaj sulltanit.... Kur Vjena pa se nuk ishte puna për një konkordat për katolikët në perandorinë osmane, por në fakt kishte të bëjë definitivisht për zhbërjen e protektoratit austro-hungarez, u tërhiq nga ky synim i Turqisë. Këtë e deklaroi edhe ministri i atëhershëm Kalnoky ambasadorit të vet në Romë, pasi që kishte dëgjuar se Azarian kishte vizituar prap Romën.⁶ Në punën e idesë për konkordatin mes Vatikanit dhe Turqisë, ishte edhe një ide që të avansohet më shumë protektorati i Francës sesa ai austro-hungarez. Qëllimi i portës

⁶ Benna Studien zum Kultusprotektorat, fq. 28.

së lartë ishte që më të vërtetë të menjanonte Austro-Hungarinë si mbrojtëse e katolikëve në Ballkan, konkretisht kishte problem me mbrojtjen e katolikëve shqiptarë. Rreth konkordatit mes Perandorisë Osmane dhe Vatikanit kishin ishin shkëmbyer edhe letrat personale mes Papës Leonit XIII dhe perandorit Franz Joseph. Papa i shkruan letër Perandorit më 6 mars 1893,⁷ kurse perandori austriak kishte përgjigj më 1 qershor 1893⁸ dhe në të dy letrat bëhet fjala edhe për konkordatin mes Vatikanit dhe Perandorisë Osmane dhe në të dy letrat bëhet fjalë për gjendjen e kishës katolike në Shqipëri. Shifet shumë qartë se austro-hungaria dëshironte me çdo kusht të ketë protektoratin, dhe pas këtij viti janë ndërpre bisedimet rreth këtij konkordati të mundshëm mes Vatikanit dhe Perandorisë Osmane. Kishte edhe disa momerandume austro-hungareze që i kishte dërguar Vatikanit rreth mospajttimeve lidhur me konkordatin të mundshëm mes Vatikanit dhe Turqisë, sikur ato Abati mirtitor Prengë Doçi kishte shkruar letër nuncit apostullik në Vjenë Antonio Algiardi më 5 tetor 1893 dhe kishte “nuhatur” se qëllimi i patrikut armen Stefan Azaniar nuk kishte që të përmirësohej gjendja e Kishës katolike në Shqipëri, por që përmes një arritje të një konkordati shpresonte që tek Porta e Lartë të ketë gjasa më të mira për përmirësimin e armënëve në perandorinë osmane dhe për interesa personale.⁹

Për të avansuar edhe më shumë punën e konkordatit mes Vatikanit dhe Turqisë dhe për të “treguar liberalizmin” e vet, Turqia i dha argjipeshkvit të Shkupit Pashk Trokshit më 1893 fermanin për liri fetare dhe me këtë shpresonte se do të fillonin prap bisedimet lidhur me konkordatin mes Vatikanit dhe Turqisë, apo më mirë të thuhet se Turqia dëshironte me çdo kusht që protektorati austro-hungarez për mbrojtjen e

⁷ Friedrich Engel-Jánosi fq. 343-346.

⁸ Friedrich Engel-Jánosi fq. 346-351.

⁹ Krhs. Andreas Gottsmann fq. 433.

katolikëve shqiptare të mos egzistonte fare, e kjo mund të ishte arritur, nëse ishte nënshkruar një konkordat sipas dëshirës së Turqisë.

Duhet pasur parasysh se kishte ipeshkvinjë shqiptarë që nuk dëshironin konkordatin austro-hungarez e sidomos ata që ishin nën ndikim e italianëve apo edhe dëshironin që të avansonin protektoratin francez në territoret shqiptare. Një prej tyre ishte edhe argjipeshkvi i Shkup-Prizrenit Pashk Trokshi. Në raportet e konzujve të Prizrenit dhe në dosjen e Personalia të Pashk Trokshit, shifet qartë se imzot Trokshi nuk ishte në pajtueshmëri me Austro-Hungarinë¹⁰ dhe mendohet se Trokshi ishte kundërshtar i Austro-Hungarisë dhe se kërk-on nga Franca të jetë mbrojtëse e katolikëve në argjipeshkvinë e tij e jo Austro-Hungaria. Atë e paraqesin edhe si „ideolog i vërtetë shqiptar“.¹¹Konflikti mes Austro-Hungarisë dhe Trokshit ishte ndoshta më shumë i panevojshëm dhe se ishin shumë mosmarveshje mes reprezentuesëve zyrtarë të Austro-Hungarisë dhe të argjipeshkvit Trokshi. Duhet pasur parasysh se Austro-Hungaria mendonte se ishte dobësuar çështja e Protektoratit në Balkan, sidomos në territorin e popullatës shqiptare dhe dëshironte që të angazhohej edhe më shumë, dhe të njëjtën kohë të mos lenë Francën të ketë ndikim në qarqet kishtarë shqiptare dhe se Austro-Hungaria mendonte se duhej të përkujdesej edhe më shumë sesa deri para kongresit të Berlinit për të krishterët e këtyre vendeve dhe kështu dëshironte të përforcohej edhe më shumë politikisht në Balkan. Në të ashtuquajtur „Memorand“ austro-hungareze edhe në „Archivio degli Affari Ecclesiastici Straordinari“ janë të publikuar më 7 dhjetor të 1899 dhe para së gjithash në memorandet e 11 marsit 1899 (faqe 77-81) dhe gusht 1899 (faqe 90-95) edhe qëndrimet e argjipeshkvit Trokshi përball prote-

¹⁰ Krhs. HHStA A.R, F 27, 136 dhe 20 Bischof Trokshi .

¹¹ Hrabak, Kulturni prtektorat, fq. 45.

ktoratit austro-hungarez.¹² Këtu akuzohet Trokshi se kishte bashkpunuar me qeverinë turke duke iu kundërvy edhe protektoratit austro-hungarez. Dihet se në kohën e Trokshit ishin edhe bisedimet për konkordat mes Turqisë dhe Vatikanit, kështu që çdo gjë që bëhej kundër Austro-Hungarisë ishte në favor të Turqisë, sepse Turqia kishte pretendim që të vij deri të nënshkrimi i konkordatit, porse Austro-Hungaria nuk kishte kurrfarë interesash, sepse protektoratin e vet e merrte sikur një konkordat për shqiptarët, vetëm se kishte emërtim tjetër.

Një betejë tjetër diplomatike lidhur me protektoratin austro-hungarez ishte edhe ideja një konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë. Bile dihet se edhe zyrtari Cedomir Mijatovic kishte dëshirë edhe më parë të rregullonte çështjen e katolikëve në Serbi me një lloj marrëveshje zyrtare mes Serbisë dhe Vatikanit. Mbreti Serbisë Aleksandri kishte shkruar një letër Papës Leonit XIII më 5 korrik 1893 dhe kishte shfaqur dëshirën që të bisedohet rreth një konkordati mes Serbisë dhe Vatikanit. Duhet cekur se ideja apo fjala për këtë konkordat ishte vetëm për territorin e Serbisë në atë kohë, çka do të thotë se nuk kishte kurrfarë lidhje me territorin e Kosovës, por puna ishte për katolikët në Serbi, sidomos Beograd, Kragujevc e Nish. Mbreti Aleksandër kishte vizituar Vjenën në tetor të vitit 1894 dhe u kishte shprehur edhe qarqeve shtetërore idenë për konkordatin dhe ideja e tij ishte që të bisedohet për një konkordat sipas modelit malazias. Më vonë u muarr vesh se ideja për konkordatin e propozuar nga Serbia ishte që të zvogëlohej apo edhe mundësisht të zhdukej përmes konkordatit fuqia e Austro-Hungarisë në Serbi. Nunci apostolik në Vjenë Antonio Agliardi kishte propozuar përfaqësuesit të Serbisë në Vjenë Djordje Simic se pa autoritetet vjeneze nuk do të ketë bisedime rreth konkordatit. Kështu do të mbetej Austro-Hungaria jo

¹² Krahaso Gottsmann, fq. 433.

vetëm partnere e bisedimeve por edhe mbrojtje e katolikëve në Balkan, konkretisht katolikëve shqiptarë.

Është edhe një gjë e ditur se Austro-Hungaria dëshironte të jetë poashtu pjesëmarrëse e procese gjatë zgjedhjeve të ipeshkvijve në trojet shqiptare dhe dëshironte që përmes argjipeshkvijve të ketë ndikim edhe në popullatë, e të mos ketë telashe në politikë në këtë rajon. Më 1907 ministri austro-hungarez i deklaroi haptas nuncit apostollik në Vjenë se Austro-Hungaria do zvoglon financimet e shkollave, klerit e Kishës në përgjithësi në Shqipëri.¹³ Kjo ishte jo vetëm për klerin katolik por edhe për Vatikanin një shenjë brengosjeje, sepse të gjitha burimet financiare për shkolla, ndërtim objektesh apo edhe shumë imtësi tjera, ishin nga Austro-Hungaria.

Në kohën e argjipeshkvit L. Mjeda, sidomos gjatë luftërave ballkanike protektorati austro-hungarez ishte tejet me rëndësi për popullatën shqiptare. Më nuk ishte rëndësia e protektoratit për të mbrojtur katolikët shqiptarë ndaj turqëve, por në fakt ishte akt politik për mbrojtjen e popullatës shqiptare nga shumë sulmeve të pamëshirshme, sidomos nga ana serbe dhe përmes protektoratit mbroheshin interesat e popullit shqiptar, përveç edhe interesave e monarkisë dualiste. Ballhausplatz-i vjenez nuk ishte më vendi ku “mbronte vetëm katolikët shqiptar” por të gjithë popullatën shqiptare.

Më nënshkrimi e konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë më 1914 ishte de facto edhe përfundimi i protektoratit të Austro-Hungaris në Ballkan, më konkretisht për shqiptarët. De jure zgjati deri më 1918 por de facto me konkordatin e 1914 përfundon. Pasi që kolegu im Zef Ahmeti trajton problemin e konkordatit, nuk do të hym në detaje lidhur me të. Në fakt, konkordati mes Serbisë dhe Vatikanit nuk ishte gjë tjetër, përveç që kishte qëllim zhdukjen e protektoratit austro-hunga-

¹³ Krhs. Gottsmann fq. 434.

rez ndaj shqiptarëve. Bisedimet rreth konkordatit mes Serbisë dhe Vatikanit që ishin zhvilluar qysh më 1894 kishin të bëjnë me territorin e Serbisë, pra pa territorin e Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi. Ato bisedime kishin në fakt të bëjnë me krijimin e një ipeshkvie katolike në Beograd, rreth famullive katolike në Nish, Kragujevc e Beograd e asgjë tjetër me territorin e sotëm të Kosovës, kurse konkordati i 1914 në fakt kishte të bëjë për Kosovën e Maqedoninë dhe ishte kundër protektoratit austro-hungarez.

Me Protektoratin Austro-hungarezë në bazë të marrëveshjeve me shqiptarët dërgon në Shqipëri misionarë dhe hapë shkolla katolike dhe ndanë subvencione dhe ndihma tjera për të ndihmuar edhe ngritjen dhe mirëmbajtjen e objekteve fetare katolike. Këto ndihma ndihmuan që populli shqiptarë të zhvillohet dhe të konstituohet. E këto gjëra i pengonin Serbisë.

Do ti kthehemi prap Argjipeshkti Trokshi. Lidhur me Trokshin shkruan edhe nunci apostollik në Vjenë Emidio Taliani raportin e shkruar më 20. gusht 1900. Është i njohur edhe konflikti i Pashk Trokshit rreth motrave të Prizrenit dhe qështja Austro-Hungarisë por kjo ka një histori më argjipeshkvin Fulgenije Carev. Argjipeshkvi Fulgenije Carev¹⁴ ishte shtetas austro-hungarez. Është e njohur që Carev dëshironte që argjipeshkvia Shkup-Prizren të shtrihej me kufijt e saj deri edhe në Selanik. Ai quhej edhe "Ipeshkvi i Austro-Hungarisë" sepse "përfaqsonte" interesat e Austro-Hungarisë. Për këtë gjë, autoritetet turke e kishin shibël në sy argjipeshkvin Carev. Atë e burgosin dhe kishin qëllim që të izolohet nga popullata krishtere e argjipeshkvisë Shkup-Prizren". Ai rezidonte në fillim në Prizren por më vonë ishte i obliguar të shkon me rezidencë në Shkup. Rezidencën e vet në Prizren iu dorëzon në shërbim motrave fraçeze që të hapin shkollën në Prizren më

¹⁴ Mbi argjipeshkvin Carev shih më gjërësisht: VELNIC Teofil: Fulgencije Carev, nadbiskup, Pazin 1961.

1890. Kurse me ardhjen e argjipeshkvit Pashk Trokshit, vendos që rezidencën ipeshkvore të rivendoset në Prizren. Pasi që në rezidencën ipeshkvore të Prizrenit ishin motrat, Trokshi vendosi qi marrë për banim disa dhoma në atë rezidencë, kurse motrat të vazhdojnë shkollën që kishin për fëmijët e Prizrenit. Austro-Hungaria nuk kishte qëllim që Franca të ketë ndikim mbi të krishterët në argjipeshkvinë e Shkupit. Kështu që me ndikim të Austro-Hungarisë largohen motrat franceze nga Prizreni dhe vendosen motrat nga Zagrebi.¹⁵ Ishte pra problem rreth rezidencës ipeshkvore, për të cilën Trokshi ra në konflikt me Austro-Hungarinë. Trokshi ishte i mendimit se rezidenca ipeshkvore ti rikthehet argjipeshkvit dhe motrat të ndërtojnë një godinë tjetër. Rikthimi i Trokshit në Prizren mendohej nga ana e tij se Prizreni ishte edhe afërsia gjeografike më e përshtatshme për të gjitha famullitë e argjipeshkvisë. Pas Pashkëve të vitit 1898 Trokshi vizitoi Vjenën dhe Romën dhe u pas një marrëveshje pajtuan që të tre, që me financa të veta Austro-Hungaria rezidencën ipeshkvore të ndërton në Prizren, ku Trokshi më 1900 u kthye në argjipeshkvi dhe filloi punën në këtë rezidencë. Popullata katolike dëshironte që Trokshi të rikthehet në argjipeshkvi e jo të lëshonte atë. Popullata nuk dëshironte të shkonte as në kishë, as nuk dërgonte fëmijët në shkollë apo kishë, kështu që kishte edhe të tillë që mendonin se më mirë të largohet konsulata austro-hungareze sesa argjipeshkvi Trokshi. Nga kjo ngjarje lindi edhe ajo që quhet “Kanga e milletit të Prizrenit” që shënoi Krist Maloki¹⁶. Do ti sjellim disa rreshta të vjerrshës popullore që e përshkruan gjendjen e atëhershme edhe mes Austro-Hungarisë dhe të Trokshit, por edhe çështjen e motrave në Prizren:

...

¹⁵ Hrabak, fq. 49, Zefi, fq. 32.

¹⁶ Maloki, Refleksione, fq. 239-242.

Por kta krenë në kishë u mluedh
E kët leter muern'e knuene
Argjipeshkvi qi kish shkruue
"Mue konakin ma kan zaptue"
U mluedhne krent e kuvenojn:
"E ket punë qish t'ja bojm?
Nja dy vetë te korçlla t'i çojm
E ket punë tëja kallxojm!"
Ata dy vetë korçllës i thojn
"Virgjineshat nuk i dojm,
Deri të honen na të presim,
Virgjineshat per krahi i qesim!"
Qe ky korçlla fort serbes
I tha krenëve: "Mirrni vesh,
Mirrni vesh, se keni gabue,
Papa Shejt fjalë ka çue,
Ju bre krenë shka keni mshtillue,
Konaki i ri ka me u vnue,
Per ket punë keni gabue,
Virgjineshat s'kan m'u çue!"
Ky mileti po kuvenojn,
Në ungjill be të bojn:
"Për pa u ndreqë puna e jonë
Na në kishë mos të shkojm!"
I madh e i vogël u çuenë vikamë
Thanë: "Myhyr hajde të vandojn
Virgjineshat nuk i dojm"

...

Ajde të shkojm na në Romë,
Atje ndreqet puna jonë!"
Këta në Romë por sa hine,
Por te Papa nuk mund të hine,
Por ni letër muern'e shkruene,
Papës Shejt ja kallxuene:

"Kët rixha me na nigue,
 Ne mileti na ka çue,
 E konakin me lëshue!"
 Papa Shejt i dha xhevap:
 "Unë veqil po çoj ni frat,
 Veç Veqilin m'e nigiue!"
 Ky veqili hyqymdar
 Shikion punët të gjithë mbarë,
 Për këtë punë mbet tuj pëvetë:
 "Qush ansht mshtillue ky milet!"
 Duel Veqili e predikoj:
 "Unë këtë letër po kallxoj,
 Papa Shejt qi ka shkrue,
 Mue të kshtenët me më nigue,
 Papa Shejt m'i tha dy fjalë
 E në kishë keni me ardhë,
 Se m'u çue Shypnija mbarë
 Virgjineshat s'kan me dalë!"
 Këta dy vetë qi kenë në gyrbet
 Si haxhi erdhne opet,
 Haxhi Krista e haxhi Shtjefni,
 Mbet si i dhinë gjithë mileti...

Sipas kësaj kënge shifet shumë qartë se sa ishte tensionuar gjendja mes argjipeshkvit dhe konzullatës austro-hungareze, poashtu edhe shifet shumë qartë se si ishte qëndrimi i popullatës katolike në Prizren.

Trokshi edhe pse ishte në konflikt me Austro-Hungarinë, prap kishin raporte të mira mes veti, për interesa të dyanshme. Më 1897¹⁷ kërkon Trokshi që që 5 student nga ipeshkvia e tij Shkup-Prizren të vijnë në seminarin (shkollën e mesme)

¹⁷ HHStA A.R, F 27/K. 49, Mission Albanien 1871-1911, Albanische Seminaristen in Innsbruck.

dhe të studijojnë teologjinë diku në Austri e të edukohen në qarqet austriake. Nuk di se a kërkon të njëjtën gjë edhe prej Francës (duhet hulumtuar), por prapseprap dëshiron që djelmoshat nga aripeshkvia të shkollohen në Austri.

Trokshi kishte vështirësi të mëdha edhe me autoritetet turke. Autoritetet turke ishin poashtu edhe ato që nuk e dëshironin Trokshin ipeshkëv. Një skandal që ndodhi në afërsi të Gjakovës, pra, ku u profanizua xhamia në rrethin të Gjakovës dhe që popullata muslimane shqiptare dhe autoritetet turke e ngarkonin argjipeshkvin Trokshin se ai kishte ndërmarr diçka të tillë. Arsyetimet e tia ishin të kota, kështu që Trokshi i ofron dorëheqje Papës Piut X më 1903. Dorëheqja e tij u muarr më vonë parasysh, dhe ishte ftuar më 1908 në Romë. Trokshi ishte emëruar poashtu edhe ipeshkëv titullar i ipeshkvisë Nacolia Nacolen(sis) në Azi të Vogël prej 29. 04 . 1908 deri më 29. 07. 1917. Për vdekjen e Trokshit ka disa vite, sikur më 1909, 1910, por Imzot Pashk Trokshi kishte vdekur më 29. 07. 1917. Pasi që ai ishte penzionuar dhe kishte jetuar në Romë prej 1908 deri në vdekjen e tij, nuk kemi shumë gjëra të shunuar për qëndrimin e tij Romë. Këtu kemi edhe një gjë që duhet cekur se Austro-Hungaria nuk dëshironte që Argjipeshkvi Trokshi të mbeste argjipeshkëv në argjipeshkvinë.¹⁸

Para ardhjes së argjipeshkvit Mjeda në Prizren, argjipeshkvinë e udhëheqte Nikolla Glasnovic nga Janjeva, që kërku-nd nuk cekët se ishte administrator apostolik i argjipeshkvisë Shkup-Prizren ishte Nikolla Glasnoviqi. Nuk duhet ndrruar Nikolla me Toma Glasnovic, sepse Nikolla Glasnovic ishte administrator para ardhjes së L. Mjedës, kurse Toma Glasnovic ishte kur Mjeda largohet nga argjipeshkvia. Që të dy vijnë nga e njëjta familje nga Janjeva. Nikolla Glasnovic kishte udhëhequr më shumë se një vitë arqipeshkvinë Shkup-Prizren.

¹⁸ Gjini Gaspër, Ipeshkvia Shkup-Prizren, fq. 202.

II. Emërimi i Lazër Mjedës argjipeshkëv në Prizren

Këtu do të trajtojmë disa nga dokumentët për Lazër Mjeda që gjinden në dosjen e veçar në arkivin shtetëror austriak të Vjenës. Dosja quhet „Miedia“.¹⁹ Sidomos ka të bëjë me emërimin e tij në Prizren dhe karakteristikat se çfarë personi është Mjeda.

Kur Mjeda emërohet për dioqezën e Prizrenit kishte 40 vjet. Për prift shugurohet në vitin 1891. Gjatë punës së tij si prift kishte qenë mjaft i respektuar për besimtarët dhe vetë ipeshkvin Marconi, i cili më vonë e bënë atë sekretar të vetin, dhe njëkohësisht edhe këshilltar. Këtë detyrë ai e kishte ushtruar deri në kohën kur ai emërohet ipeshkëv i Sapës në vitin 1901. Ai kishte qenë shumë aktiv në punët administrative në ipeshkvin e tij. I kishte fituar besimtarët e vet sa kishte lënë përshtypje të jashtëzakonshme tek grigja e vet. Më 1905 emërohet ipeshkëv i Shkodrës e koadjutor i kësaj argjipeshkëvie, që do të thotë se pas argjipeshkëvit Pashk Guerini, sipas ligjit (kanonit) kishtar L. Mjeda duhet të ishte argjipeshkëv i argjipeshkëvisë së Shkodrës.

Ndërsa emërimi i tij për të kaluar në dioqezën e Prizrenit kishte lënë përsëri çështjen e hapur në Shkodër, se cili do të jetë pasardhësi i monsinjor Guerinit. Emërimi i tij për detyrën e re në argjipeshkëv i argjipeshkëvisë Shkup-Prizren, ishte bërë pa dëshirën e Mjedës dhe kishte krijuar edhe në Shkodër “rrëmujë” tek kleri e populli, sepse Mjedën nuk dëshironin të lëshonin nga Shkodra. Poashtu edhe Austro-Hungaria e kishte këtë dëshirë, pasi që Shkodra ishte vend shumë me rëndësi jo vetëm për Kishën katolike, por edhe për politikën ballkanike.

Më 24 prill 1909 lajmron nga Roma konzullata Austro-Hungareze Vjenën se për argjipeshkëv të argjipeshkëvisë Shkup-Prizren është emëruar Lazër Mjeda, kurse Kardinal

¹⁹ Dosja e Mjedës gjendet në HHStA, MDAE, AR 27, Bischöfe-Miedia.

Gotti shpreson se Mjeda do të akcepton dekretin që do ti dërgohet.²⁰




Faksimil nga telegrami i konzullatës austro-hungareze në Romë më 24 prill 1909

Më 2 maj 1909 i shkruan Vjenës konzulli Kral nga Shkodra se në Shkodër kishte ardhur nga Vatikani dekreti se Lazër Mjeda është emëruar për argjipeshkëve Shkup-Prizren. Konzulli Kral shkruan se kjo është një disfatë e madhe për

²⁰ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 2 telegram i Konzullatës austro-hungareze në Romë më 24 prill 1909 ku lajmron për emërimin e Mjedës (shih faksimilin).

politiken austro-hungareze ndaj shqitparëve, sidomos për Shkodrën nuk do të jetë edhe mirë ky emërim. Konzulli Kral kërkon që të ndërmerren masat përkatëse që ky dekret të anulohet.²¹




Faksimili i telegramit të konzullatës austro-hungareze në Shkodër 2 maj 1909

Konzulli austro-hungarez në Prizren Prohaska lajmron konzullatën e Shkodrës më 7 maj 1909 se në Prizren kishte arritur lajmi për emërimin e koadjutorit të Shkodrës L. Mjeda

²¹ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 4, telegram i Konzullatës austro-hungareze në Shkodër 2 maj 1909 (shih faksimilin).

për argjipeshkëv të argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Kjo ishte një befasi edhe për meshtarët e kësaj argjipeshkvie, pasi që dihet se Mjeda ishte koadjutor i Shkodrës.²²



Faksimil nga telegrami i konzullatës austro-hungareze në Prizren në 7 maj 1909

Më 8 maj 1909²³ shkruan konzulli Kral se emërimi i Mjedës është sukses i Italisë dhe humbje e Austro-Hungarisë

²² HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, fq. 5, telegram i Konzullatës austro-hungareze në Prizren në 7 maj 1909.


²³ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 7 telegram i Konzullatës austro-hungareze në Shkodër më 8 maj 1909.

dhe se disfata më e madhe do të ishte nëse për argjipeshkëv të Shkodrës do të emërohej apo së paku nëse do të vinte në diskutim Sereqi, sepse nuk është aspak në gjendje ta udhëheq argjipeshkvinë e Shkodrës, dhe përball politikës austro-hungareze është shumë kritik. Konzulli kral shkruan se argji-peshkvi Guerini, popullata dhe shumica e klerit katolikë të Shkodrës janë kundër këtij emërimi.

Me 6 maj 1909²⁴ shkruan konzulli Kral se elita katolike e Shkodrës kishte kërkuar nga ai që Mjedën mos të lejoj të shkon në Prizren, sepse kjo do të ishte një humbje shumë e madhe jo vetëm për Shkodrën por edhe për tërë rajonin. Në këtë letër shkruan konzulli se emërimi i Mjedës për në Prizren shifet si një disfata e madhe për austro-hungarinë dhe fitore për Italinë, kështu shkruajnë edhe mediat e asaj kohe në Shqipëri, shtonë ai. Mjeda ishte njëri i pjekur dhe më i përshtatshmi për të trashëguar Guerinin dhe Guerini ishte shumë i pakënaqur për largimin e Mjedës nga Shkodra. Kur ishte emëruar Mjeda për Prizren, nuk ishte prezent në Shkodër, sepse ishte jasht Shkodre dhe do të kthehej pas një muaji, kështu që çka mendonte ai për këtë punë, nuk dihej ende. Kurse Guerini fliste për një pakënaqësi të madhe që do të ndodhë në argjipeshkvinë e Shkodrës, nëse Mjeda nuk do të mbetën në Shkodër, sepse Guerni nuk mund të paramendonte asnjë meshtar tjetër që do të mund ta udhëheqë argjipeshkvinë e Shkodrës, përveç Mjedës. Ai është edhe i dashur edhe i aftë për shumë gjëra. Konzulli Kral shkruan se duke e njohur karakterin e Mjedës se si është, beson se ai nuk do të kundërshtonte këtë punë, sepse është i dëgjueshëm, edhe pse nuk do të pëlqente. Është folur edhe më parë për transferimin e Mjedës për në Prizren dhe atëherë është biseduar se kjo mund të vijë nga intrigat italiane, dhe poashtu edhe fryti e dëshira e

²⁴ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 9, raport i konzullit (Kral) austro-hungarez në Shkodër të 6 majit 1909. (shih faksimilin).

Sereqit dhe të abatit Doçi, që nuk do të mund të parame-
ndonin Mjedën si argjipeshkëv të Shkodrës. Është shumë inte-
resant se shumë malsorë dhe katolikë të ipeshkvive tjera
shqiptare, nuk dëshironin të kishin punë me ipeshkvijtë e vet
të asaj ipeshkvie ku i përkisnin, por kërkonin rregullisht
këshillat apo ndihmën e L. Mjedës, edhe pse nuk ishte Mjeda
përgjegjës për ata katolikë, sidomos malsorët e të gjithë ipesh-
kvive të Shqipërisë konzultoheshin me Mjedën dhe ai kishte
ndikim shumë të madh në ta dhe u ndihmonte malsorëve
shumë. Për Austro-Hungarinë ishte disfatë politike emërimi i
Mjedës për Prizren, sepse argjipeshkvia e Shkodrës ishte
shumë me rëndësi jo vetëm për Shkodrën por për tërë rajonin.
Konzulli kishte biseduar edhe me argjipeshkvin Guerini, dhe
ishin marrë vesh që mos të shikohet në ndonjë kandidat tjetër
që do të mund të trashëgonte Guerinin.



und Föhler und auf seine Haltung haben könnte.

Mg're Miedis war um höher stets loyal ergeben und hatte sich um diesen Grunde die offene Begewehrhaft der Italiener und Jener zugewogen. Die seiner Hoffentlichung der italienischen Aethlonen auf politischen und kulturpolitischen Gebiete Vorrecht leisteten.

Der den Italienern nahestandende Teil des Kleris fürchtete daher seit längerem nichts sehr als die definitive Bekrueung des Bannwortes mit der Funktion des Erzbischofes von Skutari, da er eine stärkere Hand vorzuziehen -

Die Agitation dieser Partei machte ihn in den ersten Jahren seines klösterl. Wirkens nicht geringe Schwierigkeiten. Doch gelang zu seiner Freude und einem schriftl. Auftrahen, aller Hindernisse Herr zu werden und sämtliche Bannur zum Schweigen zu bringen. Man übermugte sich eben, dass seine Ziele aufrechtzulegen und vorkaufsmüthlich waren und dass er nicht aus gerechthelcher Eitelkeit handelte, wie seine bekannnten Rivalen, sondern das Gute wollte. Dies sowie seine loyalen Verhältnisse in der Alphabetfrage sowie in den sonstigen nationalen und literarischen Angelegenheiten, inwieweit er Mg're Docht in wirklich edler Weise seine Hand zur Hülfsung

Die ganze Offenlichkeit nicht zerkwürdnigswertes in derselben eine Niederlage unserer Politik und einen Sieg der Italiener, was deren Freistige hier ausserordentlich zu Gute kam.

Sehr bestürzt zeigte sich Mg're Cocchini, der so sehr er beacht war, reservierte Angelegenheiten des Klerus, den Verkehr mit Rom und die Behandlung gewisser prinzipieller Fragen in seiner Hand zu kanstrieren, an Mg're Miedis doch eine kaum ersetzbare Stütze in der Jurisdiktion, in der Administration der Kreditkasse, sowie in Verkehrs mit der türkischen Behörden und der Bevölkerung hatte. Der Herr Erzbischof bezeichnete diese, gegen seinen Willen erfolgte Ernennung direkt ein Unglück für die Kreditkasse, da er unter der Abwesenheit keinen Einflügen abzu, der würdig und teleischlich fähig wäre, den erzbischöflichen Stuhl von Skutari einzunehmen. Er nannte jene Maaßnahme als Unikum in seiner Praxis, da Mg're Miedis Coadjutor mit dem Recht der Nachfolgerschaft war und die Verechtung nach Skutari eine Art Kultstellung für ihn bedeuete. Er bot anzuschließen, in Rom ernote Vorstellungen gegen die Durchführung zu erheben und ersuchte auch sich, H. H. Excellenz um gnädige sach-erhöchliche Verwendung in diesem Sinne zu bitten.

Ich sagte Mg're Guerin.....die betreffende

weggenussfreude, eroberte ihn die Sympathien der ganzen Bevölkerung.

Ungewiss begünstigt war sein Wirken als Beschützer der Hellenen. Für deren Bedürfnisse und Leiden er liefen Verordnungen besann, deren Gerechtigkeit er unbedingte und deren öffentlichen Angelegenheiten er besorgte, namentlich den türkischen Behörden gegenüber. Sein Einfluss in der Halbinsel war daher ein überragender, was einen günstigen Grund für unsere Politik bedeuete, und ist charakteristisch, dass sich sogar die Bergbewohner der übrigen Diözesen an ihn und nicht an den Kompetenten Stabur wandten.


Die Vertraulichkeit und Güte seiner Wesens kamt in den ausgezeichnsten Verhältnissen zum Ausdruck, in welchen er seit vier Jahren zu Mg're Guerin stand, trotzdem es absehbar nicht leicht ist, mit diesem greisen, oft eigenartigen Herrn Politikern friedlich zusammenzukommen.

Durch die Entfernung Mg're Miedis's wird die seit Jahren gelüste Frage der Ernennung eines Nachfolgers für Mg're Guerin wieder offen, was für die Entwicklung der Verhältnisse in der Kreditkasse schädlich ist und auch unserer Stellung sehr leicht gefährlich sein kann. Es scheint mir nicht möglich, dass diese Frage ohne Erregung von Spaltungen, Ver-

örterung fand am 2. d. M. statt.....zu, entsprechend seines Versuchs zu handeln, wurde ihm aber von den Inhalt des mitlerweile eingetroffenen hahen Dittrefftelegrammes H. H. Excellenz von 4. d. M. 30 Kenntnis geben.

Den Deputierten der Bevölkerung und des Klerus geb ich ausweichende Antworten.

Die Mg're Miedis selbst seine Verstrung beurteilt, ist noch nicht bekannt, da er in Vertretung Mg're Guerin's auf der Diözesanreise abwesend ist und noch ungefähr vier Wochen nachbleiben dürfte. Nach seinen früheren Aeußerungen über die schon längst in Umlauf gewesenen Gerüchte betreffend seine Transferierung in schlussam, ist jedoch voranzunehmen, dass er dieselbe als unvermeidliche Erkrankung und Zurücksetzung empfinden wird. Angemessenes ruhigen, gefügigen und krankhaften Hergewiesenen baren Charakteres ist indessen anzunehmen, dass er seinen neuen Posten, ohne auch nur Widerrede zu erheben, beziehen werde. Er dürfte in der Vertretung vorzüglich des Herr Mg're Jereggi's und Mg're Duchi's, die ihn seine Erhebung zum zukünftigen Erzbischof von Skutari als verdienen konnten und die Früchte der italienischen Intriguen sehen. Allerdings ist zu befürchten, dass die erwähnte Maassnahme nachteiligen Einflusses auf sein Denken



Faksimil i raportit të konzullit (Kral) austro-hungarez në Shkodër të 6 majit 1909.

Argjipeshkvi i Shkodrës Guerini më 30 mai 1909²⁵ kishte kërkuar nga konzulli austriak Kral që të angazhohet edhe me shkrim që Mjeda të shkon së paku për disa muaj në Prizren e pastaj të kthehet në Shkodër ku do të mund të merrë postin e argjipeshkvit të Shkodrës. Guerini nuk kishte pranuar që të emërohet asnjë ipeshkëv koadjutor të Shkodrës, por me çdo kusht kishte dashur që Mjeda të mbesë apo të vjenë prap në Shkodër pas disa muajsh që të kalon në Prizren. Ideja e Guerinit ishte që Mjeda të shkon për një kohë të shkurtër në Prizren e prap të kthehet në Shkodër. Poashtu ideja e tij ishte që patjetër të emërohet një shqiptar në Shkodër, pasi që të huajt nuk e njoftin mirë popullin shqitar.

²⁵ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 11. raport i konzullit (Kral) austro-hungarez në Shkodër të 30 mai 1909.

Një raport lidhur me Mjedën dhe jetën e karakterin e tij shkruan konzulil Kral më 1 qershor 1909 një raport interesant.²⁶ Në këtë raport shkruan konzulli se Mjeda ishte i "rrespektuar nga të gjitha anët", pastaj shifet se puna e zelli i tij janë gjëra shumë të rëndësishme për të, dhe thekson se ai ishte pasardhës juridik i argjipeshkvit të Shkodrës Guerini dhe se emërimi i tij për Prizren ishte pa dijeni dhe dëshirën e tij. Në këtë letër thuhet se emërimi i Mjedës për Prizren ishte edhe një lloj intrige e klerit italian dhe atë shqiptarë sidomos në Shkodër që simpatizonte më shumë Italinë sesa Austro-Hungarinë dhe dëshironin që Mjedën ta largonin nga Shkodra. Sipas këtij raporti, argjipeshkvi i Shkodrës Guerini kishte simpati dhe rrespekt shumë të madh ndaj L. Mjedës. Më tutje vazhdon se Mjeda është njëri që me drejtësi dhe korrektësi ka fituar simpati në argjipeshkvinë e Shkodrës. Puna e tij karakterizohet me dashuri dhe interesimi për popullin dhe të mirën e tij. Popullata e Shkodrës edhe argjipeshkvi Guerini dëshironin që emërimin e Mjedës për Prizren ta anulonin. Guerini dëshironte me çdo kusht që të ketë Mjedën pasardhës të vetin. Poashtu edhe popullata katolike kishte bërë kërkesë që Mjeda të ndalet në Shkodër e mos të shkon në Prizren. Argjipeshkvi Guerini kishte pasur idenë që nese nuk funksionon anulimi i emërimit të Mjedës për Prizren, Mjeda mund të shkon për disa muaj në Prizren e pas një kohe të shkurtër Guerini të jep dorëheqje vullnetare si argjipeshkëv i Shkodrës e kështu në këtë mënyrë të vijë pas disa muajsh Mjeda prap në Shkodër ku do të mund të jetë argjipeshkëv i Shkodrës.


Për karakterin e Mjedës shkruan konzuli Kral se është i krishterë shumë i devotshëm, shumë i drejt, nuk është egoist,

²⁶ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 14, raport i konzullit (Kral) austro-hungarez në Shkodër të 9 qershor 1909.

është shumë inteligjent, i zellshëm, i qetë dhe energjik. Ka jetën private shumë të thjeshtë, marol shumë të lartë, është njeri që shikon përpara, dëtyrën e vet të kryen taman si duhet. Një karakteristikë e tij shumë e mirë është që ai lufton për mirëqenjen e popullit dhe të klerit dhe përkrah në të gjitha mundësitë e veta për përparimin e popullit dhe klerit. Është njeri që flijon vetëvetën e të mund të ndihmon popullin e klerin. Është patriot shumë i mirë dhe ka prirje shumë të mirë letrare. Përball Austro-Hungarisë dhe protektoratit është shumë korrekt, lojal dhe përherë në shërbim. Mjeda kërkon përherë poashtu edhe prej Vjenës korrektësi dhe përkrahje. Nëse Mjeda bënë ndonjë kërkesë financiare nuk e ka për motive personale por kërkon për të mirën e tërë popullit shqiptarë apo për të mirën e katolikëve shqitparë. Nuk e tepron në kërkesa për përkrahje financiare që bënë ai. Ai kishte jetuar në Sapë në një rezidencë të thjeshtë, ku për përkujdeje shtëpiake kishte pasë nënën e vet. Pasardhësi i tij i Sapës, të parën kërkesë që kishte bërë tek konzullata austriake, kishte bërë ndërtimin e një shtëpia luksoze dhe me shumë financiare të tepraur. Mjeda në Shkodër si ipeshkëve ndihmës (koadjutor) ishte i kënaqur me një dhomë të thjeshtë. Përshkruhet edhe karakteri i nënës së Mjedës, që kishte pas lidhje shumë të mira me djalin e vet Lazrin. Në moshën e re që gjindet, nuk i jep rëndësi pra gjërave personale, por për të mirën e popullit. Udhton rrugë të gjata - e nganjëherë edhe tërë javën, e shpesh edhe shumë të vështira nëpër vende malore në argjipeshkvinë e Shkodrës apo edhe më gjërë dhe kështu shfrytizon të njëjtën kohë raste të ndryshme për tu njoftuar sa më afër gjendjen e popullit dhe klerin shqitparë, pra dëshiron që të shof vet nga vendi gjendjen e popullit dhe klerit.

Me menqurinë e vet, dinte që ti bind edhe organet lokale turke për ndonjë rast nese ishte nevoja. Konzullata austriake në Shkodër e vlerëson shumë këtë gjë, sepse nuk

kishte më gati nëvojë të interventonte për imtësira tek organet turke. Organet turke ishin shumë mirë në dijëni se Mjeda kishte ndikim shumë të madh tek malsorët shqiptarë, kështu që edhe nuk dëshironin të hynin në kurfar konflikti me Mjedën për shkak të ndikimit të malësorëve që ai kishte, sepse malsorët do të mund tu nxirreshin telashe turqëve. Të njëjtën kohë Mjeda sihte njeri që malsorët i njihte shumë mirë, sidomos kur ishte puna e ndërmjetësimit në konflikte të ndryshme dhe i zgjidhte problemet ashtu si duhet.



In Erledigung der wehldertigen Zuschrift vom 13.v.M.2.230 res. beschre ich mich dem löblichen k.u.k. Konsulate folgende vertrauliche Mitteilungen über das kürzlich zum Erzbischof von Skopje ernannten hiesigen erzbischöflichen Koadjutor, Mgre Lazzaro Miedia, zu machen :

Mgre Miedia, ein gebürtiger Skutariner, ist gegenwärtig 40 Jahre alt. Seine Studien vollendete er zur Gänze am „Collegio Pontificio“ in Skutari, zu dessen besten Schülern er während seiner ganzen Studienzeit zählte. Er wurde im Jahre 1891 zum Priester geweiht, zugehörig der Diözese von Palati. Mgre Miedia zeichnete sich schon als Seelsorger durch Ernst und Fleiß sowie durch grosses Verständnis für die Bedürfnisse der ihm anvertrauten Pfarrkinder aus, so dass er allseitige Achtung genoss und von Bischof Marconi als Sekretär und Ratgeber verwendet wurde, welche Würde er bis zu seiner Kreuznung zum Bischof von Sapa, im Jahre 1901, bekleidete.

Als Bischof von Sapa war er unermüdlich in der Administration seiner Diözese tätig, die er,

ungachtet der grossen Beschaulichkeit, häufig be-
rührt. Seiner väterlichen Fürsorge für Volk und
Klerus war es ausserdies, dass er bald unter bei-
den ein ausserordentliches Ansehen gewann, das auch
nach seiner Trennung von der erkrankten Diözese un-
geachtet weiterbestehen blieb.

Im Jahre 1900 erhielt Mgr. Miedia den Ti-
tel eines Erzbischofs von Areepolis und wurde bald
darauf zum Koadjutor des grossen Primas von Albanien,
Mgr. Pargusis Guerini in Skutari, mit dem Rechte der
Nachfolge bestellt. In dieser Eigenschaft verblieb
er bis zu seiner kürzlich erfolgten Ernennung zum
Erzbischof von Prizren, welche Ernennung ohne sein
Wissen und gegen den Willen des Herrn Erzbischofs,
mit welchem er in ausgezeichneter Harmonie und Ein-
tracht lebte, erfolgte. Seine Entfernung von Skutari
muss als Ausfluss direkter italienischer Bestim-
mungen beim Heiligen Vater und als Folge von intriguen sei-
ner persönlichen Gegner unter den übrigen Prälaten
und unter der Skutariner Städteligkeit, welche
alle sehr oder weniger offen mit der italienischen
Propaganda in Albanien sympathisieren und sich in
ihren Ambitionen auf italienischem Einflusse stützen,
betrachtet werden. Der weltliche überwiegende Teil des
Klerus aber, sowie die gesamte katholische Bevölke-
rung der Erzdiozese und der Erzbischof Mgr. Guerini

**Wissenschaftliche Ergebnisse der Arbeit und einige
Daten über die Persönlichkeit des Djalova.**

Seine Dichtung umfasst Mysterien aus dem 18. Jhdte.
Der Charakter des Djalovisten ist durch die Arbeit
erleuchtet, daß nach ihm die ausgegangenen Mysterien, welche
in dem 17. Jhdte von den mündlichen Dichtern
erzählt wurden sind.
Der Djalovist ist ein Mensch, der aus dem
geistlichen Stande, die verschiedensten ausländischen
Mysterien aus dem 18. Jhdte erlernt haben, welche
dann in dem 17. Jhdte in dem Djalovisten
ausgesprochen sind.
Der Djalovist ist ein Mensch, der aus dem
geistlichen Stande, die verschiedensten ausländischen
Mysterien aus dem 18. Jhdte erlernt haben, welche
dann in dem 17. Jhdte in dem Djalovisten
ausgesprochen sind.
Der Djalovist ist ein Mensch, der aus dem
geistlichen Stande, die verschiedensten ausländischen
Mysterien aus dem 18. Jhdte erlernt haben, welche
dann in dem 17. Jhdte in dem Djalovisten
ausgesprochen sind.

Neue Freie Presse, 21 mars 1913 mbi vrasjen e Alois Paliqit.

Gjergj Fishta për rastin e vrasjen e Alois Paliqit shkruajti poezinë me 14 strofë “Mbi vorr t’ A. Alois Paliq, O.F.M.” (botuar te libri Mrizi i Zanave). Paliqit dhe Fishta njifeshin edhe personalisht, pasi që të dy ishin nga e njëta provincë françeskaneshqiptare.

- 1. Barbarët... e mbyten! E pra
- Ky ‘i dhunë kurrkuj s’ia bani;
- Nuk bāni kand me kja:
- Per t’keq s’i duel kurr zani;
- Per Atme e shejten Fé
- Punoi me t’ drejtë m’ket dhé.
-
- 14. Prandej o Zot, prej qiullet
- Ti priiri syt mbi né

67 Leo Freundlich, Albanians Golgotha, fq. 28-29.

E bân qi puna t'kthiellet,
Si âsht mirë për Atme e Fé;
E gjaku i ktij Meshtarit
T'kjoftë falë per komb t'Shqyptarit.

Me nënshkrimin e konkordatit ishte ideja se do të mund të përmirësohej gjendja e Kishës Katolike në argjipe-shkvinë Shkup-Prizren. Dihet se protektorati austriak pas 1912 ishte shumë vëshirë të praktikohet në territorin e ipeshkvisë. Pra, Serbia dhe Mali i Zi kishin vetëm një qëllim, okupimin e këtyre trojeve e asgjë tjetër. Përdornin metodat më brutale ndaj popullatës shqiptare, sidomos në vitin 1913 e 1914 dhe nuk kursenin as meshtarët katolik që burgosnin apo vritin, siç ishte rasti i Aloiz Paliqit⁶⁸ e disa të tjerëvë më vonë. Vatikani e shihte këtë rrezik që i kanosej popullatës katolike shqiptare. Dhe e vetma mënyrë që ndoshta do të rregullonte disa gjëra juridike, apo ti mbronte të drejtat e kësaj popullate, ishte që të nënshkruhet konkordati; kjo ishte një lloj shprese për kohët që vinin. Këtë e shrpeh edhe Vatikani se mosnënshkrimi i konkordatit mes Serbisë dhe Vatikanit do të thotë edhe një lloj shkaku që ti trajtojnë edhe më keq katolikët në Serbi.⁶⁹ Në arenën ndërkombëtare tentonte Vatikani që të drejtat e shqiptarëve katolik ti mbronte dhe mendonte se me nënshkrimin e konkordatit do të arrin këtë. Papa Piu X ishte kundër një konkordati mes Vatikanit dhe Serbisë,⁷⁰ sepse e dinte përmes raporteve që i dërgoheshin Vatikanit se si ishte gjendja e shqiptarëve në argjipeshkvinë Shkup-Prizren. Dihet se Mjeda kishte dërguar shumë raporte në Vatikan për këtë punë. Pas

⁶⁸ Aktet dhe të gjitha informacionet për vrasjen e Alois Paliqit gjinden në arkivin e Vjenës. Poashtu edhe angazhimi i Mjedës për ndriqimin e këtij akti janë në HHStA PA XII 416-1-1 (Ermordung des P. Luigi Palic).

⁶⁹ Krah. Cornwell, Papst Pius fq. 77.

⁷⁰ HHStA, PA, Türkei XLV, nr. 416 / 5, Raporti i Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein, nr. 1147 dhe 1872.

pak kohe zyrtari Austro-Hungarez Graf Pafly me 18 gusht 1913 ishte në audiencë në Vatikan tek Papa. Në këtë audiencë papa ishte shprehur shumë ashpër për gjendjen e shqiptarëve sidomos të katolikëve në Ballkan, sidomos në territorin e argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Papa ishte shumë i brengosur dhe ishte shprehur kështu: *sono tutti quanti barbari*” dhe ishte shprehur se pa protektoratin austro-hungarez nuk do të jetë mbrojtja efiqase e katolikëve në Ballkan edhe nëse vendoset të nënshkruhet konkordati me Serbinë.

Nënshkrimi i konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë më 1914 mendohej se do të sjellte një gjendje më të volitshme të katolikëve të këtyre trojeve. Për një marrëveshje ishte edhe vet argjipeshkvi Lazër Mjeda i shkruan ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz më 09. janar 1913 lidhur një marrëveshje zyrtare mes Vatikanit dhe Serbisë. Ndër të tjera shkruan Mjeda lidhur me një marrëveshje zyrtare ministrit austro-hungarez kështu: *“Pra, del qartë se nga kjo qeveri e tillë nuk mund të pritete një liri fetare. Pra, kërkohet që Qeveria Mbrojtëse e Lartëma-dhërishmit Perandor, që deri më tash ka bërë kujdes për këta të krishterë, të përpiqet të gjejë një mjet për të garantuar lirinë e plotë fetare e kombëtare. Dhe mjeti do të ishte ose, të arrish një mbrojtje efiqase, ose të detyrosh Serbinë të arrijë në një marrëveshje me Selinë e Shenjtë. Them mbrojtje efiqase, sepse një mbrojtje vetëm emrërore, ose e spjeguar butësisht do të ishte më e dëmshme për arbërorët katolikë, të cilët për shkak të saj do të konsideroheshin si armiq të shtetit, e do të trajtoheshin në mënyrë më të keqe. Me këtë rast do të ishte më e dëshirueshme një marrëveshje me Selinë Shenjtë”*.⁷¹

Në janar të vitit 1914 L. Mjeda kishte udhtuar për Romë për të biseduar rreth konkordatit të mundshëm dhe nga aty kishte njoftuar Vatikanin lidhur me situatën në argjipeshkvinë e vet dhe se diplomatët beogradas ishin të shqetësuar për

⁷¹ Gjergj Gjergji, Kosova Altari II, fq. 36.

vizitën e tij në Romë.⁷² Siç duket, Mjeda ishte takuar dhe Kardinalit Girolamo Gotti i cili ishte i njofutar hollësisht për ndodhitë në argjipeshkvinë Shkup-Prizren vet nga L. Mjeda.

Më 17 dhjetor 1912⁷³ shkruan gazeta Reichspost lidhur me konkordatin dhe pasojat jo të mira për austro-hungarinë, por në këtë artikull ka të bëjë me konkordatit mes Serbisë dhe Vatikanit, pra nuk ishte fjala apo ideja për argjipeshkvinë Shkup-Prizren, por kishte të bëjë territorin e Serbisë.

Kurse Reichspost e 31 janarit 1913⁷⁴ shkruan se nuk do të ketë bisedime rreth konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë.



Gazeta vjeneze “Neue Freie Presse e 26 qershor të 1914 shkruan në dy artikujt e saj (njëri nga K. Jirecek) se me nenshkrimin e konkordatit mes Vatikanit dhe Serbisë përfundon edhe

⁷² Krhs. Dragoljub Zivojinovic, Sveta stolica i odnosi izmedju Austro-Ugarske i Srbije, inVelike Sile i Srbija pred prvi svetski rat, Beograd 1976, fq. 246 (sidomos fusnota 32).

⁷³ Ein Serbisches Konkordat, Reichspost, 17 dhjetor 1912, fq. 5.

⁷⁴ Keine Verhandlungen zwischen den Heiligen Stuhl und Serbien, Reichspost (Nachmittag), 31 janar 1913, fq. 1.

protektorati i Austro-Hungarisë.⁷⁵ Kritikon edhe Vatikanin për konkordatën me Serbinë. De facto ishte edhe përfundimi i protektoratit austro-hungarez, por de iure ishte ende në fuqi pasi që me nënshkrimin e konkordatit të mëparshëm mes Austro-Hungarisë dhe Vatikanit.



Faksimil i gazetës "Neue Freie Presse" e 26 qershor të 1914

⁷⁵ K. Jirecek, Das Konkordat Serbiens mit dem Vatikan - das Ende des österreichisch-ungarischen Kultusprotektorat der Ausschaltung des Einflusses Österreich-Ungarn in Serbien, në Neue Freie Presse e 26 qershor të 1914 fq. 5.

VI. Territori i argjipeshkvisë Shkup-Prizren dhe L. Mjeda

Serbia dëshironte të manipulonte edhe me një gjë që katolikëve tu ipet një autonomi në kuadër të territorit të okupuar, pra Kosovës, Maqedonisë. Është e dikur se Vatikani qysh pas Lidhjes së Prizrenit nuk dëshironte që katolikët shqiptarë të ndahen në disa shtete të ndryshme ballkanike, por të jenë në një shtet. Andreas, Gottsmann shkruan se “Frika ishte e madhe që situata e shqiptarëve katolikë do të përkeqësohej në Malin e Zi të dominuar nga ortodoksia, përveç kësaj Selia Shenjte donte të mënjanojë ndarjen e shqiptarëve katolikë në shtete të ndryshme.”⁷⁶

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 1912 është paraparë që territoret e Kosovës e Maqedonisë të jenë pjesë e Shqipërisë, kështu që territori i argjipeshkvisë Shkup-Prizren duhet të ishte pjesë e Shqipërisë që ishte shtet më 1912.

Siç njofton gazeta krishtere vjeneze “Reichspost” më 22 janar 1913 në botimin e pasditës famullitari i Prizrenit dom Pashk Krasniqi ishte ftuar në Beograd për ti marrë “informatat e duhhura” për krijimin e një autonomie shqiptare katolike. Pikërisht në atë kohë, L. Mjeda gjindej në Vjenë.

Për autonominë e katolikëve shqiptarë në Kosovë e Maqedoni shkruan edhe gazeta vjeneze Reichspost më 22⁷⁷ dhe 24⁷⁸ janar 1913. Dhe se kjo “lloj autonomie” me sy të austro-Hungarisë shifej me sy skeptik. Është e ditur se Austro-Hungaria dhe Italia bashkë me Vatikanin ishin faktorë kryesor për krijimin apo shpalljes së shtetit shqiptar më 1912 dhe se në këtë shtet parashihej edhe territori i Kosovës dhe pjesë-ri i Maqedonisë. Por dihet se problemin më i madh të territorit të

⁷⁶ Andreas Gottsmann, Konkordat oder Kultusprotektorat, vep. e cit. fq. 426.

⁷⁷ Die Autonomie der Katholiken in Serbien, Reichspost 22 janar 1913, fq. 1 (botimi i pasditës).

⁷⁸ Die Frage der Katholikenautonomie in Serbien, Reichspost më 24 janar 1913, fq. 3 (botimi i mëngjesit).

argjipeshkvisë kishte lindur menjëherë pas shpalljes së pavarisë shqiptare më 1912 dhe me këtë të njëjtën kohë edhe territori i argjipeshkvisë Shkup-Prizren dhe për Lazër Mjedën, sidomos famullitë që ishin në kufi me Malin e Zi.

Die Autonomie der Katholiken in Serbien.

Die Erledigung der Konsulatsaffären.

(Von dem Korrespondenten der „Reichspost“)

S. Belgrad, 20. Jänner.

Der katholische Geistliche Don P. Paschlo aus Prizren und weite diese Tage in Belgrad. Er pa

vom Kultusminister nach Belgrad berufen worden, um Ratschläge zu erteilen, wie die Kirchenautonomie der Katholiken in dem vergrößerten Serbien zu regeln sei. Näheres konnte man nicht erfahren, da die Besprechungen geheim gehalten werden.

Alle Blätter befaßten sich mit dem Communiqué des Wiener Fremdenblattes über die Erledigung der Affäre P. Paschlo, heben den freundlichen Ton, in dem es gehalten ist, hervor und geben der Freude Ausdruck, daß diese Angelegenheit auf gütlichem Wege ausgetragen werden konnte.

Faksimil nga gazeta Reichspost e 22 janar 1913

Zur Frage der Katholikenautonomie in Serbien.

Der „Slovenec“ vom 21. d. stellt in einem Berichte aus Belgrad fest, daß die Erklärungen, Serbien werde den Katholiken in den neuerworbenen Ländern eine weitgehende Kultusautonomie gewähren, wie sie im „Slovenec“ feierlich angekündigt wurde, vom serbischen Ministerpräsidenten Herrn Nikola Pašić selbst stammen.

Die Authentizität der Informationen des „Slovenec“ ist von uns selbstverständlich nicht bezweifelt worden. Es hat auch unser Blatt Meldung gebracht, daß die serbische Regierung wegen Einführung der Katholikenautonomie verhandle. Jedoch wurde in Zweifel gezogen, inwiefern man diesen Bemühungen Ernsthaftigkeit zu sprechen kann in einem Staate, der bisher gegenüber den Katholiken eine Feindseligkeit zeigte wie kein anderes orthodoxes Staatswesen und sich gegen die Katholiken sogar noch schlimmer verhielt, als Rußland. Es ist natürlich, daß die erhebliche Vermehrung der katholischen Staatsbürger, die durch die Erweiterung der serbischen Grenzen eintritt, der serbischen Regierung nicht mehr erlaubt, über die katholische Minorität hinwegzuschreiten, aber mit welcher Aufrichtigkeit und Wirksamkeit die Einführung der Autonomie der Katholiken geschehen wird, das wollen wir doch lieber abwarten.

Faksimil i gazetës Reichspost më 24 janar 1913

Pas S. Milinovicit që ishte argjipeshkëv i Tivarit vjen Nikola Dobrecic nga Tivari. Ky vepron si argjipeshkëv prej 1912 deri 1955. Është e njohur se argjipeshkvi Dobrecic përkrahte aspiratat e Malit të Zi për okupimin e Shkodrës, me pretendim se Shkodra paska qenë „Selia e balshiqëve apo balshajve”,⁷⁹ e meqë ishte kjo kështu, sipas perceptimit të tij, kërkonte të njëjtën përkrahje nga Vatikani për realizimin e, tani, zgjerimit të ndikimit malazez edhe në Shkodër. Ky argjipeshkëv ishte shumë i njohur për idetë pro serbe dhe malazeze. Në këtë kontekst besimtarët katolik shqiptarë në këto troje përballeshin me sfida më të ndryshme. Nikola Dobrecic, e mbante veten për serb, e jo për kroat që ishte, sa që edhe qeveria e Beogradit më 1923, si argjipeshkëv të parë të argjipeshkvisë së Beogradit, e dëshironte të jetë pikërisht ky e jo ndokush tjetër,

Në vitin 1913 ishte hapur lajmi edhe nëpër gazeta dhe revista se, Papa e mbron Shkodrën⁸⁰ dhe se ai nuk dëshironte që Shkodra të jetë e okupuar nga malazezët. Ky lajm e shtynë menjëherë të vihet në lëvizje argjipeshkvin N. Dobrecic për konfirmimin e asaj çka shkruanin gazetat nga Vatikani dhe njëkohësisht kërkon njoftim zyrtar. Vatikani, i cili i dinte qëndrimet e argjipeshkvit Dobrecic, nuk lëshonte informata zyrtare, por në mënyrë diplomatike dëshironte ta zbuste përballë lajmit se, pse Papa mbron Shkodrën. Nga burimet e ndryshme del se, sikur të mos ishte aktivizuar kleri katolik shqiptarë i argjipeshkvisë së Shkodrës bashk me të gjitha ipeshkvitë sufragane e në bashkëpunim me qarqet diplomatike të Vatikanit, Shkodra do të binte në duar të Malit të Zi. Një meritë të madhe kishte edhe vet argjipeshkvi i Shkup-Prizrenit imzot Lazër Mjeda, sepse ai kishte udhëtuar për Vjenë dhe Londër për të mbrojtur jo vetëm interesat në argjipeshkvinë Shkup-Prizren, por edhe për të shpëtuar Shkodrën

⁷⁹ Rastoder, Konkordat izmedju Crne Gore, fq. 260.

⁸⁰ Rasdoter, Konkordat, fq. 261.

nga okupimi i malazezëve kështu që Mjeda ia kishte arritur qëllimit që Shkodra sidomos me ndihmën e Austro-Hungarisë të mbësë nën territorin shqiptar.⁸¹ N. Dobrecic instrumentalizonte postin e vet si argjipeshkëv për ta informuar qeverinë malazeze për realizimin e qëllimeve ekspansioniste në disfavor të shqiptarëve. Këtu le të përmendim faktin se, Argjipeshkvi i Tivarit Nikola Dobrecic vëllanë e vet Filipin e kishte sekretar në Ministrisë së Punëve të Brendshme malazeze, kështu që kur duheshin propaganda apo informata në favor të Malit të Zi, si nga ana shtetërore, po ashtu edhe nga ana e argjipeshkvisë së Tivarit, ato koordinoheshin, sikur që ndodh me rastin e vrasjes së P. Luigj Paliqit nga ana e malazezëve, por edhe lidhur me ripagëzimin me dhunë të katolikëve të Kosovës në besimin ortodoks, por edhe të atyre në pjesën e rajonit të Ulqinit duke filluar që nga viti 1913 e këtej. Këtu është luajtur një diplomaci kundërmuese që ishte plotësisht në dëm të shqiptarëve e sidomos të katolikëve.

Letërkëmbimi dhe shkëmbimi i informacioneve mes Merry de Val dhe N. Dobrecici ishte jo në favor të shqiptarëve, sidomos për gjendjen e Shkodrës më 1913 dhe okupimin nga Mali i Zi. Gjithsesi në këtë drejtim rrol jashtëzakonisht të madh mbrojtës luante kleri katolik shqiptar, sidomos ai i Shkodrës⁸² që edhe sot e kësaj dite llogaritet në publikimet serbe e malaziasë si i rrezikshëm për Sërbinë dhe Malin e Zi, meqë ishte pjekuria e tij mjaft ndikuese që nuk u lejua Shkodra të mbetet në duart e malaziasve. (Dokumenti i arkivit të Austrisë për Hskodrën në këtë kohë).

Por, një sukses jo i vogël për politikën malazeze dhe vet argjipeshkvin Dobrecic ishte ndarja e famullive të Tuzit, Traboinit, Grudës dhe Klleznas në vitin 1912 nga argjipeshkvia e Shkodrës për t'iu bashkëngjitur argjipeshkvisë së Tivarit. Në

⁸¹ Markus Peters, *der älteste Verlag Albaniens*, fq. 424.

⁸² Romeo Gurakuqi, *Aspekte të qëndrimit*, fq. 277-294.

anën tjetër Mali i Zi kishte interesim shumë të madh që protektorati i Austrohungarisë sa më shumë e më shpejtë të humbë në fuqi e mundësisht mbase të shpallet edhe si i tepërt e i tejkaluar përkitazi me rolin e saj si mbrojtëse e shqiptarëve katolikë në Ballkan, sepse ky protektorat në të njëjtën kohë ndikonte shumë në arenën diplomatike ndërkombëtare dhe se, shfuqizimi i tij do t'i hapte rruge politikës antishqiptare.

Është për tu theksuar se, qeveria e Malit të Zi kishte filluar ofensivë jo vetëm përreth Shkodrës, por edhe në Kosovë. Në bashkëpunim me argjipeshkvin e Tivarit, Dobrecic, kërkonin që famullitë e rajonit të Pejës dhe Gjakovës t'i bashkëngjiten argjipeshkvisë së Tivarit.⁸³ Kurse për pjesët tjera të ipeshkvisë së Shkupit Serbia kishte plan tjetër, kështu besimtarët katolikë ishin mes dy zjarreve, atij malazias dhe serb. Siç dihet më parë argjipeshkvia e Shkodrës dhe ajo e Shkupit kishin disa famulli nën juridiksionin e tyre që gjendeshin në territorin e Malit të Zi, por këto të drejta iu murrën nga qeveria malaziasë të dy argjipeshkvive dhe u dorëzuan asaj të Tivarit. Në këto famulli jetonin vetëm shqiptarët dhe, sipas Konkordatit të vitit 1886, nuk ishte e lehtë, as në aspektin religjioz e as në atë kulturor, që ndonjë ipeshkëv shqiptar të ndikonte nga Shkodra apo Shkupi për atë që po ndodhte me katolikët në pjesët e sunduara tash nga serbët e malazezët. Më 1913, përveç asaj që edhe priftërinjtë katolikë vriteshin nga malazezët e serbët, tash qeveria malazeze dhe argjipeshkvi i Tivarit Nikola Dobrecic tentonin që edhe famullit e rajonit të Pejës dhe Gjakovës t'i bashkëngjiteshin argjipeshkvisë së Tivarit, çka de facto më vonë do të thoshte se, edhe ky territor do ti bashkëngjitet Malit të Zi.

Për këtë arsye argjipeshkvi i Tivarit N. Dobrecic në vjeshtën e vitit 1913 udhëtoi për në Vatikan për të biseduar për këtë çështje. Kurse Vatikani këtë tendencë e refuzoi kategori-

⁸³ Rastoder, Konkordat, fq 263.

kisht, sepse tamam u pa se ku ishte plani i qeverisë malaziase. Për këtë punë më së shumti ka vepruar bariu i mirë dhe i zellshëm argjipeshkvi i Shkupit Imzot Lazër Mjeda.

Argjipeshkvi i Tivarit Nikola Dobrecic i kishte shkruar një letër argjipeshkvit Lazër Mjeda më 12 nëntor 1913 dhe në këtë letër Dobrecic thekson se të gjitha informatat për famullitë e territorit të okupuar nga Mali i zi e që gjinden nën jurisdikcion të argjipeshvisë Shkup-Prizren do ti dërgon Mjedës, por në këtë letër ai shënon se famullitë që tashmë gjinden në territor të Malit të Zi, i shef më pjesë të bashkangjitura argjipeshkvisë së Tivarit. Për këto rrethana dhe letra kishte njoftuar Vjenën edhe konzullata e Prizrenit më 10. XII 1913.⁸⁴ Lazër Mjeda i kthen përgjigje argjipeshkvit Dobrecic dhe i tregon se nuk është aspak i pajtimit më këtë gjë, por do të informon edhe Vatikanin për këtë punë.⁸⁵ Të njëjtën kohë, kur gjenerali malazias Vesovic që në atë kohë gjindej në Pejë shkon te famullitari i Pjesës dhe i Prizrenit dhe u thotë se tash e tutje duhet të keni punë me argjipeshkvin e Tivarit N. Dobrecic. Kurse famullitarët i thanë se nga ana e eprorëve të Kishës katolike nuk u kishte ardhur asnjë shkresë për këtë punë, kështu që edhe më tutje do të kemi aripeshkëv tonin L. Mjeda. Gjenerali i zemëruar u kthen përgjigje se në këto vende ma nuk ka se çka të përzihet një “argjipeshkëv i huaj” dhe se nuk mund më ta durojmë atë dhe se do t`ia ndaloj Mjedës të hynë në kufi.⁸⁶

Lazër Mjeda kishte alarmuar Austro-Hungarinë për këtë punë dhe ministri i punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz kërkon nga Vatikan spjegim për këtë punë dhe të njëjtën kohë nga Mali i

⁸⁴ HHSTA, PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Nericht Kohlruss (Prizren) 125, 10. XII 1913.

⁸⁵ HHStA, PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Nericht Kohlruss (Prizren) 125, 10. XII 1913.

⁸⁶ HHStA., PA, XVII, 49, Montenegro XIII, Nericht Kohlruss (Prizren) 113, 11. XII 1913.

Zi kërkon që edhe më tutje Lazër Mjeda duhet patjër të këtë mundësi që ti viziton të gjitha pjesët e argjipeshkvisë së vet.⁸⁷ Berchtold nuk diskuton fare për përkatësinë e Pejës dhe Gjakovës se cilës ipeshkvi i takojnë. Ministri vjenez Berchtold kishte pasur edhe bisedime zyrtare me Vatikanin lidhur me këtë punë, kështu që kërkon nga Vatikani që të deklarohet zyrtarisht për këtë punë. Vatikani ishte shprehur zyrtarisht se deri sa mos të ketë ndryshime zyrtare nga Vatikani, edhe më tutje është në fuqi se argjipeshkvi L. Mjeda është argjipeshkëv i këtyre territoreve dhe se ai nuk guxon të ketë pengesa në vizita të territorit të argjipeshkvisë së vet. Vatikani i kishte siguruar Përfaqësuesi zyrtar (ambasadorit) i Austro-hungarisë në Vatikan Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein se atë që argjipeshkvi Dobrecic dëshiron të arrij, nuk është e pranuar nga Vatikani dhe se I tregon se Dobrecic kishte vizituar Vatikanin para kakë kohe, por nëse Dobrecic vazhdon të bëjë ndonjë hap lidhur me pengesën apo përzierjen në territorin e argjipeshkvisë Shkup-Prizren që nuk është nën juridikcionin e tij, por nën juridikcionin e L. Mjedës, kështu që N. Dobrecic mund të ekskuminikohet nga Kisha katolike.⁸⁸

Për ta provokuar edhe më shumë Austro-Hungarinë gjenerali malazias Vesovic më 1914 myllli shkollat katolike në territor të argjipeshkvisë Shkup-Prizren, pikërisht në Pejë më 1914 mbylli shkollën katolike dhe përmes këtij akti dëshironte të vinte në bisedime direkte me Austro-Hungarinë.⁸⁹

⁸⁷ HHStA., PA, XVII, 49, Montenegro XIII, (Cetinje) 248, 12. XII 1913.

⁸⁸ HHStA., PA, XVII, 413, Türkei XLV/ Pözel (Prizrend) 69, 27.VI 1913.

⁸⁹ HHStA, PA, XII, 449, Montenegro XIII, Schönburg (Rom) 45, 12. XII 1913.

Djakova — aufgegeben.

Nun ist auch die rein albanesische Stadt Djakova von unserer Diplomatie aufgegeben worden. Es ist der Preis des Einvernehmens mit Rußland. Teuer bezahlt ist es, dieses Einvernehmen, dem zuliebe lebendes Fleisch aus dem Körper des freien Albanien herausgerissen wird. Wenige Wochen sind es erst her, da man am Ballplaze erklärte, „Djakova und Dibra werden niemals ausgeliefert werden.“ Um Spet und Prizrend hieß es, werde noch ein unentschiedener Kampf geführt. In der „Reichspost“ wurden wiederholt diesbezügliche hoch-offizielle Mitteilungen veröffentlicht, die sich jedoch heute nicht mehr aufrechterhalten lassen. Das Wiener Kabinett hat die russische Formel akzeptiert: Djakova für Skutari.

Es ist traurig, dies vermelden zu müssen. Der österreichischen Presse wurde diese diplomatische Niederlage auch nicht mitgeteilt, sie erfuhr die Tatsache erst aus einer Meldung des englischen Publizisten Dillon, der gestern und heute im Wiener Auswärtigen Amte von hohen Diplomaten authentische Informationen über die Situation erhalten hat. Der Engländer ist es, der uns darüber die erste glaubwürdige Nachricht aus „russischer“ Quelle vermittelt. Den Vertretern der österreichischen und ungarischen Presse gegenüber blieb das neue Uebereinkommen zwischen Oesterreich-Ungarn und Rußland bis heute ein Geheimnis.

Ungarn tatsächlich bereit wäre, im Falle einer Angliederung Skutaris an Albanien auf die Einbeziehung von Djakova zu verzichten. Jedoch unter der Bedingung, daß für einen wirksamen Schutz für die dortigen Albanesen in religiöser und nationaler Hinsicht seitens Montenegros und Serbiens Vorkehrungen getroffen wird. Eine solche Maßnahme — so wird weiters mitgeteilt — erscheint umso erforderlicher, als die letzten Wochen Meldungen von Ausschreitungen gegen Albanesen und slavische Katholiken berichtet haben, deren Wiederholung nur durch wirksame Garantien erfolgreich vorgebeugt werden kann.

Was es heißt, Djakova und Umgebung den Serben und Montenegrinern auszuliefern, das haben die entsetzlichen Vorkommnisse daseibst am deutlichsten demonstriert. Die Preisgabe Djakovas bedeutet die Preisgabe seiner bedauernd-werten Bevölkerung der nationalen und religiösen Verfolgung.

Më 1913 ishte ideja e qarqeve malaziase që nëse dëshirojnë të "japin" Shkodrën e mos të luftojnë më për të, por kushti ishte që pjesët e territorit të Kosovës së sotme, deri të Gjakova ti bashkangjiten Malit të Zi. Pra, Gjakova ishte në territor shqiptar më 1913. Gazetat e ndryshme austro-hungareze i kushtonin rëndësi të madhe ngjarjes për ndarjen e Gjakovës nga territori shqiptar. Reichspost më 23⁹⁰ e 26 mars 1913⁹¹ dhe Gazeta "Wiener Sonn- und Montags-Zeitung" 24 mars 1913⁹² shkruajnë se Gjakova duhet të ipet për Shkodrën dhe jo vetëm Gjakova, por pjesa deri të liqeni i Ohrit. Dorëimi i Gjakovës do të thotë të njëjtën kohë edhe të gjitha famullitë përreth saj

Siç thamë edhe më parë Lazër Mjeda me përkrahjen e Austro-hungarisë ia arriti që të shkon edhe në Londër të mbron interesat e Shkodrës, pra, që Shkodra të mos ndahet nga Shqipëria, pro ai kishte edhe një problem të madh si argjipeshkëv i argjipeshkvisë Shkup-Prizren.

Djakova für Scutari.
Bevorstehende Demarche der Mächte.

London, 25. März.

Wie das Reutersche Bureau erfährt, haben sich die Mächte über die Nord- und Nordostgrenze Albaniens von Djakova bis zum Dhrivagee einigt. Unter jenen Districten, deren künftige Zugehörigkeit bestimmt wurde, befinden sich Scutari und Djakova. Eine diesbezügliche offizielle Erklärung steht unmittelbar bevor und wird vielleicht noch morgen erfolgen. Die Verbündeten werden zu diesem Behufe eine gemeinsame Erklärung in der Mitte der nächsten Woche abgeben.

Zwei der schwierigsten Punkte in den Balkanangelegenheiten werden somit eine Regelung finden und, da die Verbündeten in einer jeden Zweifelschleife die Möglichkeit der Entscheidung der Mächte ändern würde. Die Botschafter werden sich sodann mit der Feststellung der südlichen Grenzen Albaniens befassen, bezüglich deren Italien und Oesterreich-Ungarn besondere Anschauungen haben; diesbezüglich ist jedoch, wenn auch die Verhandlung hierüber langwierig werden könnte, kein Schwierigkeit zu befürchten.

Reichspost më 26 mars 1913

⁹⁰ Djakova aufgeben, Reichspost 23 mars 1913, (botimi i mëngjesit), fq. 5.
⁹¹ Reichspost më 26 mars 1913 „Djakova für Scutari, fq. 2.
⁹² Gazeta "Wiener Sonn- und Montags-Zeitung" 24 mars 1913, fq. 1.

Die Frage von Djalowa.

Die Meldung, daß zwischen Wien und Petersburg eine Einigung in der Frage von Djalowa nicht als ausgeschlossen zu betrachten sei, ist Gegenstand vielfacher Erörterung und Kommentierung gewesen. Dabei wurde ausdrücklich hervorgehoben, daß eine der Voraussetzungen, durch deren Erfüllung ein Verzicht der österreichisch-ungarischen Politik auf die Einverleibung der genannten Stadt in das künftige autonome Albanien ermöglicht würde, in der Gewährung internationaler Garantien für die albanesischen, katholischen und mohammedanischen Minoritäten in den späterhin von Serbien und Montenegro zu annektierenden Gebieten bestehe. Mit der Frage der Zugehörigkeit von Skutari selbst hängt die Frage von Djalowa gewiß nicht in dem Sinne zusammen, als ob Rußland auf Skutari, Oesterreich-Ungarn auf Djalowa Verzicht leisten und auf dieser Grundlage ein Einvernehmen zustandekommen würde. Skutari muß selbstverständlich, da dies bisher allgemein und unwidersprochen als der einmütige Wille der Mächte gegolten hat, dem künftigen Albanien zugeschlagen werden, und für Djalowa ist die Möglichkeit eines Ausschlusses aus dem autonomen Albanien an die oben erwähnte Bedingung sowie an mehrfache andere Voraussetzungen geknüpft. Eine derselben hängt mit der Skutari-Frage insofern zusammen, als sie die sofortige Einstellung der Beschießung dieser Stadt und die baldigste Räumung Albaniens durch die serbischen und montenegrinischen Okkupationstruppen zum Gegenstand hat. Von einer Perfektionierung dieser Angelegenheit wird daher wohl erst dann gesprochen werden können, wenn nebst der Zusicherung internationaler Garantie für die Minoritäten auch die anderen Bedingungen erfüllt sind, von denen die der Evakuierung Albaniens für die Albanesen schon deshalb von großer Wichtigkeit ist, wie sie erst durch deren Honorierung in die Lage versetzt wird, sich von den verheerenden Wirkungen der monatelangen Okkupation zu erholen.

VII. Lazër Mjeda dhe laramanizmi në argjipeshkvinë Shkup-Prizren

Me ardhjen e turqëve në Ballkan, qështja fetare ndryshoi shumë gjëra. Pra, përhapja e fesë së pushtuesëve në vendet ballkanike, e sidomos tek shqiptarët ishte që mori hov të madh. Ndonjëherë islamizmi pranohej sipërfaqësisht nga kryefamiljari e më vonë edhe nga meshkujt tjerë të rritur të familjes (por jo edhe nga femrat - gratë), të cilët para pushtetit osman do të njihen me emra të rinj musliman për tu paraqitur para pushtuesit si mysliman për shkaqe tatimore, kurse në qarqet familjare fshehurazi ishin krejtësisht krishterë sikur të gjithë të krishterët tjerë. Vetëm se haptas nuk shkonin në kishë apo nuk merrnin sakramente, vetëm se brenda natës meshtari ishte i detyruar që ti vizitonte, pagëzonte dhe të kryente çdo shërbesë fetare që ata kërkonin. Pra, jeta e tyre fetare ishte e dyfishtë, paraqiteshin nga frika haptas se janë mysliman, kurse fshehtas mbanin fenë krishtere. Ky fenomen është në disa vende i pranishëm, sikur në Shqipëri, paoshtu edhe në Kosovë dhe quhet laramanizëm apo kriptokrishtenizëm (kriptokatolicizëm).⁹³ Në koncilin kombëtar kishtar të 1703 i mbajtur në Mërçi është trajtuar paoshtu edhe kjo temë. Edhe koncili tjetër kishtar shqiptar i 1871 dhe i vitit 1895 trajtonin këto tema. Jantë të njohura edhe enciklikat e Vatikanit lidhur me këtë fenomen sikur “Inter Omnigenas” e vitit 1744, dhe “Quod Provinciale Concilium” e vitit 1754 të firmosur nga papa Benedikti XIV dhe dekreti “Decretum que reprobantur nonnullae praxes christianorum occultorum muhamethanum sectam simultantium” i 19.02. 1774 i nënshkruar nga prefekti Kongregatës Propaganda Fide Msgr Castelli preferohet. Kjo

⁹³ Mbi këtë fenomen shif më shumë: Bartl Peter, Kryptochristentum und Formen, pprkthimi (botuar në revistën Urtia) i këij artikulli në shqip: Bartl, Kriptokrishtenizmi dhe format e religjionit; paoshtu shif Albert Ramaj, Burime dhe dëshmi, kriptokrishtenizmi...

gati më së shumti ka të bëjë me territorin e sotëm të Kosovës dhe të Maqedonisë këto enciklika dhe dekreti i lartpërmendur, apo më mirë të themi për laramanët e kësaj ane. Një ndër studiuesit e thukët të historisë shqiptare është diplomati dhe konsulli austriak, Johann Georg von HAHN që kishte shkruar për këtë fenomen dhe jepë të dhëna në librat e tija lidhur me këtë fenomen në “Albanesische Studien”, “Reise von Belgrad nach Salonik” dhe „Reise durch die Gebiete von Drin und Wardar”.⁹⁴

Në Letnicë ruhen librat e pagëzimev krikatokolikëve apo laramanëve që quhen: Liber baptizatorum occultorum I. (1906-1915) dhe II. (1920-1936) dhe në Stubëll „Matricularum baptizatorum Cryptocatholicorum Ecclesiarum Beatae Mariae Virginis Crnagorensis in Letnica Atque Sancti Joseph, Sponsi Beatae Mariae Virg. in Stubla Stubalae” Librat kanë të bëjnë me pagëzimin e kriptokrishterëve nga zona e Karadakut sidonos në vitet qysh prej 1893 deri në kohën e luftës së II botërore. Në këto libra gjëjmë të pagëzuar shumë persona kur Lazër Mjeda ishte argjipeshkëv në Kosovë.⁹⁵

Dhe Lovro Mihačević shkruan për „laramanët” kështu: "Kur prifti katolik e përshkon famullinë për t'i bekuar shtëpitë, duhet patjetër të kthehet edhe nëpër shtëpitë e myslimanëve, që ti spërkas (bekoj) edhe ato, e ata i japin lëmoshë sikur edhe katolikët; do të ndiheshin të ofenduar, nëse ai nuk e bën."⁹⁶

Në kohën e Lazër Mjedës në Prizren shkrimtari bullgar P. Cilev.⁹⁷ kishte vizituar më 1911 shumë vende në argjipeshkvinë Shkup-Prizren dhe përmend raste interesa shumë interesante lidhur me laramanët dhe festimin e festave dhe

⁹⁴ Më shumë te Albert Ramaj, Burime e dëshmi, fq. 167-174.

⁹⁵ Krahaso Albert Ramaj. Burime dhe dëshmi faqe 131-166.

⁹⁶ Për këso raste shkruan L. Mihacevic, Durch Albanien. Prag 1913, fq. fq. 34-35.

⁹⁷ Cilev P., Obikolka iz albanski seliste, poashtu Albert Ramaj, Burime e dëshmi, fq. 148; poashtu Gaspër Gjini fq. 153.

mënyrën e praktikimit të fesë katolike fshehurazi në këto troje. Shumë informata kishte marrë edhe nga bashkpuntori i Lazër Mjedës dom Luka Filiq. Në kohën e Lazër Mjedës kishte shumë fshatra laramane, që sot nuk janë të islamizuar, sikur ato në zonën e Karadakut të Shkupit dhe përreth Ferizajit. Poashtu kishte edhe në Pushnik laraman. Në rrethin e Pejës kishte në këto vende laraman, në Belaj, Lumbardhë e Rashiq. Afër Ferizajit kishte familje laramane sikur Talinovci, Jerliu, Muhovci, Koshare. Këto vend i kishte vizituar deri von prifti i Ferizajit. Është interesant se këto vende i kishte vizituar laramanët priftrinjtë katolik, por nuk ishte hetuar fare se është priftë nga rrethi, sepse ai ishte veshur sikur fshatar i thjesht dhe kishte qantën në krah, ku kishte një armë për gjueti dhe disa pëllumab të mbytur në krah, kështu që në qantë kishte të gjitha përgatitjet e veta për meshë dhe ceremoni të tjera fetare dhe shkonte e thonte meshën në këto vende. Këtë e bënte edhe bashkëkohësi i Lazër Mjedës don Bartollome Fantela i njohur sikur Don Bata.

Në kohën kur Lazër Mjeda ishte argjipeshkëv në Prizren, poashtu edhe Atë Gjergj Fishta sipas dëshmisë së tij, kishte pashur ndërmend të shkruan një vepër letrare lidhur me Martirët e Zonës së Karadakut të Shkupit që më parë kishin jetuar si laraman të fshehtë dhe ishin deklaruar si të krishterë. Atë Gjergj Fishta shkruan më 11 mars 1911 kështu: „...Edhe unë e kam një dorëshkrim në gjuhën frengjishte mbi persekutimet e familjeve katolike nga Stublla në Karadak. Me të vërtetë ky dorëshkrim është tejjet interesant: duke e lexuar kam qarë me lot për faqe për ata MARTIRË TË SHKRETË, të cilët me një përlulje aq të madhe të krishtere dhe duke iu nënshtruar vullnësës së Zotit i kanë bartur mizoritë e padegjuara të bëra nga ana e persekutuesëve barbare. Nga kjo histori mund të shkruhet një vepër me karakter të rendit të parë letrar; sepse do të ishte tejet karakterstike dhe patetike, e po ashtu edhe indikative për aktualitetin e saj....

...Edhe unë e ushqej idenë që nga kjo histori ta bëj një vepër letrare, por Zoti e di se kur do të mund të merrem me këtë çështje.“ shkruan At Gjergj Fishta.⁹⁸

Është edhe interesant të cekët një gjë se sikur në shumë vende krishtere poashtu edhe nëargjipeshkvinë Shkup-Prizren ishin kalitur me dekada edhe bile me shekuj lutje - uratë që ishin në formë të poezisë apo edhe gati se këndoheshin si lloj këngë, pra me një melodi të caktuar e të njëjtë deri në fund të uratës. Të njohura janë disa nga këto troje, psh. “kujto mirë, o njeri shkretë (Qëllimi i njeriut)”, “Un` prej Zotit jam i kështenë” “Dhetë urdhnimet e Tënzot” (forma e zgjëruar e dhjetë urdhërimeve etj. Këto gjëra i ka përmbledhur Dom Gaspër Gjini në librin “Shujta Shpirtnore”.⁹⁹ Është e njohur edhe „N`Cernagore kem një Nanë“ apo siç quhej edhe “Kanga e popullit”¹⁰⁰ e ka shumë të tjera që publikoi për të parën herë poeti Dom Ndue Bytyqi, por kjo këngë këndohet me shekuj në popullatën e Karadakut, si tek të krishterët, poashtu edhe tek muslimanët. Ka mendime se uratën “Un`p prej Zotiti jam i kështenë” e ka shkruar Lazër Mjeda. Më uratë, lutje të ndryshme e këngë të ndryshme në formë poezie në argjipeshkvinë Shkup-Prizren është marrë Dom Ndue Bytyqi dhe mendoj personalisht se më shumë do të ishte natyra e dom Ndue Bytyçit sesa e Lazër Mjedës. Nuk do të diskutoj për “autorësinë” e kësaj urate, sepse këtë punë duhet të bëjnë ekspertët e kësaj lamie, por këtu është me rëndësi se kjo uratë është shumë e njohur në Kosovë bile edhe deri gjerat e vonshme e kanë ditur përmendësh këtë uratë dhe ka disa që ende e dijnë. Dihet se këto uratë quhen edhe “lutje të moçme” e siç shprehet edhe

⁹⁸ Albert Ramaj, Burime dhe dëshmi, fq. 190-193; poashtu shif edhe GJERGJI, Gj: Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848, Drita, 3-4, 1983 fq. 22.

⁹⁹ Shujta shpirtnore (përpiloi Gaspër Gjini), Ferizaj-Zagreb 1978, krahaso fq. 205-222.

¹⁰⁰ BYTYQI Nue dom, Kanga e popullit. N`nderr t`Zois Zernaghores, Elçija e Zemrës së Krishtit, Shkodër, qershor 1894, fq. 6-9.

dom Gapsër Gjini “që populli i ka ruejtë e i përdorë.. dhe përdorën me andje dhe trashëgojen brezive të reja”¹⁰¹ Strofa e parë e uratës “un` p prej Zotit jam i kështenë” ka të bëjë shumë me fenomenin e laramanizmit apo kriptokrishtenizmit në argjipeshkvinë Shkup-Prizren, fenomen që shekuj më radhe ishte prezent në këto troja. Në këtë uratë është një lloj forme e besojmës më të thjeshtë, por në mënyrë të themi ashtu popullore por për në këtë rastë është shumë me rëndësi strofa e parë dhe e dytë:

“Un` prej Zotit jam i kështenë
E kështu due gjithmonë me kenë;
Qysh m`at ditë qi m`anë pagëzue
N`këtë fe shejte jam i shkrue.

E n`ket fe un due me rrnue,
Kam me dekë e s`kam me lshue,
Pse e dij mirë se s`ka shelbim
Për ata qi s`janë kështenim.”

Kjo duhet të ketë me laramanizmin edhe bile me islamizmin e popullit shqiptar, pasi që në këto troje kshihte shumë laraman, kljo uratë mund të kishte buruar qyshë atëherë. Pra fjalët “E n`ket fe un due me rrnue, kam me dekë e s`kam me lshue” mund të kenë të bëjnë vuajtjet e të krishterëve të këtyre trojeve, edhe ata që dëshironin të mbetnin haptas katolik ishin pra në gjendje që edhe të vdesin për fenë e vet e nuk do ta lëshonin siç thuhet në këto fjalë, kurse fjalët: “Pse e dij mirë se s`ka shelbim, për ata qi s`janë kështenim.” Duhet të kenë të bëjnë me ata që kishin “braktisur” fenë krishtere dhe ishin islamizuar apo edhe ata që ende nuk janë deklaruar haptas si të krishterë.

¹⁰¹ Shujta shpirtnore, fq. 205.

Më dobësimin dhe ramjen e Perandorisë osmane, gjendja e të krishterëve të fshehët apo kriptokrishterëve (laramanëve) duhet të ishte më ndryshe, sepse ata tash kishin mundësi që të deklaroheshin të krishterë haptas. Siç shifet qartë, tash ka të bëjë me një problem tjetër, sepse Serbia nuk dëshironte që laramanët të deklaroheshin katolik, por nëse dëshirojnë të deklarohen si të krishterë atëherë kanë një mundësi, të deklaroheshin ortodoks apo të mbësin „musliman“. Për Këtë raportin edhe gazeta krishtere vjeneze Reichspost më 27 dhjetor 1912 (botimi i pasditës), duke iu referuar poashtu Lazër Mjedës, konkret gazetës sllovene „Slovenec“, sepse Mjeda në dhjetor të vitit 1912 gjindej në Ljubljanë. Në artikullin „Serbien und die Katholiken“ shkruhet se laramanët apo katolikët e fshehur siç shkruhet në atë artikull ishin deklaruar para serbivë se dëshirojnë haptas të jenë katolikë. Kurse Serbia u kishte thënë laramanëve se „ose duhet të bëheni ortodoks (shizmatik) ose të muhamedan, kursesi katolik“.¹⁰²

Serbien und die Katholiken.

Von hervortragender kirchlicher Seite erhalten wir folgende Mitteilung:

Die Meldung des „Slovenec“ von der Gründung eines katholischen Priesterseminars in Triest und durch die serbische Regierung ist wohl unmissbar unrichtig. Weber stellt sich die serbische Regierung gegen die Katholiken nicht feindlich. Von Albanesen, welche unter den Tärten ihre katholische Gesinnung verbargen, den Serben gegenüber aber sich offen als Katholiken bekennen in der Hoffnung, von Christen in ihrer Ueberzeugung belassen zu werden, haben die Serben angefordert, entweder orthodox (schismatisch) zu werden oder mohammedanisch, keinesfalls katholisch.

Zendenzmeldungen wie die obige, die darauf berechnet erscheinen, die katholische Oeffentlichkeit Oesterreichs irre zu führen, sind schon früher durch manche Blätter gegangen zum Beispiel von katholikenfreundlichen Verhandlungen der serbischen Regierung mit dem in Triest residierenden Erzbischof von Aueslab Media, in dessen Befand sich Media schon vor Ausbruch des Krieges im Ausland und konnte seitdem den heimatischen Boden noch nicht betreten. Die Zeitungsnachrichten über die durch die Serben unter den Albanesen verübten Greuel bleiben weit hinter der Wirklichkeit zurück. So wurden zum Beispiel in einer Ortsgaststube bei Triest von den 3000 Einwohnern alle bis auf drei von den Serben niedergemacht.

Faksimil nga gazeta krishtere Reichspost e 27. 12. 1912 (botimi i pasditës)

¹⁰² „Serbien und Katholiken“, Reichsposts (Nachmitagausgabe) 27. 12. 1912, fq. 1.

Poashtu gazeta vjeneze Wiener Sonn- und Montags-Zeitung¹⁰³ shkruan për konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve në ortodoksi dhe rolin e argjipeshkvit Mjeda për rikthimin e besim-tarëve. Në këtë artikull shifet se konfertimi i shqiptarëve ishte me dhunë dhe se Mali i Zi nuk kishte tolerancë fetare ndaj shqiptarëve.

Die gewaltsamen Glaubensbefehrungen in Montenegro.

Das Entsetzen, welches die Nachrichten über die montenegrinischen Greuelthaten hervorgerufen haben, die an den katholischen Albanesen verübt wurden, um sie zur Orthodoxie zu bekehren, wird überboten durch den Ekel, welchen die Taktik der montenegrinischen Offiziosen erzeugt, die ihr Heil nun in unverschämten Lügen versuchen. Freilich wird dieser Ekel gemildert durch das Lächerliche der an völligen Stumpfheit erinnernden Auslassungen, die das montenegrinische Amtsblatt zu diesem Zwecke von sich gibt. Es bezeichnet die Meldungen über gewaltsame Befehrung katholischer Albanesen zur Orthodoxie als Verleumdung und findet es beklagenswert, daß sie in die Berliner Presse Aufnahme gefunden in diesen für Montenegro ohnehin so kritischen Tagen. In Montenegro habe es niemals religiöse Intoleranz gegeben, nicht einmal zu jener Zeit, als seine Herrscher zugleich Bischöfe waren. Das Blatt erzählt dann den Hergang der Konvertierungen in Djalowa folgendermaßen: Die montenegrinischen Behörden hätten den Leuten zuerst vom Uebertritt zur Orthodoxie abgeraten (!), ihnen aber dann ihren Willen lassen müssen, weil sie darauf beharrten und auch dem Erzbischof von Prizrend, der sich an Ort und Stelle begab und sein Möglichstes tat, um sie von ihrem Vorhaben abzubringen, Widerstand leisteten. (!)

Was soll man zu solchen Ausflüchten sagen angesichts der schauerlichen Mordthat, die an dem Franziskaner-Pater Patic verübt wurde?

Faksimil i gazetës „Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, artikulli mbi konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve dhe për rolin e Mjedës.

¹⁰³ Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, artikulli „Die Antwort Montenegros ist ausständig“ 24 mars 1914, fq. 1.

Më 21. 12. 1912 Imzot Lazër Mjeda gjindej në Ljublanë të Sllovenisë dhe prej aty i drejtohet të Kongregatës P. Fide Kardinalit Girolamo Gotti me një letër lidhur me laramanët e ndër të tjera thekson:

“Lartesia Juaj e di se në Kryepeshkopatën time kishte të krishterë të fshehur (laramane); ata duke perfituar nga ardhja e pushtesve të rinj që “krenohen me emrin kristian”, menduan se erdhi koha të shpalleshin hapur se ç`dëshironin të ishin; dhe të gjithë fshatrat në Mal të Zi të Shkupit, Janjevës dhe Ferizajt u shpallën hapur katolikë. Nuk dihet asgjë për ata që banonin në krahinën e Prizrenit, por ka mundësi që edhe ato të kenë bërë të njëjtën gjë, pasi ishin lidhur ngushtë me të tjerët. Se ç`numër kishin, s`mund t`ju them tani, por është e sigurt se duhet të jenë disa mijëra. Porse për serbët, që ndërkohë mburren se kanë ardhur të çlirojnë të krishterët nga zgjedha muslimane dhe t`i japin liri të gjithëve, ky fakt bie ndesh e t`i acaron nervat, u thirrë famulltari i Janjevës për t`i treguar se si është bërë ky kthim. Famulltari u përgjigj se ato kishin qenë gjithnjë katolikë, por nga fika e turqëve kishin qëndruar fshehur deri atëherë. Komandanti shtoi: “Nëse turqit duan të ndërrojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, e jo katolikë, pëndryshe është më mirë të rrinë turq”. Këto fjalë tregojnë mjaft qartë se ç`kriter kërkon të ndjekë qeveria e re dhe si shtypjet dhe perndjekja turke të lë të kuptosh atë të skizmatikëve (serbëve). Ia them këto Lart. Suaj sepse nën kujdesin Tuaj të lartë dhe mjetet e mundëshme, të përpiqeni për liritë tona.”¹⁰⁴

Lazër Mjeda kishte arritur në janar të vitit 1913 në Vjenë. Prej aty i shkruan edhe me letër më 09. 01. 1913 ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz lidhur me gjendjen shqipare dhe në argjipeshkvinë Shkup-Prizren. Ndër të tjera shkruan Mjeda edhe për laramanët kështu:

"Prej shumë kohësh në Kryepeshkopatën time kishte të krishterë të ashtuquajtur të fshehtë, që fshehurazi ushtronin kristian dhe ishin të

¹⁰⁴ GASHI Gj. Kosova Altari i Arbërisë, II, fq. 35.

pagëzuar, por publikisht, për arsëye frike, dukeshin muslimanë. Kur erdhën serbët në këto krahina, disa fshatra të këtyre të fshehurve menduan se erdhi koha të shfaq-en dhe u shpallën hapur katolikë. (Këto fshatra janë arbërorë e flasin atë gjuhë, jetojnë në Ferizaj e rrethinë, Janjevë e rrethinë dhe në të gjithë Malin e Zi të Shkupit. Ka edhe të tjerë në krahinat e Prizrenit dhe të Pejës, por për to nuk di gjë ç'kanë bërë). Kam dëgjuar që qeveria Serbe thirri delegatin tim Imzot Gllasnovic, dhe kërkoi të dinte si ishte bërë ky kthim i muhamedanëve. Prifti iu përgjigj se nuk kishte ndodhur asnjë kthim i muhamedanëve, por vetëm një manifestim i hapur (publik) i katolikëve, të cilët deri në atë kohë nga frika e „turqëve“ kishin qëndruar të fshehur. Megjithatë, ky shpjegim nuk e kënaqi komandantin serb, i cili i tha priftit se, nëse muslimanët duan të ndryshkojnë fe, duhet të bëhen ortodoksë, por jo kato-likë: përndryshe le të qëndrojnë muslimanë. Dhe di nga vende të tjera që muslimanë që donin të përqaфонin krishtërimin, u ndaluan nga qeveria serbe”.¹⁰⁵

Më 20 dhjetor 1912 kishte raportuar nga Ljubljana Lazër Mjeda poashtu Kardinal Gottin lidhur me laramanët në argjipeshkvinë e vet dhe kishte njoftuar se qeveria serbe nuk i lejon që ata të jetonin haptas si katolik por ata duhet të mbeteshin muhamedanë ose të kalojnë në ortodoksi.¹⁰⁶

Më 29 shtator 1913 imzot Mjeda i shkruan kardinalit Gotti lidhur me laramanët kështu: “Në të vërtetë këto ditë e para u bë një lëvizje e madhe sidonos në anët e Cërnagorës (Mali i Zi i Shkupit), ku pothuajse të gjithë të fshehurit ishin shfaqur tek famullitari i Stubllës dhe i kishin kërkuar një letër, ku të dëshmojnë se ishin katolikë. Famullitari nuk kishtë kundërshtuar dhe njëri prej tyre, një farë Jetishi nga Dunavi, ishte shpallur i pari katolik me të gjithë familjen. Por qeveria, pasi mori njoftimin, kishte dërguar t'i thonin që, ose të mëhehsin ortodoksë, ose ti priste vdekja. I shkreti ishte endur si shtegtar nëpër shpella e ferra për disa kohë, por pastaj,

¹⁰⁵ Gjergj Gjergji, Kosova II., fq. 39-40.

¹⁰⁶ Krhs. GjERGJ Gashi, Kosova II., fq. 66.

duke parë që familja kontrollohej çdo ditë dhe turbullohej nga serbët, ishte ktyher në shtëpi, duke u shtriru se ishin dakord me dëshirat e tyre.

Ndërsa një tjetër, megjithësei kërcënuar dhe rrahur, që më i patundur dhe vazhdonte të mbetet katolik.

Kështu edhe ata të Androcit të Janjevës. Aty, nga gjashtëmbëdhjetë familje, vetëm pesë dezertuan; të tjerat i rezistuan me kurajo të gjitha kërcënimeve të qeverisë. Por patën favorin se në krye të komunës së Janjevevës në atë kohë ishte famullitari lokal dhe këta mund të kishin kurajo dhe të mbroheshin nga reprezaljet e serbëve. Kështu që deri tani nga ata që ishin të fshehur kemi vetëm nja shtatëdhjetë vetë që janë shpallur dhe qëndrojnë hapur katolik. Të tjerët, nga frika, fshihihen përsëri dhe kur u bë regjistrimi, u shkruan muslimanë”.¹⁰⁷

Është interesant se qeveria serbe në atë kohë nuk lejonte që priftërinjtë katolikë të kenë kontakt të drejtpërdrejt me kriptokrishterët apo laramanët në argjipeshkvinë Shkpu-Prizren, duke etiketuar priftërinjtë se bënë propagandë austriake, por Mjeda i viziton laramanët në Karadak apo në Malin e Zi të Shkupit dhe u jep kurajo që të deklarohen publi-kisht si katolik e mos të mbesin të fshehur apo zyrtarisht të deklarohen musliman. Për fat të keq, kishte edhe muslimanë fanatik shqitparë që këta laraman i frigonin se së shpejti do të kthehet Turqia në këto troje dhe të kenë

Lazër Mjeda shkruan për këtë gjë kështu: “Qeveria i ndaloi priftërinjtë të shkonin tek ata dhe të komunikonin me ta, me pretekstin se bënë propagandë austriake”.¹⁰⁸ Pastaj Mjeda vazhdonë të njëjtin raport: “Duke qenë në këtë gjendje gjëra, mendova të shkoja në këto vende e të shikoja se ç`mund të bëhej. E në fakt, në ditën e shtatë të këtij muaji shkova në Letnicë e dergova të thirrnin njerëzit e njohur të fshatrave të ndryshëm. Ata erdhën. I pyeta pse donin të ishin katolikë e ç`mendnin të benin. M`u përgjigjën me një

¹⁰⁷ Gjergj Gashi, Kosova II. fq. 66.

¹⁰⁸ Gjergj Gashi, Kosova II. fq. 66.

zë se ishin katolikë dhe katolikë donin të mbetëshin; por te frikësuar nga njëra anë nga kërcënimet dhe ngacmimet e serbëve, e nga ana tjetër nga mburrjet e muslimanëve, të cilët thonin se së shpejti qeveria turke do të merrte këto krahina dhe do të hakmerrej egërsisht nga tradhëtia e tyre, ishin terhequr e s'ishin shfaqur publikisht katolikë, se prisnin kohë më të mira atje.

Iu përgjigja të mos i dëgjojnë muslimanët, se nuk kishin asnjë mundësi se mund të merrnin i qeverinë, nga serbët të mos trembeshin shumë, meqë në atë kohë nuk kishin mundur t'i kryenin të gjitha kërcënimet e tyre, por po të ndodhte, do të viheshja përbri tyre, për t'i mbrojtur dhe për të vdekur me to. Fituan besimin në votete e kërkuan se ç' duhej të bënin. U shtova atyre: Tani unë nuk jua kërkoj të shkoni shpejt tek qeveria për të bërë rrëfimin tuaj të besimit e të nënshkruaheni katolikë, sepse ka të ngjarë që tani nuk do të pranini, e nga ana tjetër mund të përbënte rrezik, meqë jemi në rrethanat e gjendjes së luftës. Për t'u njohur katolikë, unë ju kërkoj juve që deri në një urdhër t'ëri, të shkoni në kishën katolike një nga një, por ditën, që t'ju shohin të gjithë; që t'i merrni Sakramentete Shenjta, e se lipset ta thirrni ditën priftin, e jo natën. Kështu, në mënyrë indirekte, mund të ndreqni regjistrimin musliman të bërë pranë qeverisë. Për të dhënë këto shenja të rezistencës, ju jap kohë deri ditën e Shën Kollit (6 dhjetor); nderkohjë lidhuni me të fshehurit (laramanët) e tjerë që njihni dhe kërkoni që edhe ata të bëjnë të njëjtën gjë e të jenë solidarë, nëse qeveria do t'i krijonte ndonjë shqetësim.

Mbetën të kenaqur nga kjo zgjidhje dhe premtuan të bënin ç' i thashë.”¹⁰⁹

Në këtë raport kërkon Mjeda poashtu nga kardinali Gotti këshilla se si duhet të sillet si ipeshkëv rreth sakramenteve me laramanët në argjipeshkvinë e vet.

¹⁰⁹ GASHI Gj. Kosova Altari i Arbërisë, II, fq. 66-67.

Qeveria beogradase në atë kohë dhe më vonë kishte kërkuar nga priftërinjët e argjipeshkvisë Shkup-Prizren emrat që janë të pagëzuar dhe që janë të shënuar në këtë libër, duhet të fshihen dhe kjo punë të mos ndodh më. Pagëzimi apo deklarimi haptas i kriptokatolikëve si katolik në argjipeshkvinë Shkup-Prizren shihej me sy të keq nga ana e politikës së Beogradit, shihej si akt kundërshtetëror dhe kërkohej nga priftërinjët që këto gjëra mos të ndodhnin apo ata persona që dëshirojnë të dalin haptas si të krishterë, të deklarohen ortodoks. Kurse të njëjtën kohë, edhe përfaqësuesit fetarë të besimit musliman kërkonin nga Beogradi që kjo gjë të mos ndodhë më dhe e alarmojnë Beogradin për këtë akt "jopatri-ot"¹¹⁰ që kleri katolik po pagëazon ata persona.

Për kohën kur L. Mjeda ishte argjipeshkëv në Prizren misionet flutarake të jezuitëve kishin përshkruar edhe detaje për gjendjen e laramanëve në këtë argjipeshkvi.¹¹¹ Një libër në gjuhën kroate mbi veoprintarinë e Jezuitëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni prej 1888-1912 është përgaditë nga autori i këtyre rreshtave dhe i është dorëzuar në Zagreb për botim, dhe rreth veprimtarisë së jezuitëve mes laramanëve në argjipeshkvinë Shkup-Prizren mund të lexohen shumë detaje në atë dorëshkrim. Sipas letrës së Genovizzi-t dërguar provicës së vet në Milano, Shkup më 28. janar 1912 shifet se

¹¹⁰ Krhs. ZUTIC Nikola: Rimokatolicka misija i klerikalizam na Kosovu, fq. 108.

¹¹¹ Mbi laramanët në argjipeshkvinë Shkup-Prizren gjatë kohës kur L. Mjeda ishte argjipeshkëv shif edhe raportin e atë Giovanni Battista della Pietra për misionin fluturues të mbajtur në argjipeshkvinë Shkup-Prizren më 1911 në: Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1912, fq. . 20-31 dhe raportin e Atë Francesco Genovizzi për misionet në këtë argjipeshkvi më 1911 dhe 1912 në Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1913, fq.. 3-20. Këto dhe detajet tjera janë poashtu në librin e përgatitur nga Albert Ramaj dhe që është dorërrëzuar në botim në Zagreb.

autoritete turke kërkonin nga laramanët e argjipeshvisë Shkup-Prizren që së paku kryefamiljari të shkon haptas në xhami.¹¹² Në këtë letër shifet shumë qartë se jeta e laramanëve në këto troje, sidomos në Karadakun e Shkupit nuk ishte aq e lehtë.

Është interesant se në misionin fluturues të Jezuitëve ishte edhe një misionar nga Stublla e Kosovës që quhej Fratel Zef Antunoviçi.¹¹³ Zef Valentini ka shkruar një shkrim për fratel Zefin dhe cek se ai vjen prej rrethi laraman.¹¹⁴ Dhe ishte me rëndësi që ai iu bashkangjiti misioniart Domenico Passi, sepse njiofte shumë mirë mentalitetin e laramanëve në trojet e argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Fratel ishte bashkangjitur misionarëve jezuit jo vetëm për territor të Kosovës, por edhe të Shqipërisë. Kete e përshkruan shumë mirë edhe : Cordignano në librat e tij „L`Albania“ Fratel Zefi kishte jetuar kohë të gjatë në Shkodër, ku më 1936 kishte vdekur.

Në kohën e Lazër Mjedës kishte edhe priftërinjë katolik që vinin nga vendet laramane, sidomos të Zonës së Karadakut të Shkupit, sikur fshatrat Lubishte e Zhegër në afërsi të Gjilanit. Ato vende ishin gati „krejtësisht“ muslimane apo laramane, sikur Viktor Pashku që zyrtarisht quhej Shahin Ferizi apo siç dihet me emrin Atë Viktor Pashku apo Viktor Paskes nga Selishta e Gjilanit dhe që më vonë nga qeveria franceze kishte marrë çmimin shumë të njohur “Palme d`officier d`Accademie” për përhapjen e kulturës franceze. Nga Zhegra kishte edhe një tjetër meshtar që quhej Ahmet Fazlija.¹¹⁵ Viktor Pashku shkruan për vendlinjen e vet kështu: *“Pasi që myslimanët e fshatit tonë ishin tejet fanatik, ne s`mund të*

¹¹² Shif: Lettere edificanti dei padri della Compagnia di Gesu della Provincia Venta, Serie XXII, Venezia 1913, fq. 3.

¹¹³ Mbi jetën e Zef Antunoviçi shif A. Ramaj, Burime dhe dëshmi, fq. 108-118.

¹¹⁴ Giuseppe Valentini “Il Fratel Zef e la Missione volante”, Notizier agli Amici dei gesuiti larnardo-veneto-emeliani, Milano, 2 (1972), fq. 36-41.

¹¹⁵ DJURIC F.: Die Geschichte der Krypto-Katholiken fq. 204.

shpallnim haptas fenë tonë të shenjtë. Para syve të mi ra viktimë vëllau im kur morën vesh se jemi katolik. Nga frika prej hakmarrjes, si është adeti tek ne, deshëm të më vrasin edhe mua. Miqët tanë më fshehën dhe më çuan në Cërnegore, pastaj në Prizren te famullitari Simon Lumezi....

Të gjithë e din se isha detyruar të braktisi Selishtën në moshën 6 vjeçare për të shpëtuar nga masakri, viktimat e ti cilit ranë ati im i mjerë, nëna ime dhe sa mija të tjerë shqiptarë katolik nga fanatizmi turk. Fshati ynë e kujton përherë vdekjen e babës dhe të nënës sonë, si dhe të mijëra shqiptarë të tjerë që i mbytën turqit fanatik vetëm përse janë `Katolik`.”¹¹⁶

Për persekutimin e katolikëve në Kosovë e Maqedoni ishin marrë edhe shumë revista europiane, jo vetëm ato vjeneze, poashtu edhe për çështjen e laramanëve në këto troje. „Le Missioni Cattolice“ e Milanos kishte shkruar që ata dëshironin të deklalroheshin haptas si katolik. Gazeta e cekur milaneze kishte shkruar një shkrim tejet interesant për gjendjen e Kishës katolike në Kosovë më 20. VI. 1913 dhe trajton temën se si është e mundur që Serbia kishte luftuar kundër turqëve, pra muslimanëve, dhe si të krishterë tash luftojnë kundër krishterëve katolikë shqiptar dhe aktet barabara ndaj popullatës shqiptare dhe se thuhet se siç duket ky është fillimi. Në këtë shkrim ndër të tjera shkruhet edhe për laramanët e argjipeshkvisë Shkup-Prizren. Kur Mbreti serb Peter I. kishte shkuar në Shkup më 24 janar 1913 dhe kishte takuar 50 familje laramane që i kishin deklaruar atina haptas se dëshirojnë të jenë katolik. Mbreti i zëmëruar u kishte thënë: „Katolikë! Keq e shumë keq! Ose ortodoks ose muhamedan, e kursesi katolik“. Shkrimin e ngjashëm e shkruan edhe gazeta katolike e Splitit të Kroacisë „Dan“ më 2 korrik 1913 poashtu shtjellon të njëjtën temë me titull „Mëshohu katolikëve dhe lirisë së tyre.

¹¹⁶ Shih. KRONIKU, in: Drita XV, 11-12 (107), 1984, fq. 8-9.

Dihet se Serbia sidomos gjatë luftrave ballkanike dhe të parës botërore kishte problem të madh me klerin katolik dhe besimtarët e tyre, sidomos për shkak që katolikët shqiptarë trajtoheshin gati njëjtë sikur austro-hungarezët. Kështu që laramanët e këtyre trevave me dashje apo pa dashje për shkak të politikës ditore ishin të detyruar që edhe më tutje mbesin laraman e nuk i lente që të deklaroheshin haptas katolikë, pra, ashtu si ata dëshironin vetëm. Serbia e Mali Zi kishin qëllim tjetër, pra që të konvertonte (me dhunë) edhe jo ata laraman shqiptarë, por edhe katolikë dhe muslimanë shqiptarë në ortodoksizëm. Këtë qëllim tentuan Mali i Zi e Serbia sidomos në vitin 1913, sidomos në pjesën e Pejës, Gjakovës dhe të Malit e Zi të sotëm.¹¹⁷ Atë luigj Paliqi nuk i lentë besimtarët e vet që të konvertoheshin në ortodoksizëm dhe për këtë arsye u vra nga forcat malazeze më 1913 në Janosh afër Gjakovës. Lazër Mjeda përballej jo më vetëm me problemin e laramanëve në këto troje, por edhe të besimtarëve që prej represaljeve, torturave, dhunës e mundimeve të lloj-llojshme ishin të detyruar se paku që sipërfaqësisht shqiptarë edhe të besimit katolik e musliman të deklaroheshin si ortodoks, sepse nuk mund ti përballonin gjithë atyre hjekave të mëdha që i bëhej popullit shqiptar. Lazër Mjeda si bari i mirë viziktonte këto vende dhe u jepto kurajo që mos të bëjnë një gjë të tillë. Viozita e tij më 27 maj kishte vizituar Gjakovën dhe kishte biseduar me besimtarët e vet për deklarimin e dhunshëm të tyre.¹¹⁸ Për konvertimin e shqiptarëve (muslimanë e katolikë) në ortodoksizëm Noel Malcolm thotë: „*this was applied with peculiar vigour by the Montenegrins*“.¹¹⁹ Është shumë e vërtetë se Lazër Mjeda

¹¹⁷ Për këto gjëra shif mnë shumë Zekeria Cana Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente). Falenderoj Atë Ndue Kajtazin OFM, meshtar në Gjakovë që ma dërgoi me postë në Zvicër këtë libër.

¹¹⁸ Zekeria Cana, Gjenocidi i Malit të Zi, fq. 216.

¹¹⁹ Malcolm Kosovo, short story, fq. 254.

nuk ishte angazhuar vetëm për katolikët e konvertuar në territorin e okupuar nga Mali i Zi më 1913, por siç cekët „për të gjithë të gjitha konvertimet tjera me dhunë”,¹²⁰ pra edhe për muslimanët dhe laramanët shqiptar. Më 19. 03 1913 lidhur me këto probleme shukruan Lëzër Mjeda këhstu: “me shëndet jam mirë; shumë gjera të këqija, te vështira i kam pasur këto dite, arsyeja kryesore/salvimet e trishtueshme, te hatashme të shpërthyer kundër katolikëve nën pushtetin malazez. Më se 70 familje fand kanë kalua në skizmë dhe ekziston rreziku me arsye që edhe të gjitha familjet tjera të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke mos pasur rrugëdalje. Tri fashtra kanë pasur mundësi natën të hikin në territorin nën pushtetin serb, duke lënë çka kanë pasë e tjerët s`kanë pasë mundësi ta kalojnë kufirin...”.¹²¹ Lazër Mjeda përnjëmend bari i mirë për besimtarët e vet, ai u jepte guxim që mos të lëshonin fenë e vet, i vizitonte ata rregullisht në kohët më të vështira. Më 16.III.1913 shkruan: “Tash jam vetë i nevojshëm për të holla, pasi kam pasur detyrë të kujdesohem për refugjatët e Gjakovës.....Dje për Rrëshajë jam kthyer nga Gjakova, e nesër prapë do të kthehem për tri-katër ditë. Pasi çështja e refugjatëve ende nuk u zgjodh, dhe populli asht në lëvizje tash këtu e tash atje, është e nevojshme kohë pas kohe t`i vizitoj dhe t`i ngushëlloj, duke u dhënë zemër dhe duke u ndihmuar materialisht, se kanë humbë çdo gjë dhe janë pa bukë. Kjo është arsyeja pse tani nuk mund të largohem, se përndryshe tani isha në ato anë.”¹²²

Më 1913-14 zhvilloheshin bisedimet mes Vatikanit dhe Serbisë lidhur më një marrëveshje zyrtare apo konkordatit. Përfaqësuesi zyrtar (ambasadorit) i Austrohungarisë në Vatikan Alois

¹²⁰ Cana, Gjenocidi fq. 165.

¹²¹ Mark Sopi. Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës, arritja e imz. Lazër Mjedës në Prizren, Drita, viti XIII, nr 3-4 (95) 1982, fq. 8.

¹²² Mark Sopi. Shembulli i Bariut të mirë dhe atdhedashës, fq. 8.

(Fürst) Schöngurg-Hartenstein dhe ministri i punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz jo që angazhoheshin për përmirësimin e gjendjes shqiptare dhe ruajtjen e protektoratit austro-hungarezë, por ishin të vetëdijshëm edhe për shumë imtësi për popullatën shqiptare, pra edhe për laramanët e këtyre vendeve dhe nga bisedat e shkrimet që shëndrroheshin mes zyrtarëve austrohungarezë dhe të kardinalit Merry de Val kërkohesh që nga Vatikani të bisedon edhe për lirinë fetare të laramanëve në Argjipeshkvinë Shkup-Prizren nga ana e Serbisë. Më 12. mars 1913¹²³ lajmron ambasadori i Austro-Hungarisë në Romë Schönburg se kishte biseduar me Vatika-nin lidhur me lirinë fetare të laramanëve në argjipeshkvinë e Kosovës. Kështu që qysh në fazën e parë të bisedimeve lidhur me konkordatin kishte shprehur dëshurirën për të siguruar klirinë fetare të laramanëve. Në qarqet e Vatikani ishte të brengosur për laramanët. Vjena dhe Roma ishin të njoftuar për gjendjen e laramanëve pas largimit të Turqisë nga Ballkani, por tash kishin lindur probleme të reja për ta, pra Serbia. Në këtë letër ceket se për gjendjen e laramanëve në argjipeshkvinë Shkup-Prizren ishin njoftuar nga raportet e ndryshme, pra të argjipeshkvekit Lazër Mjeda.

Këtë e dëshmon edhe letra e ministrit të punëve të jashtme Leopold (Graf) Berchtold më 02. VI. 1914 dërguar përfaqësuesit Alois (Fürst) Schöngurg-Hartenstein.¹²⁴

Dihet se raportet e Mjedës ishin ato që kishin nxitur këtë bisedë, sidomos nga letra e Mjedës më 09. 01. 1913 dërguar ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold von und zu Ungarschitz ku i spjegon gjendjen e laramanëve në argjipeshkvinë e vet. Sipas kësaj shkrese ministri Berchtold për gjendjen e laramanëve në argjipeshkvinë

¹²³ HHStA. PA, XIII, 314 Türkei, XXXIV / 5 A, më 12. shkurt 1913.

¹²⁴ Shif HHStA. PA. XIX, 93, Serbien XVIII/ (Rom - V.) 2480, më 02. VI. 1914.

Shkup-Prizren është “formalist” i kënaqur prej asaj që është biseduar dhe është shkruar mes kardinalit Merry de Val dhe Alois Schöngurg-Hartenstein, pra Serbia ishte e obliguar që tu jep të drejtën e lirisë fetare laramanëve në këto troje.

Gazeta Reichspost e 20 marsit 1913 shkruan poashtu për aramanëdhe gjendjen të tyre në argjipeshkvisë Shkup-Prizren dhe shkruan se ata deri më tash nuk kishin mund të deklaroreshin haptas për shka të tyrqëve, kurse tash e kanë problem prej Serbisë dhe shkruan se qarqet e Beogradit u kishin ndaluar laramanëve të deklaroreshin haptas si katolik, ose duhet të bëhen musliman e nëse dëshirojnë të bëhen të krishterë atëherë ortodoks.¹²⁵ Poashtu edhe Leo Freundloich e merrë këtë artikull dhe e riboton në librin etij “Albaniens Golgotha”.¹²⁶

Më 31 Janar 1911¹²⁷ njofton konzullata austriake e Shkupit se kishte pasur një grup nortodoks nga Maqedonia, më sakt nga Kumanova që kishin shkuar tek argjipeshkvi Lazër Mejda dhe tek famullitari i Ferizajit Dom Pashk Krasniqi dhe u kishin kërkuar ndihmën e tyre që ata të kalojnë në katolicizëm. Pra ishte fjala për besimtar ortodoks maqedon e që dëshironin të kalonin në katolicizëm. Është e njohur komuniteti greko-katolik me kombësi maqedone në Maqedonin e jugut, pra në Strumicë e rrethinë, por këta ishin taman ortodoks. Nuk është fjala për komunitetin katolik të ritit bizantin që jeton edhe sot e kësaj dite në territorin e Maqedonisë, por është fjala për ortodoks të vërtetë.

Komunitetin greko-katolik në Maqedoninë e sotme ia kishte besuar Papa Benedikti më 1915 argjipeshkvit të Shkupit L. Mjeda. Argjipeshkvi Mjeda ishte pra edhe argjipeshkëv i

¹²⁵ Der Konflikt mit Montenegro, Reichspost 20 mars 1913, fq. 2.

¹²⁶ Leo Freundlich, Albaniens Golgotha fq. 27.

¹²⁷ HHStA XXXVIII PA. 441, Konzullate Üskuüb 1911-1913 të datës 31 janar 1911, fq. 293-294.

katolikëve të rritit bizantin në Maqedoni, që më komb janë maqedonas. Argjipeshkvi Mjeda dëshironte që këtë komunitet të vizitonte vetëm dhe të shifte taman se si është gjendja e këtyre shpirttrave që papa ia kishte besuar. Organet e atëherëshme bullgare nuk i dhanë Mjedës leje që të viziton këtë komunitet. Viti 1915 ishte shumë vit i vështirë edhe për katolikët e rritit bizantin, sepse bullgarët kishin vra e mbytë dhe kishin shkatrruar gati çdo gjë që ata kishin, shtëpia e pasuri tjera. Pasi që Mjeda nuk mund të shkonte në këtë zonë, ai organizo që ndihmat tu dërgonte gjithësesi dhe përmes meshtarit P. Nedeljko, i cili më 20 mars 1916 i shkruan një letër falenderimi Mjedës për këto ndihma të rëndësishme.¹²⁸

VIII. Gjuha starosllavene në Janjevë dhe L. Mjeda

Një ndër problemet që në argjipeshkvinë e shkup-Prizren që paraqiteshin ishte edhe problemi i përdorimit të gjuhës së liturgji. Në fakt, pjesërisht Mjeda e kishte „trashëguar“ para se të vinte në argjipeshkvi. Parahistoria i këtij problemi ka të bëjë edhe me Malin e Zi.

Duhet që te cekim se argjipeshkvi i Djakovo-s së Kroacisë Juraj Stros Mayer ishte njëri ndër pishtërët e flakët që në Kishë të përdorët gjuha e vjetër sllave (staroslavenski). Me ndikim e tij ishte rikthyer në Mal të Zi pas nënshkrimit të konkordatit mes Malit të Zi dhe Vatikanit prap gjuha e vjeter kishtare, që më parë përdorej vetëm në disa vende të Dallmancisë.

Problemi i gjuhës së vjetërë sllave për ta kuptuar këtë, duhet që të cekim se Stros Mayer ishte i dërguari apostolik për Serbi dhe idetë e tija nuk mund edhe aq lehtë të pengoheshin, pasi që ishte njëri zyrtar si i dërguari apostulik për Serbi, kështu që

¹²⁸ Shif më shumë Rudolf Grulich, Die unierte Kirche in Maqedonien (1856-1919), fq. 91.

kjo gjë, jo vetëm që mund të ndikonte në Mal të Zi, por edhe në Kosovë, pasi që argjipeshkvia e Shkupit kishte disa teritore rreth Nishit që i përkisnin Serbisë.

Në konkordatin e Malit të Zi, poashtu edhe atë të vitit 1914 me Serbien dhe 1937 me Jugosllaninë ishin parqitë problemet konkrete (sidomos gjatë bisedimeve rreth konkordatit) të praktikimit të gjuhës starosllavene. Kjo gjuhë është gjuhë e vjetër dhe e vdekur dhe nuk përdoret në popull, por më parë është përdorë si gjuhës së vjetër sllave në shërbesa liturgjike, sidomos në disa vende të Dalmacisë.

Përdorimi i gjuhës staroslave ishte poashtu edhe problem në Janjevë kur Mjeda ishte argjipeshkëv. Qarqet politike të asaj kohe të Beogradit dinin se futja në përdorim e liturgjisë starosllave, sidomos në ato mejdise ku kishte shqiptarë katolikë, dhe nuk ishte nuk ishte edhe aq shumë qëllimi tek kroatët që gjindeshin në Janjevë apo në Letnicë. Në Janjevë shumica kurse në Letnicë të gjithë kanë jetuar më parë popullata kroate. Për këtë arsye, idea që në këto vende të përdoret edhe gjuah e vjetër staroslave ishte e kahmotshme (kqyre hyllin e dritës ku shkrun për ipeshkvin carev). Kurse në vitin 1908 sihte një konflikt që ndodhi në kishën e Janjevës për shkak të këtij përdorimi të gjuhës. Konzulli i atëhershëm në Shkup Rappaport lajmron Austro-Hungarinë që në Janjevë është bërë një lloj rrëmuje për shkak të përdorimit të gjuhës së vjetër sllave apo siç quhet edhe starosllavenski. Sipas Rappaport që më 10 dhe 24 janar të vitit 1908 shkruan një letër thotë se argjipeshkvi Carev kishte vu në përdorim në disa pjesë të liturigjisë në Janjevë që të përdoret kjo gjuhë.¹²⁹ për këtë konflikt që ndodhi në janjevë dhe që zgjati deri më 1914, më së shumti fajëson konzullata austro-hungareze nga Shkupi

¹²⁹ HHStA. P.A. XIV, K 31, Albanien, Liasse XXXI , Liturgiekonflikt in Janjevo 1908-1912, raport i konzullit Rappaport nga Shkupi më 24 janar 1908.

nacionalistin e tërbuar kroat Jakov Sliskovic.¹³⁰ Jakov Sliskovic kishte shkruar një libër „ Albanija i Makedonija dhe kishte prezentuar edhe gjëra të paskata në atë libër. Sliskovic ishte mësues në Janjevë dhe donte që me çdo kusht në Janjevë të mos ketë meshtarë shqiptarë, e siç dihet në Janjevë kishte edhe mehstarë shqiptarë, sikur famullitari don Shtjefën Krasniqi, kurse kapelan dom Pashk Krasniqi. Problemi ishte se kinse famullitari i këtushëm don Shtjefën Krasniqi paska dëmtuar „qëllimisht“ mesharin e liturigjisë „starosllavene“. Kurse popullata e merrte këtë si provokim. Në anën tjetër ishte edhe problem për ipeshkvin e atëhershëm Trokshin, sepse qëllimi i tij nuk ishte si shqiptar të ndërhyjnë në këtë problem, sepse ai mendonte që popullata do ta merrte si provokim këtë punë, për shkak se Trokshi është shqiptar. Prapseprap Trokshi u bëri shumë mirë me dije, nëse problemi nuk zgjidhet, do të ndërmer masat e tija si ipeshëv dhe siç e kërkonte Kisha katolike në atë kohë. Trokshi bazohej në atë se për përdorimin e gjuhës starosllavene në liturgji duhej të jepte leje të veçantë Vatikani për çdo territor. Të njëjtin problem e hasim edhe me ardhjen e Mejdës si argjipeshkëv. Përdorimi i liturigjisë starosllavene në Janjevë nuk ishte bërë deri më tani, përveçse famullitari i mëparshëm don Franjo Brkic kishte vendos që disa pjesë të liturgjisë si epistali dhe këndimi i ungjillit të bëhet në gjuhën starosllavene. Kurse famullitari don Pashk Krasniqi kishte lanë anësh edhe këndimin e Epistalit edhe të ugjillit në gjuhën starosllavne. Nuk ishte siç shifet problemi i përdorimit të gjuhës, sa ishte problemi se këtë akt kishte bërë një shqiptarë. Dhe në fakt, nëse analizojmë në ditën e sotme, akti i largimit të gjuhës starosllavene ishte krejtësisht në rrgull në aspektin juridik dhe praktik. Juridik sepse Vatikani ende nuk kishte

¹³⁰ HHStA. P.A. XIV, K 31, Albanien, Liasse XXXI , Liturgiekonflikt in Janjevo 1908-1912, raport i konzullit Lukes nga Shkupi më 13 korrik 1908.

dhënë një lloj leje të tillë, siç ishte e duhur, kurse praktik sepse ishte gjuhë që më nuk flitej dhe nuk përdorej.

Qysh në fillim të ardhjes së tij në argjipeshkvinë Shkup-Prizren L. Mjeda kishte deklaruar se dëshiron konfliktin liturgjik në Janjevë të rregullon si duhet dhe dëshiron që të fillon me reforma të reja në argjipeshkvinë e vet. Për zgjidhjen e konfliktit liturgjik në Janjevë e lajmron qysh më arritjen edhe konzullata austriake në Shkup, përkatësisht vicekonzulli Adamkiewicz qysh më 7 nëntor 1909.¹³¹

Argjipeshkvi Lazër Mjeda kishte vendos që problemin e përdorimit të liturgjisë ta rregullon Roma. Ai kishte vizituar Janjevën më 3 janar 1912 dhe kishte biseduar me famullitarin e vendin dhe me besimtarët lidhur me këtë punë.

Është e ditur se Mjeda nuk kishte problem aspak me Janjevën bile ai ishte përkrahës i shkollës së Janjevës dhe kërkonte rregullisht përkrahje financiare nga Austro-Hungaria për shkollën e Janjevës, jo vetëm por të, por edhe për të gjitha shkollat që gjindeshin pran famullove të atëherëshme në Kosovë e Maqedoni.

Në kohën e bisedimeve rreth konkordatit të mundëshëm mes Serbisë dhe Vatikanit, ishte edhe kjo bisedë. Vizitatori apostullik i Bosnes e Hercegovinës Pietro Bastien paralajmronte se qeveria e Beogradit është në gjendje që të manipulon dhe të instrumentalizon problemin e përdorimit të liturgjisë së vjetër sllave.¹³² Problem ishte shtypuar edhe në Këtu ishin në pyetje vetëm disa njerëz nga Janjeva që ishin në shërbim të Beogradit e asgjë tjetër. Sepse ata keqpërdornin atë çka populli i Janjevës dëshironte. Problemin liturgjik në Janjevë e kishte zgjidhur koha vetëm. Pra, me kalimin e kohës, ky problem ishte zgjedhur vetvetiu.

¹³¹ HHStA, MdAE, AR 27, Bischöfe-Miedia 7, 26, raport i Adamkiewicz.

¹³² Krhs. Gottsmann, fq. 459-460.

Në ditët e parat ë janarit të 1912 kishte vizituar persona-lisht Janjevën për të parë se si ishte gjendja rreth këtyre problemeve. Këtë gjë raporton edhe konzulli i Prizrenit më 8 janar 1912 Prochaska.¹³³ Mjeda kishte parë se problemi i kësaj pune ishte sidomos i mëparshëm në shkollë, konkretisht tek mesuesi Sliskovic që ishte më parë. Dhe mendonte që në Janjevë të dërgonte mësuesin Ndue Paluca. Tek Hylli (janar dhe shkurt) i dritës më 1935¹³⁴ spjegohen disa gjëra rreth Janjevës ku ka të bëjë edhe më punën e Sliskovic si mësues dhe nacionalizmi i tij kroat. Këtu shifet se ai kishte qenë më parë françeskan dhe kishte lëshuar rregulltarinë e ishte bërë mësues. Në fakt si mësues në Janjevë e kishte prurë prej Sarajeve Austro-Hungaria, por shumë shpejt e kishin vërejtuar se ishte bërë një gabim për këtë punë.

Në fakt Mjeda kishte dërguar landën në Vatikan për të vërtetuar dhe vendosur nga Vatikani punën e përdorimit të gjuhës së vjetër sllave në liturgji dhe këtë punë dhe kishte bërë një komision i mëvonshëm që kishte analizuar analizuar këtë punë dhe kishte vërejtuar se puna e përdorimit të liturgjisë në gjuhën e vjetër nuk ishte në rregull në territorin e argjipe-shkvisë Shkup-Prizren, në fakt edhe për Janjevën, por për fat të keq, kjo gjë u instrumentalizua nga disa nacionalistët, apo më mirë të themi nga instrumentalistët e Beogradit.¹³⁵

Në janar të vitit 1914 L. Mjeda kishte udhtuar për Romë dhe vet nga Roma Lazër Mjeda përveç gjërave tjera kishte njoftuar

¹³³ HHStA. P.A. XIV, K 31, Albanien, Liasse XXXI , Liturgiekonflikt in Janjevo 1908-1912, raport i konzullit Prochaska nga Prizreni më 13 korrik 1908.

¹³⁴ Njoftime historike mbi argjipeshkvijt e Shkupit, Hylli i Dritës, IX, shkurt 1935, nr. 1, fq. 33-37 dhe nr. 2, fq. 92-98.

¹³⁵ Krahaso më shumë Andreas Gottsmann, fq. 458-460, Colak-Mazuran, Janjevo, fq. 183.

Vatikanin dhe ambasadën austro-hungareze për së afërmi lidhur me përdorimin e gjuhës starosllave në Janevë. Për këtë arsye Austro-Hungaria, përkatësisht vet ambasador i Schönburg pretendonte me çdo kusht që kjo gjë mos të trajtohet në kuadër të protektopratit të mundshëm, sepse ka të bëjë vetëm me disa persona nga Janjeva që janë në shërbim të Beogradit. Me ndërhyrjen e Austro-Hungarisë, nuk u muarr parasysh fare në konkordatin e 1914 qështja e shërbesës në gjuhën „staroslavenski“ apo edhe përdorimi i shkronjave gllagolike.¹³⁶

Koha kisthe rregulluar këtë punë vetvetiu dhe nuk kishte nevojë të merret ndokush më me këtë punë.

IX. E vërteta për largimin e Mjedës nga argjipeshkvia Shkup-Prizren

Në disa shkrime gjejmë të shkruar edhe të autorëve shqiptarë, pohimin se Lazër Mjeda e lëshoi argjipeshkvinë Shkup-Prizren qysh me 1911 dhe se deri më emërimin e ipeshkvit të ri, Janez Gnidovec, nuk ishte i pranishëm. Kështu shkruajnë Milan Premrou M,¹³⁷ Gaspër Gjini¹³⁸ Zef Mirdita,¹³⁹ Aloiz Turk.¹⁴⁰

Kjo nuk mund të jetë e saktë, sepse Mjeda e lëshoi argjipeshkvinë më 1911. në këtë pjesë do të trajtojmë këto gjera dhe shifet taman se si është puna dhe do të trajtojmë punën e Mjedës sidomos prej 1914 deri më 1921.

¹³⁶ HHStA, PA. XIX, 93 Serbien XVIII/ 1, 17 B, Raporti i Schönburg, më 19. maj 1914.

¹³⁷ Premrou Milan, Katolicki nadbiskupi u Skopjlu, glasnik skopskog naucnog drustva, Shkup 1926.

¹³⁸ Gjini Gaspër, Ipeshkvia, fq. 203.

¹³⁹ Zef Mirdita, Shqiptarët në dritën e politikës së jashtme të Shkrimi në Dardania Dacra shqip, poashtu është ky shkrim në anglisht e kroatish i botuar.

¹⁴⁰ Turk, Letnica, fq. 57.

Argjipeshkvi Mjeda në letrën e tij të datës 09.01.1913 ministrit të punëve të jashtme austro-hungarez Leopold (Graf) Berchtold¹⁴¹ cek një gjë shumë interesant se, katolikët shqiptarë të argjipeshkvisë së vet nga ana e Serbisë konsideroheshin si “armiq të shtetit serb”. Shqiptarët katolik, e sidomos klerikët katolik, paraqiteshin si armiq të shtetit serb e dëshmojnë edhe sot vet autorët serb dhe tregojnë se njerëzit më të rrezikshëm për shtetin jugosllav ishin klerikët katolik shqiptar, e sidomos Lazër Mejda që edhe „serbofon“ e quajnë¹⁴² Kurse atë Gjergj Fishtën e quajnë „serbofonin më të madh të njerëzimit“.¹⁴³ Mjeda në letrën e 09. 01. 1913 më tej thekson mendimin se do duhet të bëhej ndonjë marrëveshje mes Selis së shenjte dhe Serbisë për lirinë fetare, sepse gjendja e katolikëve që gjende-shin nën territorin e Serbisë ishte shumë e vështirë.

Në disa shkrime lidhur nganjëherë paraqitet “largimi” i Mjedës së 1911 se ishte me vetdëshirë. Kjo është thënë dhe thuhet edhe sot se ai ka lëshuar argjipeshkvinë me dëshirën e vet dhe se ai ka dashur të shkoj në Shkodër. Këtë e thotë edhe argjipeshkvi i Beogradit Aloiz Turk¹⁴⁴ dhe, në anën tjetër, kishte po ashtu zëra të cilët e akuzonin Mjedën për atë se, si ka mundur të bëjë këtë punë, pra si prijës i Kishës në argjipeshkvinë e Shkupit t`i len besimtarët e tij dhe detyrën për të ikur drejt Shkodër, dhe kjo në një kohë kur ndihej nevoja më e madhe për prezencën dhe mbrojtjen e tij. Kjo akuzë vinte sidomos nga shtypi slloven.¹⁴⁵

Në anën tjetër kemi shumë fakte se, Mjeda kishte lëshuar ipeshkvin e Shkupit pas dekretit që ishte lëshuar nga Papa

¹⁴¹ Krah Gj. Gashi, Kosovoa II, fq. 40.

¹⁴² Nikola Zutic, artikl nga Istorija 22 veka., krah. fq. 111.

¹⁴³ Nikola Zutic, artikl nga Istorija 22 veka., krah. fq. 112.

¹⁴⁴ Turk, Letnica, fq. 57.

¹⁴⁵ Lexo më shumë artikulin e gazetës Druzina të Ljublanës: “Na svetolnik postavljen, ob 55-letnici postavate skofa De. J. Fr. Gnidovec, 18.XI. 1979, fq. 13.

Benedikti XV. Dihet se më 14 prill 1909 Papa i Shenjt Piu i X ka dekretuar Mjedën për në argjipeshkinë e Shkupit, dhe 12 vite më vonë është emëruar argjipeshkëv metropolitan i argjipeshkvisë së Shkodrës nga Papa Benedikti XV me dekretin e datës 19. Tetor 1921. Dhe kjo kishte ndodhur pas vizitës që i kishte bërë rajonit vizitatiri nga Vatikani monsinjor Ernesto Cozzi i cili kishte konstatuar se ai ishte i vetmi njeri që ishte i përshtatshëm për ta bërë prijës të kishës në Shkodër. Pra, ai sipas këj vlersimi, me 14. Shkurt 1922 kthehet në Shkodër për të vepruar deri me vdekjen e tij më 1935.¹⁴⁶

Mjeda deri më 1921 kishte qëndruar në Prizren. Deri më 1918 dëshmojnë dokumnetetë që gjinden në Vjenë, në dosjen "Prizren, apo në raportet e konzujve austro-hungarez nga Prizreni.¹⁴⁷

Raportet e Lazër Mjedës dërguar në Vatikan e Vjenë dihet se ishin deri më 1921, pra kur ai qëndronte në Prizren. Disa nga raportete ka publikuar edhe Gjergj Gashi në librin e tij Kosova - Altari arbërisë dhe poashtu në Vatikan dhe Arbëria, kështu që siç duket është bërë një lëshim i madh nga historianët apo autorët tanë që thonë se Mjeda kishte lëshuar argjipeshkinë Shkup-Prizren qysh më 1911. Burimi i këtij gabimi duhet të jetë tek M. Premrou dhe se gabimi i tij është stërcituar në botime të ndryshme.

L. Mjeda më 28 nëntor 1916 kishte nda sakramendit e krezmimit edhe Gonxhe Bajaxhiut (Nënë Terezës) e kumbara i saj ishte Tade Simon Shiroka. Për këtë është dokumenti (Fletëkrezmimi) i saj.¹⁴⁸ Dihet edhe raportet e Mjedës që rregu-

¹⁴⁶ Krah. Markus Peters, Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung, Bildung und Kultur, Hamburg 2007, fq.423-424.

¹⁴⁷ Krahaso HHStA, Diplomatie und Außenpolitik 1848-1918 GKA KsA, Konsulatsarchiv Skutari, Kt. 11, kath. Klerus, Miedia.

¹⁴⁸ Për më shumë shif. Alber Ramaj, Mutter Teresa... fq. 56.

llisht i dergonte nga Prizreni deri më 1921. Një raportë i Mjedës për vdekjen e 1000 personave në Prizren paraqet edhe Noel Malcolm¹⁴⁹

Konzullata e Shkupit, konkretisht konzulli Lejhanec njofton më 26 korrik 1911¹⁵⁰ lajmin e Kolë Bojaxhiut (baba i Nënë Terezës) i cili kishtë shkuar sëbashku me Luigj Naracin tek konzullata italiane në Shkup për të hapur një shkollë italiane. Në këtë raport shifet se Kolë Bojaxhiu ishte më afër me konzullatën italiane sesa austriake. Më poshtë në këtë raport njoftohet se Mjeda nuk kishtë ndërmarrë asnjë hap të duhur, por pret një herë nga Vjena konstruksione të caktuara. Nga letra e konzullit Lejhanec shifet se L. Mjeda kishtë njohur shumë mirë Koë Bojaxhiun, babën e Nënë Terezës.¹⁵¹

Me konkordatin e 1914 shihet shumë qartë se Serbia dëshironte centralizëm për Kishën katolike, pra që çdo gjë të kontrollohet vet, nëse ishte e mundur. Marrëveshja (konkordati) nuk kishtë sjellë përmirësim të gjendjes së katolikëve shqiptarë, përkundrazi. Me sa shihet si një nga qëllimet kryesorë të Serbisë duhet të ketë qenë njohja indirektet pushtetit serb nga Vatikani edhe në ato pjesë si Kosova dhe Maqedonia. Dhe, meqë vet kleri katolik shqiptar ishte ai i cili e luftonte politikën serbe dhe ishin kundër nënshtrimit të këtyre pjesëve të banuara me shqiptarë pushtuesit serb, marrëveshja ishte e mirëseardhur.

Mjeda nga ana politikës jugosllave gjykohej si njeri shumë i rrezikshëm, sepse ai ishte vënë në mbrojtje të pa dallime të shqiptarëve, dhe mu kjo e bënë atë të kualifikohet si i rrezikshëm. Duke pasur parasysh rrethanat e kohës dhe gjendjen e arsimit të popullatës, ishte kleri ai që kishtë

¹⁴⁹ Noel Malcolm, Kosovo, fq. 261-262.

¹⁵⁰ HHStA, HHSa, F 27, 139 Missionen Üsküb 1871-1911, Üsküb I, 1, raport i Lejhanec më 26 korrik 1911.

¹⁵¹ HHStA F27/K 135 - Missionen Üsküb 1871-1911, raport i konzullit Lejhanec nga Shkupi më 26 qershor 1911.

njohuri, aftësi e mundësi për t'iu kundërvënë politikës serbe e malazeze. Argjipeshkvi Mjeda ballafaqohej me një problem tjetër. Ai ishte shtetas i Shqipërisë, dhe për këtë punë, me nënshkrimin e konkordatit të 1914 ishin të paraparë që meshtarët të mos jenë të huaj, përveç ata që janë të lindur në „Jugosllavi“. Edhe fakti që Mjeda për qeverinë jugosllave ishte një lloj „zullumqari“, me raportet e veta për mbrojtjen e të drejtave të besimtarëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Qeveria jugosllave dinte shumë mirë që L. Mjeda kishte lidhje të forta me botën perëndimore dhe e shihninin si të rrezikshëm.

Më 25 shkurt 1915 shkruan Mjeda Beogradit lidhur me emërimin e famullitrit të Shkupit, pasi që më shumë se një vit më par kishte vdekur famullitari i atyshëm don Zef Ramaj. Qeveria dëshironte që edhe në emërimin e famullitarëve të ketë fjalën e vet. Mjeda vendos vetëm, pra pa konzulltim dhe për famullitar emëron dom Shtjefën Zadrimën, që Beogradi nuk ishte i pajtimit me këtë emërim. Poashtu Mjeda me një letër të 29. II. 1915 kishte problem me burgosjen e të tre meshtarëve të argjipeshkvisë së vet, sikur Milosav Hulak, Giovanni Nerkmër e Adolf Melan. Mjeda kërkon lirimin e tyre dhe dy të shkojnë të shërbejnë në famullinë e Nishit – famullia ishte pjesë e argjipeshkvisë Shkup-Prizren, kurse për njërin prej tyre kërkon që të vij të shërben në Shkup.¹⁵²

X. Mjeda duhej të emërohej administrator e pastaj argjipeshkëv i parë në Beograd - largimi nga Prizreni

Nga një raport i diplomatit austro-hungarez Schönburg del se kardinali Mery de Vall ishte personi i cili kishte pasur ndikim për konkordatin dhe se ai ishte që nuk ishte përherë në favor të elementit shqiptar, por diplomati Schönburg e shtyn në shumë gjëra atë të mendon dhe dëshiron të bind se mbrojtja e

¹⁵² Krhs. Dragoljub Zivojinovic, Vatikan, Srbija, fq. 83-84.

shqiptarëve është poashtu gjë që duhet patjetër të trajtohen edhe përmes konkordatit dhe kërkon që edhe e drejta e shkollave shqipe të mbrohen mbrohet përmes konkordatit. Ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë Bertchold dëshironte që me çdo kushtë kleri katolik shqiptar i argjipeshkvisë Shkup-Prizren të ketë mundësinë e shkollimit vetëm në Shkodër në seminarin papnor¹⁵³ dhe poashtu Serbia kishte problem që kleri katolik shkollohej jashtë, sidomos në Austri (Innsbruck).¹⁵⁴ Ideja e Serbisë ishte që të ngritej një seminar në territor të Serbisë dhe ideja ishte për në Beograd, dhe kjo të vendosej me konkordat, kurse Austro-Hungaria nuk lejonte një gjë të tillë, sidomos ministri i punëve të jashtëm i Austro-Hungarisë Berchtold.

Në të njëjtin raport shifet poashtu se po të krijohet një lloj seminar në Kosovë apo Serbi, Austro-Hungaria kërkon që në këtë seminar duhet patjetër të jetë poashtu edhe gjuha shqipe, nëse jo e para, e dyta apo së paku një seksion special i gjuhës shqipe. Ambasadori Schöngurg i kërkon kardinalit Mery de Vall, edhe nëse bëhet semianri në Beograd, duhet patjetër që të mësohet edhe në gjuhën shqipe.¹⁵⁵ Schöngurg duke parë se puna e nënshkrimit të konkordatit nuk mund të menjanohet, lajmron dhe kërkon nga ministri i punëve të jashtme të Austro-Hungarisë Berchtold që patjetër të krijohet një seksion i gjuhës shqipe edhe nëse bëhet puna që seminari të ndërtohet në Beograd.¹⁵⁶

¹⁵³ HHStA, PA. XIX, 93 Serbien XVIII/ 1, 5736, raporti i Schönburg më 9 dhjetor 1913.

¹⁵⁴ HHStA, PA. XIX, 93 Serbien XVIII/ 1, 17 B, Raporti i Schönburg, më 19. maj 1914.

¹⁵⁵ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) - V), 17 B, më 19. 05. 1914.

¹⁵⁶ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) - V), 25 dhe 26, më 7 qershor 1914.

Për sektionin e gjuhës shqipe në seminarin e mundshëm në Beograd Austro-Hungaria nuk dëshiron të lëshon pe në bisedime për konkordat,¹⁵⁷ poashtu edhe të shkollave shqipe. Sekcionin në gjuhën shqipe në seminarin në Boegrad, ishte i paraparë që të udhheq vet argjipeshkvi Lazër Mjeda.

Në qershorin e 1915 qeveria e Beogradit kishte dërguar në Romë përfaqësuesin (ambasadorin) e vet Gavrilovic. Kardinal Gaspari kishte pasur takim zyrtar me Gavrilovic. Në këtë bisedë ishte shfaqur edhe ideja që në Beograd të vendoset ipeshkvi siç ishte paraparë sipas konkordatit të 1914. Kardinali i propozon që për administrtor të Beogradit ka qëllim Vatikani të emëron argjipeshkvin L. Mjeda. Gavrilovic nuk ishte aspak me këtë ide i kënaqur dhe mundohet që të bind kardinalin Gaspari se Mjeda nuk gëzon aspak rrespekt dhe nuk ka kurfar besimi qeveria e Beogradit në Mjedën. Pra, është i padëshiruar në qarqet politike në Beograd e kështu që nuk do të ishte i kënaqur me këtë emërim. Mundësia e emërimit të Mjedës si administrator i Beogradit, do të ishte humbje fatale për Serbinë, sepse ekziston mundësia që pas luftës Mjeda të mbet argjipeshkëv i Beogradit e jo vetëm administrator. Papa Benedikti XV kishte dërguar Mjedës në fillim të marsit 1915 një tekst zyrtar të Papës që të lexon. D. Zivojinovic shkruan se është fjala për leximin e një enciklike për paqen, kështu që sipas saj del që papa kishte dërguar Mjedës tekstin për lexim para publikimit të ndonjë dokumenti që papa këshillohej me Mjedën apo diçka tjetër. Është e njohur enciklika për paqën e Papës Benediktit XV që quhet „Ad beatissimi Apostolorum principis“ dhe që është publikuar më 1 nëntor 1914. Ndostha Papa i kishte dërguar tekstin e enciklikës para se të publikohet, kurse Beogradi kishte marrë vesh më vonë, apo është fjala për

¹⁵⁷ HHStA., PA XIX, 93 Serbien XVIII / 1, raporti i Schönburg (Romë) - V), 32, më 23 qershor 1914.

ndonjë dokument tjetër zyrtar. Duhet kërkuar më shumë kjo gjë. Kjo ishte për Beogradin shumë shqetësuese dhe dëshironin që në krye të ipeshkvisë së Beogradit mos të vinte L. Mjeda, sepse siç thonin „ishte një i Austro-Hungarsisë dhe i Vatikanit“. Sipas mbledhjes qeveritare në beogradase të 3 shtatorit 1915, shifet se emërimi i mundshëm nga ana e Vatikanit i Mjedës për administrator të Beogradit do të ishte qëllimi i Vatikanit që përmes Mjedës të aprovohet politika e Vatikanit në këto troje dhe do të ishte një disfatë e madhe për Serbinë. Deri te emrimi i Mjedës për argjipeshkëv të Beogradit nuk erdhi. Serbia dëshironte që me çdo kusht të parandalohet emërimi i Mjedës një herë administrator e më vonë argjipeshkëv i Beogradit. Siç duket mandatin për administrator të Beogradit L. Mjeda e kishte. Këtë e potencon edhe N. Zutic.¹⁵⁸ Ndoshta kjo ishte vetëm gojarisht, apo edhe ndonjë shkrimletër nga Vatikani që i kishte drejtuar Mjedës, apo është ndoshta edhe fjala për „enciklikën“ që përmendëm më lartë e dërguar nga Papa Mjedës. Për këtë duhet të ndërmerrej ndonjë gjë kundër Mjedës, që jo të emërohet por edhe mundësisht të largohet nga territori i argjipeshkvisë Shkup-Prizren, pra mundësisht që të dëbohet në Shqipëri.

Qysh më 1918 kryetari i Prizrenit kishte alarmuar në Beograd se L. Mjeda është duke punuar vetëm për Shqipërinë dhe kthimin e saj në këto troje. Për fat të keq, kishte edhe meshtar në argjipeshkvinë Shkup-Prizren, që bashkpunonin me pushtetin e Serbisë, sikur ai Simon Picinic (kishte shkruar letër qeversie në Beograd), që ishte nga Istra e Kroacisë. Picinic e quan Mjedën „propagandues shqipar, i cili e urren Serbinë“ poashtu thotë se „për të nuk është me rëndësi katolicizmi, por mbajtja e shpirtit shqiptar dhe se qëllimi i tij ishte krijimi i Shqipërisë së madhe“¹⁵⁹dhe në qarqe të Beogradit shihet me sy

¹⁵⁸ Shif Zutic, Kraljevina . fq. 155-156.

¹⁵⁹ Zutic, Vatikan i Albanci, fq. 101.

të keq se Mjeda bashkpunonte jo vetëm ne rrethet kishtare në Shqipëri, por edhe me besimtarë të thjesht. Me Pecinic kishin ndhur edhe disa skandale e ekscese gjatë kohës së Mjedës. Kishe bashkpunuar ngusht me qeverinë e Beogradit. Ai kishte djegur fotografën e Fraz Josepf-it në Prizren dhe dëshironte që Zoja e Këxshillit të mirë të hiqte nga kalendari kishar të kësaj argjipeshkvie. Picinic ishte në shërbim të Serbisë. Për këtë kishte njoftuar L. Mjeda edhe Vatikanin me letrën e tij të 17 gusht 1921 Mjeda, konkretisht kardinal Van Rossum.¹⁶⁰ Mjeda ia kishte ndaluar Simon Picinic që të ketë shërbesa fertare në argjipeshkvinë e Shkupit.

Pecinic e kishte tradhtuar Mjedën dhe se informatat lidhur me aktivitetet e Mjedës në Prizren, i dërgonte Pecinic në Beograd dhe "jugosllavenët" kishin informacione të mjaftueshme për aktivitetin e L. Mjedës. Nga kryetari të atëhershëm i Prizrenit më 1921 (për shkak se Mjeda bënte "atak" në popullin serb me letrat e veta që i dërgonte botës mbarë) lindi ideja në qarqet politike serbe për kërkesë drejtuar ministrisë së punëve të jashtme: që ai të pensionohet e kështu gradualisht krijohet mundësia për ta larguar nga ipeshkvia jo vetëm Don Mikel Tarabulluzin, por edhe argjipeshkvin Mjeda.

Sipas literaturës dhe që citojnë burime arkivore të Beogradit,¹⁶¹ Imzot Lazër Mjedës i kishte ardhur një letër në gjuhën italiane nga Don Mikel Tarabulluzi datuar më 15 janar 1920, dhe kjo letër merret si arsytim nga regjimi i kohës se,

¹⁶⁰ Gjergj Gashi, Kosova II, fq. 165-66.

¹⁶¹ Kemi pyetur në arkivin e Beogradit se a është mundur që ti kemi dokumentët që kanë të bëjnë me Mjedën e ti kopjojmë, nuk na është lejuar. Disa shkenctar nga Kosova pretendojnë dhe theksojnë se i kanë ato dokumente, por dyshohet kjo punë, përveç literaturës serbe që kanë përdorur dhe ajo citohet, nuk duhet të kishin pasur në dorë dokumente nga arkivi ushtarak i Beogradit lidhur me L. Mjedën apo dom M. Tarabulluzin. Bile edhe citimet janë bërë të dobta, saqë lirisht mund të thuhet se janë plagjiatur.

këta dy po veprojnë kundër shtetit jugosllav, dhe kjo vetëm për faktin se ata përpiqeshin që mos të mbyllen shkollat në gjuhën shqipe cilat gjendeshin pranë famullive në Kosovë e Shkup. Kjo letër i bie në dorë pushtetarëve dhe don Tarabulluzi e burgosin (përsëri) më 24 korrik të 1921 ku dënohet nga gjykata e Gjilanit me 8 muaj burg. Don Tarabulluzin e kishin burgosur edhe më herët (1919) nën akuzën për veprime në kundërshtim me shtetin jugosllav. Dënimin me burg të Don Tarabulluzit gjykata e apelit në Shkup më 4 mars 1922 ia zgjati burgimin për 2 vite, vendim ky që vërtetohet edhe një gjykatë e Beogradit, si instanca e fundit. Qeveria serbe e dinte se, po të provonte në të njëjtën mënyrë edhe me Lazër Mjedën do të ketë probleme me karakter ndërkombëtar. Si alternativë veprimi kundër argjipeshkvit Mjeda ishte ideja e kryetarit të atëherëshëm të Prizrenit e vitit 1921 ku kërkon nga Ministria e Punëve të Jashtme që ai të pensionohet nga detyra e kështu gradualisht të mund të largohet nga Ipeshkvia e Shkupit, dhe kjo arsye të hej me argumentin se, "Mjeda bënte atak në popullin serb me letrat e veta". Më 16 janar 1919 shkruan L. Mjeda për Dom Mikel Tarabulluzin dhe burgosjen e tij kështu: "Fati i keq i don Tarabulluzit shumë rëndë më ka pikëllua. Edhe pse kam bërë çmos, duket se nuk është e mundur ta liroj. Sa kam ndërgjua për këtë ngjarje, fill i kam paraqitë ankesat e mia pranë Divizionit Kosovar dhe i kam sigurua që meshtari është pa faj, por nuk shitet kurrfarë suksesi. Kam shkrua edhe në Beograd ministrit për çështje fetare duke kërkuar drejtësinë, por me gjendjen e rrugëve sot, kur do të mërrijnë ajo atje. Çdo ditë pyes për te edhe më jepem premtime të mira, por ai gjendet ende në burg. Kisha shkua personalisht në Prishtinë për ta mbrojt... por që erdhi lajmi që ka nvdëkë imz. Toma Glasnoviqi. Ah, viti i ri për mua është shumë me dhembje! Kështu don Zoti, u bëftë vullnesa e tij".¹⁶² Siç duket është

¹⁶² Mark Sopi Marks Sopi, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës -

ndërru këtu Tomë me Nikollë Glasnoviqi, sepse Tomë Glasnoviqi nuk ka vdekë në këtë vit, por ai pas largimit të Mjedës nga Shkupi merr detyrën e administratorit apostullik.

Më 17 mars 1919 nga Shkupi i shkruan L. Mjeda i shkruan Romës, konkretisht kardinal Domenico Serafini letrën lidhur më gjendjen e rëndë të Kishës në argjipeshkvinë Shkup-Prizren ku edhe spjegon gjendjen e mjerë të Dom Mikel Tarabulluzit kështu:

Në letrën time të 11 janarit informova Lart. Tuaj të Nd. se kryetari i komunës së Vitisë (krahinë e Gjilanit) në 20 dhjetor kishte zënë rob famullitarin katolik të Cëmagorës, Don Mikel Mesues Trabulluzin, sepse kishte shkuar në një vend tek një i sëmurë, pa kërkuar leje tek autoritetet lokale, por duke ditur se atij si famullitar i vjetër i vlente çdo lloj pashaporte brenda kufijve të famullisë së tij.

Nga Vitia e kishin dërguar në Gjilan me duart prapa të lidhura, e kishin goditur me qyta pushke, e kishin lenë të ectë në këmbë për shumë orë midis baltës e shiut, megjithëse kishte me vete kalin e tij. Aty ishte futur në burg për rreth pesë orë dhe ishte denuar me njëzet ditë heqje lirie, që pastaj u kthyen në dyqind e dy dinare gjobë, që vetë ai duhet të çonte në Gjilan në 27 dhjetor. Kur kishte shkuar atje ditën e caktuar për të dorëzuar shumën e përmendur, i ishte thënë që për momentin ajo monedhë nuk pranohej, prisnin udhëzime nga Prishtina e ndërkohë i ishin bërë qortime të mëdha e kërcëmime të ashpra, sepse nxiste arbërit në revolte. Çdo shfajsim i tij nuk vlente, siç që pa vlerë ndërhyrja ime pranë Prefektit të Prishtinës, prej nga varet Gjilani. Më një janar, megjithë solemnitetin e ditës, e detyruan të nisej për Gjilan, duke mos e lejuar të celebronte meshën e shenjtë për popullin, siç e kishte për detyrë. Sapo arriti në këtë qytet, e mbyllën menjëherë në burgun e përgjithshëm në shoqërinë e keqbërësve dhe që

rreptësisht e ndaluar për çdo katolik që mund të vizitonte dhe t'i jepte ndonjë ndihmë, si për të ngrënë apo për të veshur, kështu që i mjeri duket të vuante nga uria, i ftohti, shqetësimi i instikteve, veç shoqërisë së keqe me njerëz vulgarë e të pa edukuar. Pas pesëmbëdhjetë ditësh që kishte ardhur, prefekti i ri u mor me këtë çështje dhe e futën në një birucë me dy zoterinj arberorët muhamedanë. Ditën e njezetë kur mbaronte denimi, u thirr nga prefekti e u mor në pyetje, e vënë përballë dy dëshmitarëve që thonin se e kishin dëgjuar t'u thoshte arbërorëve muhamedanë se Qeveria serbe s'e kishte të gjatë e do të vinte ajo e Arbërisë. Njëri nga dëshmitarët ishte një i poshtër, që në kohën e turqëve ishte bërë muahamedan, pastaj me serbët serb, me bullgarët bullgar, e tani është kthyer serb; e megjithëse njëri i shkatanrruar në çdo pikëpamje, ishte bërë xhandar në bashki dhe nga autoritetet serbe mbahej si njeri i besuar. I pyetur pasi kishte dëgjuar këtë, u përgjigj para dhjetë ditësh.

Falliteti dukej qartë para të gjithëve, pastaj kishte njezet ditë që prifti kalbej në burg. Megjithë këtë shpifësi nuk pati asnjë qortim ndërsa Famullitari, pas disa këshillimesh iu lejua të kthehej në qelen e tij.

Kjo është e vërteta e faktit e nuk vlen të thuhet se një incident tillë ka bërë përshtypjen. Më të keqe tek katoliket e mrekullinë më të madhe tek muhamedanet, të cilët nuk kanë parë kurrë prift katolik të trajtuar në këtë mënyrë të padenjë. Unë u ankova tek z. prefekt i Prishtinës për padrejtësinë ndaj priftit të pafajshëm dhe e pyeta nëse i ka dhënë një kënaqësi të denjë, por ai nuk u dha se e kuptoi.

Prandaj jam i detruar t'i drejtohem persëri Shkllq. Suaj të Nd. e t'i lutem me këmbëngulje të denjorë ta marrë në konsideratë këtë incident të pakëndshëm e të kërkojë që të ndreqet e keqja. Perveç kësaj, po deshi Sh. J. të urdhërojë që prifti të lihet i lirë pr të ushtruar misionin e tij të shenjtë në të gjithë famullinë e tij, e cila përqafon tre komuna, sepse autoritetet nuk

kanë pranuar T'ia japin këtë leje; e ky është një dhunim i hapur i lirisë së kultit. Me këtë rast, më lejoni t'i raportoj L. S. të Nd. disa fakte, prej nga mund të nxirret mënyra e padenjë përmes të cilës komandanti i komunës së Verbovcit, Milan Diiq, e ai i Vitisë, një Rista, i trajtojnë katoli-kët e këtyre krahinave.

Së pari, asnjë katoliku të këtyre vendeve nuk iu lejohe të shkoj e në Shkup, as në Kumanovë, as në Ferizaj për të shitur e blerë, kështu që të mjerët duhen të dergjen në varfëri. Së dyti, u kanë marrë armët të gjithë rojeve e xhandarëve katolikë dhe i kanë nxjerrë jashtë çdo sherbimi.

Veç të tjerash kryetari i komunës së Verbovcit, nën pretekstin e nxjerrjes së armëve fshehurazi e zbulimit të sekreteve që nuk i duhen, i goditi e përgjaku më kryesorët e katolikeve. Pastaj për famullitarin nuk tregoi asnjë kujdes e për fjalë të kota e detyruan të bëjë disa ore udhëtim për të shkuar tek ai e për të dëgjuar atë që ai do. Po ai nxorri me dhunë nga katolikët shumë të hollash, pa asnjë arsye të ndershme e i kercënoi me jetën cilindo që guxonte të fliste. Nuk u sollen më mirë ato të Vitisë.

Nje fare Lenci Nout, një katolik shumë i ndershëm nga Binça, pasi e rrahën mirë, i morën djetë lira turke ari e një herë tjetër njemijë leva bullgare. Ndreka Gjergji po nga Binça, i morën njëzet lira turke ari e katërqind leva bullgare. Koli Pjetrit po nga ia vend, trembëdhjetë lira turke e pesëqind leva. Shanit të Markut, katërqind leva.

Nocit të Sebës e Tomi Zefit njëqind leva secilit.

Gruas së Gegë Zefit po nga Binça, i morën dymijë e shtatëqind leva bullgare, sepse i shoqi me lejen e autoriteteve të Shkupit shkoi në Selanik, për të vizituar dy motrat e tij që janë Murgesha e Shen Vinkut nga Poli, në Institutin francez të atij qyteti.

Paratë u zhvatën nga një Gapi i Dodes katolik, i cili doli vullnetar për këto veprime të këtij kryetari komune. Ka edhe të tjerë, por po i kaloj për të mos të lodhur Lrt. T. Të Nd.

Megjithatë nuk mund të kaloj në hështje dëmin e konsiderueshëm që serbët e komunës së Verbovcit na kanë krijuar e vazhdojnë të na krijojnë duke prerë një numër të madh lisash të dy pyjeve që i përkasin njëri Menses Kryepeshkopale e tjetri kishës Famullitare. E megjithëse kryetari është lutur më shumë se një herë nga famullitari dhe rojet e pyjeve t'i pengonin këto plaçkitje e jo vetëm s'i kanë dhënë kur kanë pasur nevojë, po i kanë shtyrë këta njerez të veprojnë keq. Lidhur me këtë problem i lutemi Shkllq. S. t Nd. të urdhërojë që të dërgohet në vend një komision i nderuar, i cili të shqyrtojë dëmin e të përcaktojë shumën e dëmtimit.

Më vjen keq të them se autoritetet e Gjlanit dhe Prishtinës i lënë të sillen si perëndi këta prepotentë dhe nuk kujdesën për vuajtjet e popullsisë. Përkundrazi për çdo ankesë që bëhet, rëndohen mundimet. Prandaj gjendja e kësaj popullate është e mjeruar dhe padurueshme.¹⁶³

Poashtu në një letër tjetër të 17 gusht 1921 Mjeda i shkruan Romës, konkretisht kardinal Van Rossum për Dom Mikel Tarabulluzin dhe gënjeshttrat e qeversisë serbe lidhur letrën e e Tarabulluzit kështu:

Në datën 10 të këtij muaji i Nderuari Don Mikel Turabulluzi, famullitar i Letnicës, krahinë e Gjllanit, prefekturës së Prishtinës, u burgos nga autoritetet qeveritare të Gjllanit. Në datën 15 të po atij muaji zëvendësprefekti i dërgonte një telegram prefektit të Prishtinës, ku e ngarkonte t'i komunikonte Kryepeshkopit se famullitari i Letnicë, Don Nikel Tarabulluzi ishte dënuar për fajin kundë paragrafit të II të Kodit Penal Nr. 90, e në vend të tij të dërgonte një prift tjetër. Të

¹⁶³ Gjergj Gashi, Kosova II, fq. 131-134 dhe Albert Ramaj, Burime dhe dëshmi, fq. 209-212.

nesërmen pastaj. Perfaqësuesi im më dha një letër të Ministrit të kultit, ku më thoshte se ishte e informuar nga autoritetet e vendit, që famullitari i Letnicës, Don Mikel Tarabulluzi sillej në menyre që interesat e Qeverisë në ato krahina kërkonin heqjen e tij nga ajo famulli. Ngulmova pra ta zbatoja me shpejtësi këtë urdhër dhe ta bëja përgjegjës për vendimin e marrë!

Tani ia vlen të thuhet se Tarabulluzi do të ketë të metat e tij, por s`mund të preket në politikë, sepse nuk kujdeset, nuk ka asnjë aftësi për një shërbim të tillë.

Është për t`u ditur se kjo është e treta herë që burgoset i mjeri. Herën e parë, siç ka njoftuar në një rast tjetër Eminencës Tuaj të Nd., që në janar 1919, u mbajt për rreth 25 ditë nën praninë e keqbërësve. Faji që iu vu që se kishte shkuar për t`i shpëmdarë sakramentët një të semuri të famullisë pa lejen me shkrim nga kryetari i komunës. Famullia e tij përfshin tre komuna. Dëshën t`i vinin edhe faj politik, por dëshmitarët nuk ditën ta luanin mirë pjesën e tyre dhe u duk qartë fallsifiteti prandaj nuk u denua. (Por dëshmitarët e rrëmë nuk patën denimin nga qeveria).

Të dytën herë u burgos këtë vit në të gdhirë të Shtunës së Rrëshajve. Motivi ishte se çështja e 1919 nuk kishte qenë vendosur akoma, nga nuk e di se kush gjykatë e se duhej ta priste sentencën në burg; e pastaj sepse pa lejen e qeverisë kishte ndertuar një kishëz në Binçë, për qellime politike. (Kisha u ndertua gjatë pushtimit bullgar).

Qëndroi në burg tre ditët e Rrëshajve, pastaj u lirua për pathemelësi krimi.

Tani përsëri e kanë burgosur nën akuzën: shkatërrues të popullit dhe kundështar të Qeverisë.

Jam i Bindur, i Lartmadhërishmi Princ, se edhe këtë herë Don Mikel Tarabulluzi i gJORË është i pafajshëm e se z. Minister i Kultit është informuar keq, pasi arsyet e pëmdjekje kundër këtij prifti janë krejt tjetër nga sa thuhet.

Një arsye, por jo kryesorja, ishte kjo se, duke qenë Tarabulluzi i nderuar famulliar i nje vendi, ku ka një Shenjëtoare të Shëmtë Lumturës Virgjër Mari, Shenjtërorja e Zonjës së Madhe në Cernagore, siç duhet (që serbët e quainë manastir, e mendojnë se është si manastiri i tyre për të ardhur në qejf) është i ekspozuar ndaj vizitave të nëpunësve qeveritarë, të cilët në dukje shkojnë për gjoja shërbim, por në fakt vetëm për të ndrënë e pirë atyre që vinë. Nuk kënaq gjithnjë, sepse mbase s`arrijnë të dehen. Për këtë janë ankuar shpesh e kanë kërcënuar se do të hakmerren, aq sa e ndjeva për detyrë ta këshilloja Don M. Tarabulluzin të ishte më bujarë e t'i mirëpriste njerëzit, e t'i shmangëte mundimet e njerëzve e mos e vriste ndërgegja!

Një arsye tjetër, e unë mendoj të jetë më e forta e që flitet nga goja e popullit edhe klerit, janë intrigat e Don Tade Ivanoviqit, të cilit e nje tashmë ky konregacion.

Ky, që në fillim të mosbindjes që i bëri Kryepeshkopit, ka kërkuar të shkojë në famullinë e caktuar, me kusht që ta heqë të Nderuarin Don Mikel Tarabulluzin e Letnicës; e kjo për kapriçot e tij. Natyrisht unë s`mund të t'ia jepja këtë kënaqësi, edhe pse nuk kisha person tjetër për të dërguar në atë famulli. Prandaj u dha pas manovrave të tjera dhe kështu ka marrë t'i ngrinte kundër popullit dhe qeverinë. Me popullin që më i lehtë pajtimi, po me qeverinë ja kaq me fat. Ivanoviq është tepër në zemër të nëpunësve, e madje thuhet se paguhet nga qeveria si spiun. Është e qartë pse instituatat e tij gjëjnë terren të mirë."¹⁶⁴

Paralel me përndjekjet që i bënin Don Tarabulluzit dhe argjipeshkvit Mjeda, në korrik të vitit 1920 policia serbe burgosë 3 meshtarë shqiptarë – don Shjtefën Krasniqin (Famullitarin e Gjakovës, Atë Klement Miraj (famullitar i Pejës) Atë

¹⁶⁴ Botuar nga GASHI Gjergj: Kosova. Altari i Arbërisë 1910-1941, Imzot Lazer Mjeda, Tiranë fq, 131-134 dhe 161-163.

Serafin Koda (famullitar në Rajë-Mertur) ndërsa në vjeshtën e vitit 1921 policia burgos tashmë për të tretën herë Don Mikel Tarabulluzin (famullitar në Letnicë), nën akuzën e dyshimit se ishin të involvuar në organizimin e një kryengritjeje shqiptare. Këta rrinin në burg pa u gjykuar fare, kurse argjipeshkvi Mjeda kishte kërkuar pa reshtur fillimin gjykimi i tyre. Me muaj të tërë kaluan këta 4 meshtarë të pafajshëm nëpër burgje.¹⁶⁵ Për këtë rast propaganda e atëhershme serbe kishte informuar opinionin publik nëpërmjet gazetës Politika të datës 04.06.1921. Në shkrimin me titull „*Medju nama – nozem u ledja*“ (mes nesh – me thikë në shpinë) shihet shumë qartë se, kleri katolik për politikën serbe ishte ai i cili rrezikonte Serbinë dhe organizonte shqiptarët për kryengritje. Pas gjykimit të Don Tarabulluzit qeveria kërkonte që t'i ndërrohet vendi, nga famullia e Letnicës dhe Stubëll, në një vend tjetër, meqë qeveria serbe tashmë kishte vendosur që t'i mbyll të gjitha shkollat shqipe që gjendeshin pranë famullive në argjipeshkvinë e Shkupit, kurse si pishtarët kryesor të arsimit shqip ishin meshtarët, që kishte vepruar në shkolla në Shkup, Prizrenit, Janjevë, Pejë, Stubëll, Letnicës etj. Është shumë interesant se Dom Mikel Tarabulluzi kishte planifikuar të hapte shkollë në gjuhën shqipe më 1918 në Zhegër afër Gjilanit, ndërsa ky pretendim ishte gjykuar si provokim i madh për qarqet politike serbe.

Përndjekjet që i bëhen klerikëve dhe besimtarëve e shtyn Mjedën shtroj pyeten se, a do të mbes më ndonjë katolik në këto troje, nëse vazhdon kjo politikë kundër katolikëve shqiptarë në argjipeshkvinë e tij. Qeveria serbe kërkonte armë nga popullata katolike që fare nuk posedonin, i maltretonte duke përdorë mënyrat më brutale kundër popullatës katolike

¹⁶⁵ Colak-Mazuran, Janjevo, fq. 189, që shenohen dokumente arkivore të Vatikanit - Arhivin e Propagande Fide, Affari ecclesiastici straordinarii, Austria-Ungheria, fasc. 448, post. 1052-1056, nr. 628, fol 56-59, dhe poashtu fasc. 600. Fol. Pos. 1475-1476, fol. 28.

të pafajshme nëpër famullit e ndryshme të Kosovës. Më 1921 në famulinë e Zllakuqanit u maltretohen besimtarët shqiptarë, deri sa nuk iu thyejnë edhe eshtrat e tyre, në të njëjtin vit në rrethin e Gjakovës janë djegur shumë fshatra dhe vriten shumë besimtarë katolik. Bëhej një luftë që kishte edhe pasoja psikologjike e shtimit të frikës në popullatë me vrasjen e Atë Luiq Paliqit (1913) dhe burgosjen e 4 meshtarëve (1920/21).

S`ka fare dyshim se, qëllimi kryesor i politikës dhe diplomacisë serbe ishte përgatitja që imzot Lazër Mjeda sa më parë të largohet prej Kosove por edhe klerikët katolikë që komunikonin me Vatikanin dhe shtetet tjera perëndimore, përkatësisht të të gjithë atyre që kishin ngritur zërin kundër përndjekjeve dhe maltretimeve serbe. Këtë e dëshmojnë edhe shumë dokumente.¹⁶⁶

Ëdhtë e ditur se qeveria serbe pretendonte që selinë ipeshkvore ta shpërngul në Shkup e të mos rri në Prizren, sepse kështu edhe mund tu ikte kontakteve më të shpeshta me njerëz. Por dihet se largimi apo më mirë të themi dëbimi i Mjedës nga argjipeshkvia Shkup-Prizren për qeverinë serbe ishte më i përshtatshmi. Që kjo të arrihej ishte veprim i vështirë për qeverinë serbe sepse kjo ishte kompetence për të cilën duhej të vendoste Vatikani. Si hap i rëndësishëm që ndërmerret nga Milivoj Jovanovic, ministër për çështje fetare, urdhri i adresuar policisë vendore që ta marr Mjedën fshehurazi në arrestim për të shikuar më vonë se si vepron më atë. Kështu qarqet vendore me rekomandim të Beogradit e detyruan që Imzot Lazër Mjeda fshehurazi ta lëshon argjipeshkvinë e të shkon për në Shqipëri. Kështu Mjedës nuk i mbetet tjetër rrugëdalje. Në vitin 1921 largohet “në heshtje” prej Prizrenit, ku e kishte selinë ipeshkvore të Shkupit. Me 14

¹⁶⁶ Shih më shumë në Arhivin e Propagande Fide, Affari ecclesiastici straordinarii, Austria-Ungheria, fasc. 600. Fol. Pos. 1475-1476, fol. 159.

shkurt arrin në argjipeshkvinë metropolitane të Shkodrës,¹⁶⁷ një hap ky i marrë pa dëshirën e vet. Pra si arsyetim kryesor i strukturave serbe ishte letra e Don Mikel Tarabulluzit e 15 janart 1920 që u bie në dorë qarqeve të sigurimit shtetërore, ku vlerësohet se ai duhej ose të gjykohej apo të lëshon argjipeshkvinë.¹⁶⁸ Ky ishte arsyetimi, por jo shkaku. Vlerësimet e qarqeve policore e politike serbe kishin gjykuar se, kleri katolik po përgatisë një lloj revolucioni kundër ushtirsë serbe në Kosovë.

Është e ditur letra përshëndetëse për meshtarët dhe për popullin e argjipeshkvisë së vet që kishte lënë Lazër Mjeda më 27 nëntor 1921 që do ta sjellim në tërësi këtu më poshtë. Para kësaj letre, dëshiroj edhe diçka të cekë. Me ardhjen e argjipeshkvit Mjeda në Prizren, kishte sjellë me vete shërbëtorën e vet nga Shkodra, që quhej Leze Suma, lindur në Shkodër më 1882 kurse vdiqë ne Velezhë (shërbei në këtë famulli deri në vdekje) afër Prizrenit më 1968. Ajo thotë: para Kërshëndellave zotni argjipeshkvit i kishte ardhur një shkresë nga qeveria. Ai dukej shumë merzitur dhe kishte kerkuar që sa ma shpejt t'ia pergaditnim disa gjera të ti që janë më të nevojshme, sepse duke të shkonte urgjentisht në Shkodër. Se a do të kthehej, - kihste thanë nuk din, por nese nuk do të kthehej duhet qëgjërat tjera të tij, t'ia dërgonim në Shkodër Të nesërmen u largua nga Prizreni. Ai ma nuk u kthye dhe ne ia dërguam në Shkodër të gjitha gjërat e ti personale", kurse natën para se të largohej shkruan letrën përshëndetëse që po e sjellim këtu e që ishte botuar në revistën Drita:¹⁶⁹

¹⁶⁷ Krah. Filip Fishta, njoftime historike mbi argjipeshkvijt e Shkupit , Hylli i dritës, vj. X. nr. 11, 1934, fq. 552.

¹⁶⁸ Për këtë ka akte të mjaftueshme në arkivin jugoslav në Beograd, në dosjen „Ministarstvo inostranih poslova - politicki arhiv (1922-1923) dhe Ministarstvo pravde - versko odeljenje sidomos 26-28, siqshkruan në literaturën e vet Nikolla Zutic, kjo duhet hulumtuar në tërësi.

¹⁶⁹ Botuar në "DRITA" Viti XI, 1(81), Jan. 1980, fq. 14-15.

“LETER BARITORE PER LAMTUMIRE ARKIDIEÇEZIT
T' SHKUPIT

Meshtarve t'ndershem e Popullit te dashtun t' Arkidieçezit
t`Shkupit shendet e bekim prej Zotit.

Dymdhet vjet janë rnushë n'ket muej t'nandorit qi Na per me çue
n'vend fjalën e madhnueshme t'Shejtit Atë Papë duelme Shkodret e
erdhme nder jue. Nuk kje punë e letë për Ne n`at koh me lanë vendin
e t'lemit e Seliën e parë t' Shqypniës per me ardhë nder kto kto vise,
ku Feja shejte gjindej nder ngushtime e travajë. Por besimi i ngulët
qi prej Zotit drejtohen t'tana punët rozollimit, e qi shka t'na ndollin
per t'miren t'onë e premtun i Lumi, ky besim Na forcoj zemren me
qitë poshtë t'tana arsyenat e shekullit e me ja shtruve kraht pa far
pritjet asajë barrë qi Dora e Zotit na ngarkote. E kjo e shtruve e
unjishme vullneses s`Tenzot kje cok njajo 'qi Na xuer prej Zotit
hirin e fuqishem me muejt per pak koh e me nji mëndyrë fort t'letë
me i qetue zemrat e popullit, e me hjekë ç`farë do ndryshkut ndermjet
t'Ti e t'Meshtahtareve. E jo veç kaq, por edhe me gjith kohna
t'vshtira qi Na u desht me kalue Na ndimuj Zotit me perparue e me
ndertesa t`reja si me permirsime t'vjetrave. Lavdi i kojfte t'Lumit!
Por shka e kuer kjeme tuj ende giatë e ma giatë per me i dhanë ma
shkelxim shejtes Fe, e me e xe popullin ma fort kah shpirti, pa pritë
pa kujtue Na u kputne t'tana fijet. Ajo fjalë e madh-nueshme qi prej
Shkodret Na prunë ktu, Na urdhnoj persri me kthye m'at gjytet. E
asht e ditun, se t'betuem me nigiue, Na do t'a kryjmë pa
kundershtrim urdhnit t'Parit. Por me gjith kte nuk mujtme me e
ndalë qi zemra e jenë mos t'ndalë dhimtë, e dhimtë t'fortë. E jo per
vedi, pse sikurse e dini, nuk jena tuj shkue m'nji vend ma t'poshter
as nuk jena tuj dalë per ndonji punë t'pamire; veç dhimten e ndiëme
per jue, qi mbas sa vjetve po Na duhet me ju lanë. Jena ken msue me
kja me jue e me jue me gzue; e dashtnija qi kishim me shoqishoj Na
nepte fuqi me i ba ballë sa t'vshtirave qi na rane nder kto vjet. Patme
edhe kujtue se ky do te ishte caku ma i mbrami i joni e se ktu do t'a

sosshë jetën; por Zotyn premtoj ndryshej, e kjoftë ba vullndesa e t'Lumit. E mbasi ket punë Ne as nuk e lypme, as nuk e dishrueme kurr, duhet me thane se prej Zotit ka rriedhë, e prandej do t'jetë per t'mirë t'dyë palna. Ky mendim do t'ma nep zemer me ju shtrve per ankim vullndeses s 'Zotit.

E tesh, ndoshta per t'mbramen herë, po m'hjek zemra me ja u thanun dojë fjalë. O ju Meshtarë qi ju ka vue Zoti me i prie popullit t'Krishten kah rruga e shelbimit, peshonie detyren t'uaj, e kujdesni me e krye. Dunie popullin, si Krishti don shpirtnat t'onë, e kjo dashtni ka me ju msue se si me i ardhë rreth popullit per me e shelbue. E ti popull i kti Arkidieçezit, nderoje e nigioje Meshtariën t'ande, ne daç me pasë bekimin e Zotit. Mos u dajë kurr prej ti, n'daç mos me dalë jashta rruges t'shelbimit. Dunie edhe shoqishojnë jo veç me fjalë, por edhe me veptra, qi t'shofë gjithkush se jeni besimtartë e vertetë t'Lumit J. Krisht. I lum Arkidieçezi ne ecshi mbas ktyne fjalve. - Ne e mbram tuj ju thanë lamtumirë po ju lypim t'falun per gjithshka qi dashtë pa dashtë kena muejt me folë e me ba kundra kuej; por ç'far do sendet qi ka muejt kuej me i ra n'syë e me i dhane shkandull; tuj ju sigurue se kundra kerkuj s kena pasë qellim t'keq por n'pasim reshqitë prej pa dies. Edhe Na juve ç'far do idhnim o fjalet po jau falim unjië, si miqve si anmiqve e kurrfarë ndryshkut kundra kuej s'ka me metë ne zerner t'Onë. T'gjith sa jeni kjoshi lirë e bekue, e Zoti i shprazhtë huret e veta permbi jue.

Lutnie Zotin per Ne si Na jena lutë e kena per t'a lutë per jue, e sidomos lutnie Zotin pa da qi t'a çojnë nji Bari t'mirë, si e lypë nevoja e fesë shejte, dobija e shpirtnave t'uej, e lulzimi i atdheut t'onë.

Bekimi i t' Naltit kjoftë gjithmonë me jue, e ju forcoftë me mbrie n'lumni t'pasosme.

Ne Perzerend me 27 nanduer 1921

Lazri, Argjipeshkoi"

Nga përmbajtja e saj ne mund të nxjerrim një vlerësim tjetër përkitazi me arsyen e largimit të tij nga argjipeshkvia e Shkupit. Largimi i tij, del nga përmbajtja e letrës, kishte qenë e përcjellur me një dhimbje tejet të madhe, nga përmbajtja shihet se sa i dhemb shpirti bariut të popullit për grigjën e vet, ai e dinte saktësisht se, ishte detyruar në gjendje nevojë të madhe ta linte grigjën e vet, dhe sa dashuri të madhe kishte ai ndaj popullit të argjipeshkvisë së Shkupit. Ai shkruan po ashtu se, nuk ishte dëshira e tij të linte argjipeshkvinë e Shkupit. Megjithatë ai kishte mbet me shpresë të madhe në meshtarët, ku i porositi ta duan popullin e vet.

Është shumë interesant se, shpeshëherë është thënë se Mjeda kë lëshuar Ipeshkvin e Shkupit me dëshirë të vet. Se kjo është një pohim dhe vlerësim i pasaktë, do të shihet më poshtë. Detyrimi që ta lëshoj Shkupin ishte e planifikuar e kurdisur mirë, sa “ikja” e tij në heshtje kishte qenë alternativa e vetme dhe më e arsyeshmja. Do të krijohet një situatë e pa përballeshme kundruall zullumit të kurdisur nga pushteti i atëhershëm. Për gjendjen në fjalë edhe Vatikani ishte i informuar në detaje, për çka atij jepet detyra e re në argjipeshkvinë metropolitane të Shkodrës. Selia Shenjte ishte në dijeni për rastin e L. Mjedës se qeveria serbe nuk e donte aspak, dhe siç duket, Vatikani ishte i obliguar “ta largonte” L. Mjedën prej argjipeshkvisë Shkup-Prizren që t’i ikë konflikteve diplomatike në rajon. Atë emëron argjipeshkëv metropolitane të Shkodrës që dekretin e datës 05.11.1921, kurse zyrtarisht më 3.12.1921 lajmërohet edhe qeveria në Beograd se është e pajtimit me largimin e Mjedës.

Para se të kalonte për në Shkodër Mjeda kishte emëruar administrator të ipeshkvis Don Tomë Glasnivic (famullitar në Ferizaj) dhe Don Ferdinand Hrđi (famullitar në Nish) për ta udhëheqë argjipeshkvinë e Shkupit – siç duket gjatë kësaj kohe, pra, deri në emërimin e ipeshkvit Gnidovec, argjipeshkvia e Shkupit duhet të jetë shndërruar një herë në admini-

straturë apostolike për tu ngritur përsëri në ipeshkvi. L. Mjeda kishte pasur shumë besim në Dom Tomë Glasnoviqin-Shala. Kardinal Gaspari kishte lajmëruar qeverinë serbe me 02..04.1922 se Dom Toma dhe Ferdinandi do të administrojnë ipeshkvinë deri në emërimin e ipeshkvit të ri, pra të imzot Janez Gnidovec nga Sllovenia, që do të jetë ipeshkëv i parë i Shkupit, pra pasi që i merret titulli argjipeshkvi.

Përpos kesaj letre larntumirëse arqipeshkvi Mjedja u kujdesua edhe për zëvendësin e vet të përkohshëm dhe si delegat e emëroi Don Temë Glasnoviqin. Me këtë rast ai u shkruan kështu meshtarëve: "... Mbas Zotyn neper gojë t'Shejtit Atë Papë Na urdhnoj me i lanë kto vende. Na për mos me metë Arkidioçezi pa prisë, e me prandim t'Selisë Shejte, kena sjellë fort t'ndertin Zotni D. Tomë Glasnoviqin për me ken sundues i Arkidioçezit, deri qi Rroma t'na ndreqin punen ndryshej ..." ¹⁷⁰

Me kalimin e Lazër Mjedën në Shkodër për shqiptarët e Kosovës dhe Maqedonisë do të jetë një humbje e madhe. Me largimin e Mjedës "Jugosllavia" nuk do të pranoj më shtetas të huaj që të jenë në krye të kësaj detyre. Me emërimin e Ivan Gnodovec nga Sllovenia më 29.10.1924, ipeshkvia e Shkupit tashmë bëhet ipeshkvi sufragane e argjipeshkvisë së Beogradit. Selia ipeshkvore nga Prizreni në Shkupi. Me emërimin e ipeshkvit Gnodovec fillon krejtësisht një periudhë e re sidomos për besimtarët shqiptar në territorin e Jugosllavisë. Konkordati i vitit 1914 ishte ratifikuar, Serbisë i konvenonte të vepronte sipas këtij dokumenti deri në bisedimet për konkordatin e ri të vitit 1935. Në fakt sipas konkordatit të vitit 1914 çdo ndryshim në ipeshkvinë Shkup-Prizren, duhej mirati-mi i qeverisë serbe. Kështu për shembull për formimin e famullisë së Velezhës nga ana e administraturës apostolike të Shkupit më 10.10.1922, ku si famullitar ishte vendosur don Luigj Gashi,

¹⁷⁰ Shif Drita, 3/1980, fq. 8.

ishte dashur lejimi dhe miratimi nga ana e ministrisë për çështje fetare në Beograd. Më 01.01.1923 ministria për çështje fetare e miratuar kërkesën. Edhe ndërrimi i famullitarëve nuk parashihej pa u informuar ministria e lartpërmendur.¹⁷¹ Mbështetur në autorët serb shihet shumë qartë se, problemi i famullitarëve nuk ishte aq i madh nëse ata nuk ishin shqiptarë. Problem ishte nëse ishte fjala për shqiptarë.

Studiuesi i mirëfilltë i historisë së ipeshkvisë Shkup-Prizren, Gaspër Gjini, në veprën e tij, në mënyrë të tërthortë, mbase nuk e lejonte situata kur e kishte shkruar veprën e tij, thotë: „Ç'qëllim pati kjo politikë e këtillë e kurdisur, nuk është vështrë të qëllohet. Dhe jo vetëm kaq, shumë individë dhe qarqe të atëhershme nuk ngurruan ta thoshin këtë qysh atëherë edhe publikisht dhe me fjalë të hapura, gjë që sot gjithsesi na befason shumëfish“.¹⁷²Dhe, duke i ikur me qëllim komentimeve, G. Gjini merr një citat të R. Kazimirovic të botuar atë kohë ku haptas thotë se, nëpërmjet protektoratit të vitit 1914 dëshiroam, përveç gjërave tjera politike, që protektorati të shërben si mjet për sllavizmin e shqiptarëve në këto troje. Kurse Selia Shenjte luftonte për të drejtat e kishës katolike.¹⁷³

X. Në vend të përfundimit

Luka Filiq¹⁷⁴ thotë për Lazër Mjedën kështu: „Pas kësaj kohe të stuhishme dhe të zyrtë, timonin e kryeipeshkvisë sonë e mori Shkelqësia e Tij, Lazër MJEDA. Së pari me uratë, shembull dhe fjalë filloi të punojë për mirëqenje dhe ngrohtësi të grigjës së besuar. Pas një kohe të shkurtër mund t`u shihte përparimi shpirtëror i shpirtërve. Me fjalë tjera:

¹⁷¹ Shif edhe Nikola Zutic, kraljevina jugoslavija, fq. 163-164.

¹⁷² Gjini, Ipeshkvia, fq. 210.

¹⁷³ Krahe. Gjini, fq. 212-213 fusnota 11.

¹⁷⁴ SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, Drita Nr. Viti XIII, Nr. 5-6, 1982. fq. 6.

1. I pruri Jezuitët në kryeipeshvki
2. Themeloi dy famulli të reja: Novosellën dhe Becin, ndërsa të tretën në Velezhë:
3. I dërgoi nxënësit për priftërinj në Shkodër, ndërsa teologët në Innsbruck.
4. Në këtë mënyrë e siguroi ardhmërinë e kryeipeshkvisë së vet sa i përket priftërinjëve; ndërsa për të mbajtur brezin e ri prifëror
5. e ndërtoi një godinë të madhe në Shkup kundrual qelës
6. La një fond prej 1.000.000 (milion) dinarësh për ndërtimin e seminarit të vogël.

Deri sa ishte ky, kryeipeshkëv nukl i mungonte sa i përket priftërinjëve, sepse famullitë ishin plotësuar me famullitarët e vet, ndërsa aty-këtu ishin edhe dy dhe tre priftërinjë. Atëherë nuk ishte aspak nevoja për kolekte të hollash, as që ishin më parë taksat e tanishme. Krejt kjo ngjati pas shkuarjës së Shkelqësisë së Tij, zotëri argjipeshkvit Lazër MJEDËS. Ai nuk pat `kler shumë të ndershëm` sepse nuk kishte nevojë, pasi që për çdo rast kishte Jezuitët, dhe kështu lulëzonte kryeipe-shkvia jonë“

Imzot Lazër Mjeda ka thënë: „Unë nuk di politikë tjetër, por me ba detyrën teme. Si shqitpar e si ipeshkëv. Krishti nuk ka ba kurr politikë. Ai ka folë qartë“.¹⁷⁵

¹⁷⁵ SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, Drita Nr. Viti XIII, Nr. 5-6, 1982. fq. 7.

Burimet dhe literatura

Burime

Arkivi shtetëror i Austrisë – Haus-Hof und Staatsarchiv (HHStA), Vjenë, Austri

Arkivi i Famullisë së Stubllës (Kosovë).

Arkivi i Françeskanëve në Graz (Austri).

Arkivi i Universitetit Innsbruck (Austri).

Gazetat

Allgemeine Tiroler Anzeiger, Innbruck

Elçija Zemres s`Kristit

Hylli i Drites, Shkodër

Neue Freie Presse

Reichspost, Vjenë

Wiener Sonn- und Montags-Zeitung, Vjenë

Zani i shna Ndout, Shkodër

Zani i Zojes Cernagore, Prizren 1992-63

Vossischen Zeitung, Berlin

Literatura

AHMETI Isak, Don Mikeli, pishtar i arsimit në Kosovë, Shkëndija, shtator 1990.

AHMETI Zef, Lidershipi shqiptar sipas Krist MALokit në kontekstin actual, Urtia, Revistë fetaro-kulturore, Zagreb 2005.

BARTL Peter, Kryptochristentum und Formen des religiösen Synkretismus in Albanien. Grazer und Münchener Balkanologische Studien. München 1967. S. 117-127 (= Beiträge zur Kenntnis Südosteuropas und des Nahen

- Orients 2). Përktimi shqip: Kriptokrishtenizmi dhe format e religjionit sinkretik të shqiptarëve, *Urtia*, X, 1 (15) 2002, S. 107-119.
- BENNA Anna Hedwig, Studien zum Kultusprotektorat ÖSTERREICH-Ungarns in Albanien in Zeitalter des Imperialismus (1888-1918), *Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs (MÖSTA)* 3, fq. 13-46, 1954 Vjenë.
- BOECKH Katrin, Von den Balkankriegen zum Ersten Weltkrieg. Kleinstaatenpolitik und ethnische Selbstbestimmung auf dem Balkan. München 1996.
- BYTYQI Nue don, Kanga e popullit. N`nderr t` Zois Zernaghores, Elçija e Zemrës së Krishtit, Shkodër, qershor 1894.
- CANA Zekeria, Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente), Prishtinë 1996.
- CANA Zekeria, Martir i fetarisë dhe atdhëtarisë, në *Bashkësia jonë*, Gjakovë, Viti XI, nr 39, 2003, fq. 18-20.
- Catalogus Moderatorum, Professorum, Alumnorum in Convictu theologorum ad S. Nikolaiu et in facultate theologica Universitatis Oenipantanae invente anno schol. 1905/06 editus. Oenipante Typis Sociaetatis Marianae, Innbruck 1905.*
- CILEV P, Obikolka iz albanski seliste v Pristinsko, Prizren, Debrsko i Ohridasko, *Izvestija na Narodnija muzej v Sofija*, VI, 1926.
- COLAK N.- MAZURAN I., Janjevo. Sedam stoljeca opstojnosti Hrvata na Kosovu, Zagreb 2000.
- CORDIGNANO Fulvio, L'Albania a traverso l'opera e gli scritti di un grande Missionaria italiano, il P. Domenico Pasi S.J. (1847-1914). I-III. Roma (1933-1934).
- CORWEL John, Pius XII., Der Papst, der Geschwiegen hat, München 1999.

- DEUSCH Engelbert, das Kultusprotektorat Österreich (Ungarns) im albanischen Siedlungsgebiet in seinem kulturellen, politischen und wirtschaftlichen Umfeld (ende i pabotuar, botimi pritet ne mesin e vitit 2009) Vjenë 2009.
- Die Schulaktion in Albanien, (Geheim) Referat II, mit einem Vorwort von Tibor Graf Szapary, Vjenë 1917 (Manuskripti gjindet tek Albert Ramaj)
- DIMIC Lj-BOROZANIN Dj, Jugoslovenska drzava i Albanci. Sluzbeni list SRJ, Arhiv Jugoslavije, Vojno-istorijski Beograd 1998
- DIMIC Lj-ZUTIC N, Rimokatolicki klerikalizam u Kraljevini Jugoslaviji 1918-1941, Beograd 1992.
- DJURIC Franjo. Die Geschichte der Krypto-Katholiken (Ljaramanen) in der Diözese Skopje-Prizren und die Probleme ihrer pastoraren Bedeutung, Innsbruck 1987.
- DURHAM Edith, High Albania. London (1909).
- DURKOVIC-JAKSIC, L.D. Srbija i Vatikan 1804-1918. Kraljevo-Kragujevac, 1990.
- ENGEL-JANOSI Friedrich, Die politische Korrespondenz der Päpste mit den Österreichischen Kaisern 1804-1918, Vjenë-München, 1964.
- FISHTA Filip, njoftime historike mbi argjipeshkvijt e Shkupit, Hylli i dritës, X, 11, 1934.
- FREUNDLICH Leo, Albaniens Golgotha - Anklageakten gegen die Vernichter des Albanervolkes. Gesammelt und herausgegeben von Leo Freundlich, Vjenë 1913.
- GASHI Gjergj, Kosova. Altari i Arbërisë I-III, Tirana 1996.
- GASHI-Gj Gjergj, Martirët shqiptarë gjatë viteve 1846-1848, Feriazj (Drita), 1994.
- GASHI-GJ. Gjergj, Vatikani dhe Arberia 1700-1922, Tirana 1998.
- GJINI Gaspër, Skopsko-Prizrenska Biskupija kroz stoljeca Zagreb 1986, shqip: Ipeshkvia Shkup- Prizren nëpër shekuj,

- Ferizaj 1992, anglisht: The Shkup-prizren Diocese through centuries, Prizren 2000.
- GOSTENTSCHNIGG Kurt, Protektorati i Kultit austro-hungarez mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut. Phoenix, 15-16, Shkodër, 2000.
- GOTTSMANN Andreas, Konkordat oder Kulturprotektorat? Die Donaumonarchie und die diplomatischen Aktivitäten des Hl. Stuhls in Südosteuropa 1878-1914. fq. 409 - 464, Römisch Historische Mitteilungen 48, Vjenë 2006.
- GRULICH Rudolf, Die unierte Kirche in Maqedonien (1856-1919), Würzburg 1977.
- GURAKUQI Romeo, Aspekte të qëndrimit të Klerit Katolik shqiptar në agimin e pavarësisë së shqiptare: (mars 1911-maj 1914), Phoenix, viti 3, nr. 5-6, Shkodër 1999.
- HAHN Johan, Georg von, „Albanesische“ Studien, Jena 1854.
- HAHN Johann Georg von, Reise von Belgrad nach Salonik, Vjenë 1861.
- HAHN Johann, Georg von, Reise durch die Gebiete von Drin und Wardar, Vjenë 1867
- HARAPI Zef Mark, (përgatiti Nikë Ukgjini) Ditët e trishtimit në Pejë e nder rrethet 1912-1913, Pejë (Dukagjini) 2004
- HÖSCH Edgar, Geschichte des Balkans, München 2004.
- HRABAK Bogumil, Kulni protektorat Austro-Ugarske nad katolicima Arbanasima. Vjetar XXIII, Prishtinë, 1987
- ILLYRISCH-ALBANISCHE FORSCHUNGEN (Hg). L. Thalloczy, C. Jirecek, M. Sufflay I-II. München und Leipzig 1916.
- IPPEN Theodor Anton, Das religiöse Protektorat Österreich-Ungarns in der Türkei, in: Die Kultur, 3, 1902.
- JANOSI Friedrich Enge, Österreich und der Vatikan 1846-1918, II, Die Pontifikate Pius` X. und Benedikts XV. (1903-1918), Graz, Wien. Köln 1960.

- KËRHRANAJ Nikollë, Paraprgatitje për koanonizim të Pater Luigjit, *Bashkësia jonë*, Gjakovë, Viti XI, nr 39, 2003, fq. 21-23.
- KOSIR Borut, *Das jugoslawische Konkordat aus 1935*, Österreichisches Archiv für Recht und Religion, 48, 1, 2001, S. 53-77.
- LOVRIC, B. J. *Katolička crkva u Srbiji - pod zaštitom Austro-Ugarske Monarhije - prilog povjesti Katoličke crkve u Jugoslaviji*, Nis 1930.
- LUFU Simon, *Vatikani dhe Shqipëria. Përpyekjet për nënshkrimin e Konkordatit*, Krishterimi ndër shqiptarë, Simpoziumi ndërkombëtar, Shkodër 2000.
- MALCOLM Noel, *Crypto-Christianity and Religious Amphibianism in the Ottoman Balkans: the Case of Kosovo* (referat) i mbajtur më 1997, organizuar nga SSEES/SOAS, Londër 1997.
- MALCOLM Noel, *Kosovo. A short history*, London 1998, Shqip: MALCOLM, N.: *Kosova. Një histori i shkurtër*, Prishtinë-Tiranë 2001.
- MALOKI Krist, *Refleksione, - Kritikë (letrare), analiza dhe mendime*, përgatitur nga Albert Ramaj, Prishtinë 2005.
- Memoar i Pashk Kçires prej Gjakove*, Lezhë (kuvendi) 2001.
- MIHACEVIC Lovro, *Crtice iz albaneske povijesti*, Sarajevë, 1912.
- MIHACEVIC Lovro, *Durch Albanien*, Prag 1913.
- MIHACEVIC Lovro, *Po Albaniji. Dojmovi s puta*. Zagreb, 1911.
- MIRDITA Zef, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Prizren-Zagreb, 1998.
- MIRDITA Zef, *Krishtenizmi ndër shqiptarët*, Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Zagreb 1998.
- MIRDITA Zef, *Shqiptarët në dritën e politikës së jashtme të Serbisë*, Dardania Sacra Nr 4, Prishtinë 2002.

- MUÇAJ Nimon, Misteri i kujtesës. Martirit Atë Luigj Palaj, në Bashkësia jonë, Gjakovë, Viti XI, nr 33, 2001, fq. 7-11.
- NIKIC ANDRIJA, Stanje na Kosovu od 1840-1890, Split, Zbornik Kacic, 1980.
- Österreichs Katholiken-Protectorat in Albanien, Vossischen Zeitung (17 gusht 1913), nr. 415.
- PETERS Markus, Der älteste Verlag Albaniens und sein Beitrag zu Nationalbewegung. Bildung und Kultur, Hamburg 2007.
- PETERS W. E. Markus, Geschichte der katholischen Kirche in Albanien 1919-1993, Wiesbaden, 2003.
- RAMAJ Albert, Burime dhe dëshmi. Stublla në dokumente arkivore austriake, shkolla, kriptokrishtenizmi në Karadak. Stublla im Kosovo. Die Geschichte, die Schule und das Krypto-Christentum der Karadakregion, St. Gallen 2008.
- RAMAJ Albert, Dita e vdekjes së Kolë Bojaxhiut, Shkeulli (Tiranë) 01.08.2006.
- RAMAJ Albert, Dokumente arkivore për Stubllën në arkivat e Austrisë in: www.albanisches-institut.ch
- RAMAJ Albert, Kongresi i Manastirit sipas dokumenteve austriake, (Gurmëshkrim shqip apo 100 vjetori i Kongresit të Manastirit, editor Ndue Ballabani), Zagreb 2008 fq. 98-110.
- RAMAJ Albert, Krypto-Christentum im Kosovo, Albanische Hefte 1/2007, fq. 11-13, Bochum 2007.
- RAMAJ Albert, Krypto-Christentum im Kosovo, G2W (Zürich), 3/2007 35, S. S. 24-25.
- RAMAJ Albert, Mutter Terasa von Kalkutta ist Gonxhe Bojaxhiu von Skopje, Thede Kahl, Izer Maksuti, Albert Ramaj) (Ed.), Die Albaner in der Republik Makedonien. Fakten, Analysen, Meinungen zur interethnischen Koexistenz . Münster-Vjenë-Zürich, 2006.
- RAMAJ Albert, Nëna Terezë - Bojaxhinjtë dhe prejardhja e tyre, Thema (Tiranë), 23-24. XI. 2003, 1-6. Ribotim

- Universitas, revistë për Shoqëri, Shkencë dhe Kulturë, Tetovë, III. 4-5, 2004, fq. 156-187.
- RAMAJ Albert, Probleme etnike të personaliteteve tona, Bojaxhinjtë dhe preardhja e tyre, Zeri ditur (diaspora) fehton prej 27. XI - 10. XII 2003.
- RAMAJ Zef dom, Emzot Lazer Miedia n`S`hkup, në Elçija Zemres s`Kristit, I, 20 (1910), fq. 8-12.
- RASTODER Serbo, Konkordat izmedju Crne Gore i Vatikana 1886. godine s posebnim osvrtom na položaj albana katolika, Krishterimi nder shqiptar, Simpoziumi nderkombetar, Shkoder 2000.
- REMROU Milan, Katolicki nadbiskipi u Skopjlu, glasnik skopskog naucnog drustva, Shkup 1926.
- REUTER J. - KLEWING K. (Ed), Der Kosovo Konflikt, Ursachen, Verlauf, Perspektiven, Klagenfurt 2000.
- RJELIC Slobodan, Opasni dokumenti, gazeta NIN, Beograd, 26 mars 2003.
- SCHWANKE Robert: Österreich-Ungarn und der albanische Sprachkongreß zu Manastir (Bitola) im Jahre 1908, Gjurmime Albanologjike, 1 Prshtinë, 1969, fq. 58-75.
- SERBISCHE AKTION GEGEN DIE KATHOLISCHEN SCHULEN IN LETNICA UND STUBLA 1914 fq 418, Mitteilungen des Österreichischen Staatsarchivs, Nr. 29, Vjenë 1976.
- Serbisch-vatikanische Beziehungen, në Österreichische Monatschrift für den Orient 39 (tetor 1913), nr. 10.
- Shujta shpirtnore (përpiloi Gaspër Gjini), Ferizaj-Zagreb 1978.
- SIMIC Sime, Jugosllavija i Vatikan. Zagreb 1937
- SLISKOVIC Jakov, Albanija i Macedonija, Sarajevo 1904.
- SOPI Mark, Argjipeshkvit e Shkupit, Drita, viti XI, 11 1980, fq 12-13.
- SOPI Mark, Imzot Lazër Mjeda, Kumbona e së dielles, tetor 10 (16), fq. 3-4, Shkodër 1993.

- SOPI Mark, Memoriam. Imzot Lazër Mjeda, Drita viti XVI, nr. 9-10 1985, fq. 18-19
- SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, Drita Nr.Viti XIII, Nr. 5-6, 1982. fq. 7
- SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, Drita Nr.Viti XIII, Nr. 3-4, 1982. fq. 8.
- SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës - Arritja e Lazër Mjedës në Prizren, Drita Nr.Viti XIII, Nr. 5-6, 1982. fq. 6-7.
- SOPI Mark, Shembulli i baritu të mirë dhe atdhedashës, Drita Nr.Viti XIII, Nr. 1-2, 1982. fq. 8.
- SOPI Marko, Briga biskupa Gnidoveca o ljarmanima, SKULJ Edo (Ed.), Gnodovcev simpoozij v Rimu, Celje 1989, S. 177-186.
- STADTMÜLLER Georg, Die Islamisierung bei den Albanern. Jahrbücher für Geschichte Osteuropas N.F. 3 (1955) S. 404-429. përkthim, Urtia, IX, 1 (14), 2001, S. 37-60.
- STEINITZ E. Berchtolds albanische Politik, Berliner Monatshefte 10, Berlin 1932
- SUPPAN Arnold, Jugoslawien und Österreich 1918-1938, Oldenburg 1996.
- TOMIC Jovan, O arnautima u Staroj Srbije i Sanzaku. Beograd 1913.
- TRATZKI Leo, Die Balkankriege 1912-1913, Essen 1995.
- TURK Alois, Letnica. Marijansko hodocasnicko svetiste Ekumenski centar na Kosovu. Belgrad 1973.
- TURK Aloiz, Dr. Janez Francisek Gnidovec, Beograd 1968.
- TURK Aloiz, Skof Janez Gnidovec, Celje 1992.
- UKËGJINI Nikë, Albanci katolici u sjevernoj Albaniji i u danasnoj Crnoj Gori za vrijeme turskog gospodstva (XV.-XIX), Zagreb 2002.

- UKËGJINI Nikë, Aneksimi i Kishave Katolike të Kryedioqezës së Shkodrës nga ana e Malit të Zi, Fjala Hyjnore. revistë për kulturë religjioze e meshtarëve të Kosovës, Prishtinë 1/2004.
- UROSEVIC Anastazije, Dvoverstvo medju Arbanasima, Extrait des Comptes Rendus Du VI-e Congres des Geographes et des Etnographes Slaves - Sofia, 1936
- VALENTINI Giuseppe, "Il Fratel Zef e la Missione volante" Notizier agli Amici dei gesuiti lambardo-veneto-emeliani, Milano, 2 (1972)
- VELNIC Teofil, Fulgencije Carev, nadbiskup, Pazin 1961.
- WAGNER Vjekoslav, Povijest katolicke Crkve u Srbiji u XIX. Stoljeću od 1800. Do Konkordata 1914. Godine, Bogoslovska smotra, XXI, 4, Zagreb 1933.
- WAGNER Vjekoslav, Strossmayer Apostolski administrator u Srbiji, Katolicki list 84 (1933).
- ZEFI Frok, Austria mbrojtëse e katolikëve në Ballkan, Urtia 1/1994.
- ZEFI Shan don, Fenomeni i laramanizmit në vazhden e islamizmit ndërshqiptar në dritën e relacioneve kishtarë, Takimet e don Mikelit III (1995-1996), fq. 20-27, ribotim Krishtërimi ndër shqiptarë, simpozim ndërkombëtarë Tiranë, 16-19 nëntor 1999, fq. 180-185 poashtu ribotim Argjipeshkvi Vinçenc Zmajevich, punimet e simpoziumit të mbajtur në Zagreb me 14-15.X.1995, fq. 43-50., MKSH, 2001 Zagreb.
- ZEFI Shan, Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve, Prizren 2000.
- ZEFIQ Frok, Djelovanje isusovaca u albanskom narodu, Zagreb 2002.
- ZIVOJINOVIC D - LUJIC D., Varvarstvo u ime Hristovo, prilozi za Magnum crimen, vëll. I-II, Beograd 1988.
- ZIVOJINOVIC D.R. Vatikan, Srbija i stvaranje jugoslovenske države 1914-1920, Službeni list Beograd 1980.

- ZIVOJINOVIC Dragoljub, Srbija i Jugosloveni za Vreme Rata 1914-1918, Biblioteka grada Beograd 1991.
- ZIVOJINOVIC Dragoljub, Sveta stolica i odnosi izmedju Austro-Ugarske i Srbije, in Velike Sile i Srbija pred prvi svtski rat, Beograd 1976.
- ZIVOJINOVIC Dragoljub, Vatikan, Srbija i Stvaranje Jugoslovenske Drzave 1914-1920 (bot. i dytë), Sluzbeni list SRJ 1995.
- ŽIVOJINOVIĆ, D. R. & LUČIĆ, D. J., Varvarstvo u Hristovo ime. I-II, Beograd 1989
- ZUTIC Nikola, Kraljevina Jugoslavija i Vatikan. Odnos jugoslavenske drzave i rimske crkve 1918-1935, Beograd 1994.
- ZUTIC Nikola, Rimokatolicka misija i klerikalizam na Kosovu i Metohiji u kraljevini Jugoslaviji, Istorija 20 Veka, XVII 1-2, Beograd 1999, fq. 105-113
- ZUTIC Nikola, Vatikan i Albanci u XX veku, fejton në gazetën beogradase Glas javnosti 16-26 shkurt 2003.
- ZUTIC Nikola, Vatikan i Albanici. U prvoj polovini XX veka do 1941. Beograd 2000.